



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 549 Akti

Nr. 735 Vendimi
Tiranë, më 31.1.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 29.1.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati 0 (*underground*), salla B, Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Dritan Nushi**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Nushi, vëzhguesin ndërkombëtar z. Steven Kessler, pasi shqyrtoi në seancën dëgjimore publike, në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Dritan Nushi, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Nushi, aktualisht me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është subjekt rivlerësimi, që i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi në kohën e dorëzimit të deklaratës *Vetting* ushtronte detyrën e prokurorit.
2. Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.6.2020 në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Olsi Komici dhe Firdes Shuli. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Olsi Komici.
3. Trupi gjykues, me vendimin datë 22.6.2020, vendosi të fillojë hetimin administrativ bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Dritan Nushi, si dhe caktoi kryesuesen e trupit gjykues, komisioneren Firdes Shuli. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mungesa e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues dhe subjekti i rivlerësimit, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Steven Kessler.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), aktualisht Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP).
5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për të tria kriteret e vlerësimit.
6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 28.12.2023 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Nushi, bazuar në të tria kriteret, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative.
7. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 5.1.2024 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo për të kërkuar marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfuturara nga hetimi kryesisht i zhvilluar Komisioni, brenda datës 22.1.2024.
8. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka dërguar nëpërmjet *email*-it datë 22.1.2024 dhe datë 23.1.2024 prapësimet dhe provat pranë Komisionit, në lidhje me rezultatet e hetimit të dërguara.
9. Komisioni, bazuar në vendimin datë 24.1.2024, nëpërmjet postës elektronike datë 24.1.2024 i njoftoi subjektin ftesën për seancën dëgjimore të datës 29.1.2024 (ora 10:00).

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 29.1.2024 (ora 10:00), në Sallën e Konferencave në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler.

11. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

12. Z. Dritan Nushi ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 dhe duke respektuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

14. Për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Nushi, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të saj, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin tri kritere vlerësimi: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; vlerësimin e aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

15. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe në përfundim ka hartuar dhe dërguar në Komision raportin përkatës¹ ku, bazuar në pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje pasurie;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

16. Komisioni nga ana e tij vëren se në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë sipas nenit 31/1² të ligjit nr. 84/2016, subjekti Dritan Nushi ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 25.1.2017, pra në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2018, dërgohet nga ILDKPKI-ja akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Nushi.

² Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

fuqi³. Pas analizimit të kësaj deklarate, raportit dhe dosjes se dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe informacioneve të marra nga subjekte të së drejtës publike, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting* sipas formularit (shtojca nr. 2), datë 25.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

❖ Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit

1. Depozitë bankare me afat në Credins Bank, shtuar interesat deri në datën 23.1.2017. Depozitë rrjedhëse. Vlera: 1,484,127 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: _____.

1.1 Kjo depozitë është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2008, duke pasqyruar shtesat përkatëse për çdo vit deklarimi deri në vitin 2016 kur është deklaruar vlera 1,484,127 lekë.

1.2 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* një përshkrim nga Credins Bank, datë 23.1.2017, për gjendjen e llogarisë me vlerë 1,479,332.03 lekë deri në datën 26.9.2016.

1.3 Credins Bank⁴ konfirmon llogarinë bankare të subjektit me gjendje në datën 31.12.2016 në shumën 1,479,332 lekë. Vlera 1,484,127 lekë e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* i referohet shumës në llogari bankare pa zbritur shumën e tatimit të interesave të mbajtur nga llogaria në datën 26.9.2016.

1.4 Komisioni vëren se në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi për këtë llogari, por nga verifikimi i veprimeve bankare në bankat e nivelit të dytë rezulton se kjo llogari është krijuar në datën 26.9.2008 nga depozitimi *cash* i shumës 1,000,100 lekë, e tërhequr në të njëjtën datë nga Raiffeisen Bank pas maturimit të depozitës prej 1,020,305 lekësh në datën 23.4.2008, krijuar me burim nga pagat e patërhequra të subjektit⁵. Nga data 26.9.2008 deri më 31.12.2016, shtesat në këtë llogari janë krijuar nga interesat e akumuluar.

1.5 Në pyetësonin nr. 2, subjekti ka deklaruar⁶ se burimi i krijimit të kësaj depozite janë të ardhurat nga pagat ndër vite, e provuar nga *statement*-et bankare nga viti 2005 në Raiffeisen Bank. Gjatë vitit 2007, shumicën e këtyre parave subjekti i ka futur në depozita tek i njëjti numër llogarie dhe më pas ka tërhequr 1,000,000 lekë nga depozita me afat dhe i ka transferuar në vitin 2007 në Credins Bank, ku ka pasur depozitë kursimi afatgjatë.

1.6 Për sa më lart, përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e depozituar. Nuk konstatohen problematika për këtë pasuri.

³ Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3, datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti dhe datës të botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare³, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin dhe rrëzimin e kërkesës për shfuqizim, ligji hyri në fuqi në datën 8.10.2016. Në datën 25.10.2016, ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese. Në datën 18.1.2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit. Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare në datën 19.1.2017. Si rezultat afati 30-ditor në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit për dorëzimin ka përfunduar në datën 31.1.2017.

⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 26.3.2021.

⁵ Fillimisht subjekti ka çelur në datën 20.3.2007 një depozitë 6-mujore në shumën 1,060,000 lekë, me gjendjen e mbetur në llogarinë e pagës. Kjo depozitë është maturuar në vlerën 1,080,198 lekë, në datën 20.9.2007. Në datën 23.10.2007, subjekti ka riçelur një depozitë tjetër 6-mujore me shumë fillestare 1,000,000 lekë, e cila është maturuar në datën 23.4.2008 në vlerën 1,020,305 lekë, në llogarinë e pagës. Nga kjo llogari, në datën 26.9.2008 subjekti ka tërhequr shumën 1,000,000 lekë, të cilën e ka depozituar në të njëjtën ditë në Credins Bank.

⁶ Përgjigjja nr. 1/a e pyetësonit nr. 2.

2. Depozitë rrjedhëse në Raiffeisen Bank për pagën deri në datën 24.1.2017. Vlera: 285,122 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: paga e subjektit.

2.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2005 “*Llogari rrjedhëse e pagës në Raiffeisen Bank (RFB). Vlera 579,998 lekë deri në datën 31.12.2005*” dhe për çdo vit ka deklaruar llogari rrjedhëse dhe llogari depozitë në Raiffeisen Bank, që kanë si burim pagat e subjektit.

2.2 Raiffeisen Bank⁷ konfirmon llogarinë e pagës së subjektit, me gjendje në datën 31.12.2016 në shumën 216,804 lekë. Vlera 285,122 lekë e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* i referohet gjendjes së datës 24.1.2017. Në këtë llogari kanë kaluar pagat për periudhat 31.3.2005 – 31.12.2013 dhe 6.7.2016 – 3.3.2021. Për periudhën 2014 – qershor 2016 pagat e subjektit kanë kaluar në llogarinë e tij të pagës në Credins Bank, të cilat i ka transferuar më pas në Raiffeisen Bank. Pra, kjo depozitë ka ekzistuar në vazhdimësi për vitet 2005 – 2016.

2.3 Për sa më lart, nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë llogari.

3. Automjet tip “Golf 4”, vit prodhimi 1998, me targë *, blerë në vitin 2006 nga babai, fituar në vitin 2010 me trashëgiminë ligjore nr. ***, datë 22.6.2010, pas vdekjes së babait. Vlera: 500,000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: me trashëgimi ligjore nga babai.**

3.1 Subjekti ka deklaruar ndër vite:

- Në DIPP-në e vitit 2010: “*Bashkëpronar me 1/3 i një autoveture WV Golf 4, targa *** (vendimi nr. ***, datë 22.6.2010, i Gjykatës së Rrethit Fier), regjistruar me emrin N. N. (pas vdekjes së babait)*”.
- Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar pronësinë e plotë individuale 100% mbi automjetin tashmë me targë ***, pas dhurimit nga ish-bashkëpronarët e tjerë.

3.2 Referuar dokumentacionit⁸ që subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, rezultoi se shtetasi N. N. (babai i subjektit) ka blerë nga shitësi E. M., në datën 26.7.2006, automjetin tip “Golf 4” me targë ***, në vlerën 500,000 lekë. Ky automjet është blerë nga shtetasi E. M. në Gjermani në datën 12.6.2006, me çmimin 2,400 euro dhe është zhdoganuar në Doganën Durrës në datën 1.7.2006⁹. Në datën 22.6.2010¹⁰, trashëgimtarët ligjorë të shtetasit N. N.¹¹, bashkëshortja e tij A. N. dhe vajza e tij B. N., heqin dorë nga pjesa takuese 1/3 e pronësisë së tyre mbi automjetin në favor të bashkëpronarit tjetër, subjektit të rivlerësimit.

3.3 Nga hetimi që kreu Komisioni¹² nuk rezultoi ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit dhe shtetasit E. M..

3.4 Në pyetësin nr. 2, subjekti ka deklaruar se ky automjet është blerë nga babai i tij në vitin 2006, ku sipas certifikatës familjare subjekti nuk ishte pjesë e familjes së origjinës, nga e cila është shkëputur në datën 20.12.2005 dhe e ka përfituar automjetin si trashëgimtar¹³ pas vdekjes së babait.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 5.3.2021.

⁸ Kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 26.7.2006, e lidhur midis shitësit E. M. dhe blerësit N. N.

⁹ Vërtetim zhdoganimi nr. ***, datë 1.7.2006.

¹⁰ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 8.11.2010.

¹¹ Vendim nr. ***, datë 22.6.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së trashëgimlënësit N. N. (N. N., ndërruar jetë në datën 30.3.2010).

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 17.11.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe shkresë nr. *** prot., datë 14.11.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹³ Sipas vendimit nr. ***, datë 22.6.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë.

3.5 Nga hetimi në AMF rezulton se ky automjet është në pronësi dhe përdorim të subjektit të rivlerësimit që nga data 28.12.2016 deri më 7.2.2023.

3.6 Për sa më lart, duke qenë se Komisioni vëren se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit përputhen me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika me këtë pasuri që është krijuar nga babai i subjektit të rivlerësimit pas shkëputjes së subjektit nga trangu familjar dhe subjekti e ka fituar pronësinë mbi këtë automjet si trashëgimtar pas çeljes së dëshmisë së trashëgimisë së babait, duke mos u ngritur dyshime edhe për pasuri të fshehur të subjektit, Komisioni vlerësoi të mos hetojë më tej për mundësinë financiare të krijimit të kësaj pasurie.

4. Bashkëpronar me 5/9 pjesë e pasurisë nr. *, e llojit apartament me sip. 62.5 m². Burimi i krijimit: me trashëgimi ligjore pas vdekjes së babait.**

4.1 ZVRPP-ja Fier¹⁴ konfirmon bashkëpronësinë e subjektit mbi 5/9 pjesë të këtij apartamenti, i cili sipas certifikatës për vërtetim pronësie datë 7.6.2010 ka qenë në bashkëpronësi të prindërve të tij dhe të shtetasës Dh. N. (gjyshja e subjektit).

4.2 Sipas vendimit gjyqësor datë 22.6.2010, për çeljen e dëshmisë së trashëgimisë pas vdekjes së babait dhe gjyshes së tij, subjekti e ka fituar me trashëgimi ligjore pjesën e tij në bashkëpronësi mbi këtë pasuri.

4.3 ASHK-ja Fier konfirmon¹⁵ se ky apartament është shitur në datën 9.2.2022¹⁶ nga bashkëpronarët A., B. e Dritan Nushi tek blerësit L. e R. A., me vlerën 2,800,000 lekë, likuiduar nëpërmjet llogarisë së noterit në datën 10.2.2022.

4.4 Për sa më lart, përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e depozituar. Nuk u konstatuan problematika për këtë pasuri.

5. Në përdorim pa akt të banesës në pronësi të vjehrrit të subjektit, z. B. N., me certifikatë pronësie me nr. pasurie *, datë 13.12.2001, apartament me sip. 93 m², me adresë: rruga “****”, p. ***, shk. ***, kati ***, ap. ***, Tiranë. Vlera: 2,000,000 lekë. Burimi i krijimit:**

5.1 Referuar dokumentacionit¹⁷ që subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, rezulton se në datën 11.1.2001 shtetasi B. N. (vjehri i subjektit) ka blerë nga bashkëpronarët K. (S., S., P., H., H. e M.) apartamentin me nr. pasurie ***, me vlerë 2,000,000 lekë. Me certifikatën për vërtetim pronësie datë 13.12.2001, shtetasi B. N. figuron pronar i këtij apartamenti.

5.2 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se bashkë me bashkëshorten e tij I. N., që nga viti 2006 (në datën 1.8.2007 janë martuar zyrtarisht) deri aktualisht, përdorin shtëpinë në pronësi të vjehrrit të tij, z. B. N., e ndodhur në rrugën “****”, p. ***, h. ***, ap. ***, pallat i vjetër, pa qira (vërtetuar me deklaratën noteriale, ku shtetasi B. N.¹⁸, vjehri i tij, deklaroi se është pronar i apartamentit të lartpërmendur dhe që prej datës 13.12.2001 ia ka lënë në përdorim pa kundërshtim vajzës së tij I. N., si dhe familjes së saj; kontratën e shitblerjes dhe certifikatën e pronësisë së apartamentit, bashkëlidhur përgjigjes).

¹⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.9.2017, të ZVRPP-së Fier.

¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2023, e ASHK-së Fier.

¹⁶ Me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.2.2022, notere E. T..

¹⁷ (i) Kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 11.12.2001, e lidhur midis blerësit B. N. dhe shitësve, bashkëpronarët K. (S., S., P., H., H. e M.) para noterës Sh. K.; (ii) certifikatë pronësie datë 13.12.2001, e lëshuar nga ZVRPP Tirana 1 (bashkëlidhur harta treguese dhe kartela e pasurisë).

¹⁸ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.7.2020, e shtetasit B. N..

5.3 FSHU-ja konfirmon¹⁹ se në emër të shtetasit B. N. figuron e lidhur në datën 10.2.1998 kontrata familjare e furnizimit me energji elektrike nr. *** Tiranë, por nuk ka ID bashkëlidhur dhe nga verifikimi në vend nuk rezulton të jetojë njeri në banesë. FSHU-ja ka depozituar²⁰ pranë Komisionit të dhëna mbi konsumin dhe pagesat e energjisë elektrike për periudhën shkurt 2007 – tetor 2023, nga ku rezulton se ka konsum në mënyrë konstante e të vazhdueshme për këtë periudhë. Në pyetësin nr. 7, subjekti i rivlerësimit nga ana e tij ka sqaruar se kjo kontratë e lidhur me FSHU-në i përket apartamentit nr. ***, ku ai jeton.

5.4 Referuar faktit që subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar pasurinë në rrugën “****”, p. ***, hyrja ***, ap. ***, në deklaratën *Vetting*, si dhe referuar marrëdhënies së huapërdorjes pa kundërshtim që subjekti ka me vjehrin e tij për përdorimin e kësaj pasurie, atëherë sipas nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vlerësuar që vjehri i subjektit (edhe vjehra për efekt të pasurisë bashkëshortore) të konsiderohen “persona të tjerë të lidhur” me subjektin e rivlerësimit, duke pasur detyrimin që të provojnë burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

Analiza për mundësitë financiare të krijimit të apartamentit me sip. 93 m², ku banon pa kundërshtim subjekti i rivlerësimit

5.5 Në pyetësin nr. 2, subjekti ka deklaruar²¹ se apartamenti me sip. 93 m² është blerë nga vjehri i tij B. N. në datën 11.12.2001, në vlerën 2,000,000 lekë, me: (i) të ardhurat nga puna e tij në shtet²² deri në vitin 1991; (ii) të ardhurat dhe fitimet nga firma e tij e ndërtimit “****” sh.p.k.; (iii) të ardhurat nga puna e vjehrrës si stomatologe në shtet e më pas në aktivitet privat si stomatologe në Elbasan.

5.6 Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti ka depozituar dokumentacion provues si vijon:

*i) Në lidhje me aktivitetin e shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k.:* (a) vendim datë 23.2.1995, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për regjistrimin e shoqërisë “****” sh.p.k., si person juridik, me aktivitet në fushën e ndërtimit të veprave civile e industriale; (b) certifikatë regjistrimi të shoqërisë “****” sh.p.k. në organin tatimor, datë 22.2.1994; (c) licencë nr. ***, datë 28.9.2006, për subjektin “****”, me drejtues ligjor e teknik B. N., dhënë nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (në vijim MPPTT); (ç) licencë nr. ***, datë 28.9.2006, dhënë shtetasit B. N. si ing. mekanik nga MPPTT-ja; (d) certifikatë e numrit të identifikimit për personin e tatueshëm “****”, me NIPT ***, datë 26.1.2001; (dh) certifikatë regjistrimi për TVSH-në e personit të tatueshëm “****”, me NIPT ***, datë 26.1.2005; (e) kontratë punësimi nr. ***, datë 29.1.2001.

ii) Në lidhje me aktivitetin e vjehrrës si stomatologe në Elbasan, fillimisht në shtet e më pas në aktivitet privat: (a) vërtetim nga QKB-ja datë 5.9.2017, që vërteton se personi fizik “P. N.”, me NIPT ***, ka aplikuar për çregjistrim; (b) vërtetime datë 13.8.2002, 27.2.2004 dhe 31.1.2005 nga Bashkia Elbasan, që vërtetojnë se subjekti klinikë dentare “P. N.” ka paguar taksat lokale të vitit 2002, 2004 e 2005; (c) vërtetim datë 30.1.2007 nga DRT Elbasan, që vërteton se subjekti “P. N.” ka paguar detyrimet tatimore, sigurimet shoqërore dhe taksat vendore për vitin 2006; (ç) mandatarëtime nga Bashkia Elbasan dhe posta, që provojnë se subjekti “P. N.” ka paguar taksat lokale për vitet 2007 – 2013 e 2016 – 2017; (d) NIPT i subjektit “P. N.”; (dh) licencat datë 31.3.2005 dhe datë 9.3.2007, dhënë shtetas P. N. për ushtrimin e profesionit ndihmësmjek

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 14.5.2021, e FSHU-së drejtuar Komisionit.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 10.11.2023, e FSHU-së drejtuar Komisionit.

²¹ Përgjigja nr. 1/a e pyetësin nr. 2.

²² Si drejtor i Ndërmarrjes së Ndërtimit në Kombinatin *** Elbasan.

stomatolog; (e) mandatarkëtime të Drejtorisë së Tatim Taksave, Bashkia Elbasan, për pagesën e taksave vendore dhe tatimit për biznesin e vogël për periudhën 2002 – 2016²³; (ë) certifikatë regjistrimi në organin tatimor për vitin 2007 të personit fizik P. N. “Ndihmës dentiste”, me NIPT ***.

5.7 Meqenëse në dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit në pyetëtorin nr. 2, për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të apartamentit objekt shqyrtimi, mungon informacioni për të ardhurat e krijuara nga shtetasi B. e P. N. nga punësimi i tyre në shtet deri në vitin 1991, por kursimet e mundshme të kësaj periudhe janë në një vlerë të pakonsiderueshme për shkak të nivelit të ulët të pagave të asaj periudhe, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë në përlllogaritje as shpenzimet jetike për këtë periudhë.

5.8 QKB-ja konfirmon²⁴ se shtetasi B. N. ka qenë administrator dhe ortak 50% (F. L. 50%) i shoqërisë “****” sh.p.k. me NIPT ***, regjistruar në datën 22.2.1994 dhe çregjistruar në datën 6.6.2014. Shtetasi B. N. figuron i regjistruar me vendim nr. ***, datë 6.7.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan si person fizik, por nuk gjendet NIPT.

5.9 DPTatimeve konfirmon²⁵ se shtetasi B. B. N. rezulton i regjistruar si administrator i subjektit “****”, me NIPT ***, në datën 26.1.2001 dhe i çregjistruar në datën 6.6.2014. Nuk është subjekt i deklaramit të të ardhurave vjetore.

5.10 DRSSH-ja Elbasan²⁶ konfirmon të ardhurat nga punësimi të shtetasit B. N. të periudhës maj 1994 – prill 2008, në shumën neto 1,782,720 lekë.

5.11 DRTatimore Elbasan²⁷ konfirmon se shtetasi B. N. për vitet 1994 – 2001 është regjistruar me kod fiskal *** dhe nga dokumentacioni i përcjellë nuk mund të konkludohet një e dhënë e saktë mbi të ardhurat e deklaruara, fitimet/humbjet e realizuara, pagesat për sigurimet, tatimin mbi të ardhurat personale, tatimin në burim, tatimin mbi dividendin për vitet 1994 – 2001.

5.12 DRTatimore Elbasan²⁸ konfirmon se subjekti “****” sh.p.k. me NIPT *** është regjistruar në organin tatimor në datën 26.1.2001 si person juridik dhe rezulton me status i çregjistruar, me datë 6.6.2014. Nga deklaramet e subjektit “****” sh.p.k. në sistemin C@TS²⁹ nuk rezulton të kenë realizuar të ardhura për vitin 2001 dhe nuk ka derdhur tatim mbi dividendin, ndërsa subjekti “P. N.”, person fizik, me NIPT ***, është regjistruar në organin tatimor në datën 11.4.2006. Nga deklaramet e subjektit në sistemin C@TS³⁰ nuk rezultojnë të dhëna tatimore para vitit 2006.

5.13 Në vijim, në lidhje me personin fizik “P. N.”, nga hetimi ka rezultuar se Bashkia Elbasan³¹ konfirmon që ky person fizik, me NIPT ***, ka qenë regjistruar si subjekt me aktivitet “Ndihmës dentiste” dhe është çregjistruar në datën 11.12.2017. Bashkia Elbasan (Drejtoria e Tatimeve,

²³ Mandatarkëtimet nr. ***, datë 13.8.2002; nr. ***, datë 27.2.2004; nr. ***, datë 31.1.2005; nr. ***, datë 15.3.2006; nr. *** dhe nr. ***, datë 11.4.2007; nr. ***, datë 9.7.2007; nr. ***, datë 14.1.2008; nr. ***, datë 17.4.2008; nr. ***, datë 17.4.2008; nr. ***, datë 14.7.2008; nr. ***, datë 7.10.2008; urdhër pagesë nr. ***, datë 9.1.2009; nr. ***, datë 9.1.2009; nr. ***, datë 7.1.2010; nr. ***, datë 10.1.2011; nr. ***, datë 17.2.2012; faturë arkëtimi nr. ***, datë 20.2.2013; nr. ***, datë 5.3.2014; pagesat e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2015; nr. ***, datë 6.4.2016.

²⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.2.2021, të QKB-së.

²⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.2.2021, të DPTatimeve.

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 10.11.2022, drejtuar Komisionit.

²⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 9.2.2023, e DRTatimore Elbasan drejtuar Komisionit.

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2022, e DRTatimore Elbasan.

²⁹ Subjekti “****” ka depozituar deklaramet e tatimit mbi fitimin për periudhën 2002 – 2012, gjatë së cilës subjekti ka rezultuar me 284,996 lekë fitim në vitin 2003 dhe 23,726 lekë fitim në vitin 2005; ka rezultuar me humbje në vitet 2004, 2006 e 2007 dhe nuk ka realizuar të ardhura (nuk ka kryer aktivitet) për vitet e tjera të periudhës 2002 – 2012.

³⁰ Personi fizik “P. N.” ka depozituar deklaramet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe deklaramet e pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël, periudha 2006, 2011 – 2017.

³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 25.11.2022, e Bashkisë Elbasan.

Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave) ka qenë autoritet pranë të cilit raportohej për xhiron e deklaruar për periudhën para vitit 2013. Për periudhën 2006 – 2012, subjekti ka deklaruar pranë bashkisë qarkullim vjetor të deklaruar (në vijim QVD) dhe qarkullim vjetor të parashikuar (në vijim QVP): viti 2006/QVD dhe QVP = 1,500,000 lekë; viti 2007/QVP = 1,500,000 lekë; vitet 2008 – 2009/QVP = 1,800,000lekë; vitet 2010 – 2011/QVD = 1,800,000 lekë; viti 2012/QVP = 314,376 lekë. Në vijim, Bashkia Elbasan (Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave) konfirmon se nuk është autoriteti kompetent për të dhënat tatimore (të ardhurat, fitimet, pagesat për sigurimet, tatimin mbi të ardhurat personale, tatimin në burim etj.)

5.14 DRSSH-ja Elbasan konfirmon³² se personi fizik “P. N.” nuk rezulton në indeksin e personave fizikë Elbasan për periudhën 1994 – 2004, por për periudhën prill 2006 – dhjetor 2011 ka realizuar të ardhura (paga) mbi bazën e të cilave ka derdhur kontribute.

5.15 Në përfundim, Komisioni vëren se dokumentacioni justifikues për të ardhurat nga aktivitetet private nuk është relevant për burimin e krijimit të apartamentit që ka blerë shtetasi B. N. në shumën 2,000,000 lekë, në datën 11.12.2001, pasi i përket periudhës pas datës së blerjes së apartamentit, ndërsa të ardhurat e përfituara nga pagat për periudhën 1994 – 2001 janë të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet dhe për të blerë apartamentin.

5.16 Komisioni analizoi³³ treguesit financiarë të prindërve të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Shpenzimet jetike për periudhën 1994 – 1999 janë përllogaritur sa 66% e të ardhurave, ndërsa për periudhën 2000 – 2001 janë përllogaritur sipas të dhënave të INSTAT-it për përbërjen familjare me 4 anëtarë³⁴.

5.17 Për sa më lart, duket se personat e tjerë të lidhur (vjeherri dhe vjehera) me subjektin e rivlerësimit nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për të blerë apartamentin që i kanë lënë në përdorim subjektit, pasi rezultojnë me balancë negative në shumën -2,096,891 lekë.

Komisioni mban në konsideratë se kjo është një pasuri e krijuar para martesës së subjektit të rivlerësimit dhe para se ai të emërohej në detyrën e prokurorit, si dhe nuk ka asnjë lidhje me familjen e tij të origjinës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë konstatim

5.18 Në prapësimet e tij, subjekti ka dhënë disa shpjegime lidhur me këtë konstatim. Fillimisht, për sa i takon përcaktimit që Komisioni i ka bërë vjeherit dhe vjeherës së subjektit si “persona të tjerë të lidhur”, subjekti ka sjellë në vëmendje se Kolegji në disa vendime të tij ka mbajtur qëndrimin se: *“Sipas përkufizimit të dhënë në pikën 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, që një person fizik ose juridik të konsiderohet si “person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit”, duhet që të provohet një lidhje interes mes tyre, e cila duhet të rrjedhë nga: i) një interes pasuror; ose ii) çdo marrëdhënie tjetër biznesi. ...lidhja e interesit që rrjedh nga një interes pasuror është trajtuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet në mënyrë specifike se cilat marrëdhënie do të përfshihen në sferën e interesit pasuror. Pra, interesi pasuror duhet të jetë një marrëdhënie dhurimi, huamarrjeje ose huadhënieje ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe një personi fizik ose juridik. Në zbatim të këtij kuadri ligjor, subjekti i rivlerësimit për efekt të procesit të rivlerësimit*

³² Shkresë nr. *** prot., datë 4.1.2023.

³³ Gjatë viteve 1994 – 2001: të ardhura 934,179 lekë (500,869 të ardhura nga paga B. N. + 0 lekë të ardhura nga paga e P. N. + 0 lekë të ardhura nga aktiviteti privat “***”) + 433,310 lekë të ardhura nga paga I. N.); detyrime 0 (zero) lekë; shpenzime 1,031,070 lekë; pasuri apartament i blerë në datën 11.12.2001, me vlerë 2,000,000 lekë; të ardhura + detyrime - shpenzime - pasuri = - 2,096,891 lekë.

³⁴ Shihni certifikatën e përbërjes familjare të depozituar në pyetësoin nr. 2.

detyrohet të provojë burimin e ligjshëm të pasurisë së personit tjetër të lidhur, për pasurinë e përfshirë në marrëdhënien e konfirmuar të dhurimit apo huas”.

5.19 Në lidhje me pamundësinë e vjehrrit dhe vjehrrës për të pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e apartamentit që i kanë lënë në përdorim subjektit, pasi rezultojnë me balancë negative në shumën -2,096,891 lekë, subjekti në prapësimet e tij ka dhënë të njëjtat shpjegime dhe ka përmendur të njëjtat prova që ka paraqitur në pyetësorë gjatë hetimit administrativ. Gjithashtu, në lidhje me shkresën³⁵ e DRT-së Elbasan që Komisioni ka administruar gjatë hetimit si provë, sipas së cilës për shtetasin B. N., për vitet 1994 – 2001, i regjistruar me kod fiskal ***, nuk mund të konkludohet një e dhënë e saktë mbi të ardhurat e deklaruara, fitimet/humbjet e realizuara, pagesat për sigurimet, tatimin mbi të ardhurat personale, tatimin në burim, tatimin mbi dividendin për vitet 1994 – 2001, subjekti shpjegon se është në kushtet e pamundësisë absolute të provueshmërisë me dokumentacion ligjor justifikues të të ardhurave të vjehrrit, pasi ky i fundit nuk rezulton as subjekt i deklaramit të të ardhurave vjetore, e dokumentuar kjo edhe nga Komisioni që nga viti i regjistrimit 1994 deri në vitin 2014, vit i çregjistrimit dhe mbylljes së aktivitetit, ndërkohë që sipas vjehrrit, shoqëria ka punuar të paktën për 20 vjet. Në këto kushte, për këto të ardhura subjekti kërkon të aplikohet parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit.

Vlerësimi i Komisionit

5.20 Komisioni, pasi mori në analizë dokumentacionin e siguruar përgjatë hetimit, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, argumenton dhe vlerëson se: apartamenti i banimit me nr. pasurie ***, me sip. 93 m², adresa rruga “****”, p. ***, shk. ***, kati ***, ap. ***, Tiranë, është blerë nga shtetasi B. N. në datën 13.12.2001, shumë kohë përpara se subjekti i rivlerësimit të martohej me vajzën e z. N., shtetasen I. N.; shtetasi B. N. ka deklaruar se këtë apartament që kur e ka blerë ia ka lënë në përdorim vajzës së tij, e cila kishte filluar punë në Tiranë, pra shumë kohë përpara se ajo të lidhte martesë me subjektin e rivlerësimit; subjekti i rivlerësimit është martuar me shtetasen I. N. në datën 1.8.2007 dhe është bërë përdorues i këtij apartamenti (që prej muajit dhjetor 2006) për shkak të lidhjes në martesë me shtetasen I. N. dhe jo për shkak të një marrëdhënieje direkte me shtetasin B. N., për më tepër që kjo pasuri është krijuar edhe përpara se subjekti i rivlerësimit të emërohej në detyrën e prokurorit.

5.21 Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se nuk u gjet asnjë element që të ngrihen dyshime se kemi të bëjmë me një pasuri të fshehur apo të investuar nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe e personit të lidhur me të. Gjithashtu, bazuar në argumentet e pasqyruara në pikën më lart, Komisioni vlerëson të mos ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në lidhje me pamundësinë financiare prej -2,096,891 lekësh të vjehrrit dhe vjehrrës për të blerë me burime të ligjshme financiare apartamentin që i kanë lënë në përdorim vajzës së tyre dhe subjektit për shkak martesë, duke mbajtur në konsideratë edhe parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit.

➤ **Në lidhje me apartamentin shtesë + papafingo (dupleks) në pronësi të shtetasit B. N., të ndërtuar mbi apartamentin ekzistues (të trajtuar më lart), po në pronësi të këtij shtetasi**

5.22 Në pyetësorin nr. 7, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit që të shpjegojë e provojë me dokumentacion ligjor se ku ka banuar vjehrrin i tij që nga data 13.12.2001 deri aktualisht.

5.23 Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se vjehrrin dhe vjehrra e tij jetojnë në Elbasan, në lagjen “****”, pallati ***, shkalla ***, kati ***, apartamenti ***, me sip. 67.2 m², i ndërtuar para viteve

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 9.2.2023, e DRTatimore Elbasan.

‘90 dhe i fituar me privatizim³⁶, pasi aty kanë të afërmit dhe bizneset. Apartamentin nr. 27, me sip. 93 m², vjehri e bleu me qëllim për të siguruar një banesë ku të jetonte vajza e tyre I. N., e cila pas përfundimit të studimeve për drejtësi u punësua në Tiranë. Pas datës 28.1.2015, për shkak të distancës së afërt dhe mundësisë për t’u kujdesuar për fëmijët e subjektit dhe fëmijët e kumatës së tij, ata jetojnë edhe në apartamentin nr. ***, shtesë + papafingo (dupleks), mbi apartamentin ku banon familja e subjektit të rivlerësimit.

5.24 Subjekti e ka konfirmuar përdorimin e apartamentit shtesë + papafingo nga ana e vjehrit dhe vjehrrës edhe në pyetësonin nr. 4, duke shpjeguar se banimi ka filluar pas përfundimit të punimeve dhe në apartamentin shtesë as subjekti i rivlerësimit e as ndonjë anëtar i familjes së tij nuk ka asnjë përfitim, nuk e kanë përdorur ndonjëherë dhe nuk kanë kontribuar në ndërtimin e tij.

5.25 Nga korrespondenca me ASHK-në³⁷ rezulton se mbi apartamentin me sip. 93 m², që përdor subjekti i rivlerësimit, vjehri i tij ka ngritur një apartament dupleks me sipërfaqe totale 153.30 m², i përbërë nga 1 kat shtesë me sip. 80.60 m² dhe papafingo me sip. 72.70 m². Apartamenti me sipërfaqe totale 153.30 m² është legalizuar me leje legalizimi datë 12.1.2015 dhe është regjistruar në pronësi të shtetasit B. N. në ZVRPP-në Tiranë, në datën 28.1.2015, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, adresa rruga “****”, Njësia Bashkiake nr. ***. Kërkesa për legalizimin e ndërtimit shtesë është bërë nga shtetasi B. N. sipas formularit datë 27.6.2013, ndërsa tarifa e shërbimit prej 16,000 lekësh për ALUIZNI-n është paguar nga subjekti i rivlerësimit sipas mandatit bankar datë 12.1.2015 në Raiffeisen Bank, në emër të shtetasit B. N..

5.26 ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri konfirmon³⁸ se në pallatin me adresë në rrugën “****”, z. k. ***, shtetasi B. N. ka vetëm dy apartamente të regjistruara me nr. pasurie ***, vol. ***, f. *** dhe nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***.

5.27 Referuar edhe përgjigjeve nga ASHK Drejtoritë Vendore Tiranë³⁹, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të tyre dhe as janë vetëdeklarues për legalizim të ndërtimeve pa leje.

5.28 FSHU-ja (OSHE) konfirmon⁴⁰ se në emër të shtetasit B. N. figuron e lidhur në datën 1.7.2013 kontrata familjare nr. ***, e cila sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit⁴¹ i përket apartamentit shtesë kati + papafingo (dupleks) mbi objektin ekzistues, pa numër apartamenti të regjistruar në akt dhe i regjistruar në ZVRPP në datën 28.1.2015 në pronësi 100% të vjehrit të tij. Për të provuar këto shpjegime, subjekti ka depozituar në pyetësonin nr. 6 edhe dokumentacionin⁴² e administruar nga FSHU-ja.

³⁶ Bashkëlidhur certifikata e pronësisë së këtij apartamenti, i regjistruar në z. k. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, në emër të shtetasit B. N..

³⁷ Me shkresat nr. *** prot., datë 17.3.2021, të ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Jug dhe nr. *** prot., datë 18.3.2021, të ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri, konfirmojnë se shtetasi B. N. figuron aplikues për legalizim të ndërtimit pa leje (Form *** prot., ***, datë 28.6.2013, Tiranë) dhe është pajisur me leje legalizimi nr. ***, datë 12.1.2015, për shtesën 1 kat + 1 kat papafingo mbi objektin ekzistues 1 kat në zonën Tirana Rurale 2, si dhe ka depozituar praktikën përkatëse të legalizimit.

³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 3.11.2023, e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri, depozituar nga subjekti i rivlerësimit në pyetësonin nr. 7, përgjigja nr. 5.

³⁹ Shkresat: nr. *** prot., datë 15.11.2023, e ASHK Kamëz-Vorë; nr. *** prot., datë 3.11.2023, e ASHK Tirana Rurale 2; nr. *** prot., datë 2.11.2023, e ASHK Zonat e Stimuluara; nr. *** prot., datë 20.11.2023, e ASHK Drejtoria e Përgjithshme; nr. *** prot., datë 22.11.2023, e ASHK Drejtoria Vendore Durrës; nr. *** prot., datë 5.12.2023, e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1.

⁴⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2021, të FSHU-së.

⁴¹ Përgjigja nr. 8 e pyetësonit nr. 2.

⁴² Librezhë e dritave në emër të shtetasit B. N., me pagesa që nga janari 2021 deri në gusht 2023; praktikë e lidhjes së kontratës nga FSHU-ja, ku në kartelën e furnizimit me energji elektrike është shënuar adresa: rruga “****”, pallati ***, data e instalimit të matësit 6.4.2013, si dhe lista e pagesave të konsumit që nga qershori 2013 – 2023.

5.29 Në lidhje me kohën e ndërtimit të apartamentit shtesë, në pyetësonin nr. 4, subjekti shpjegoi se ai është ndërtuar në vitet 2009 – 2010, por nuk ka paraqitur dokumentacion që provon këtë fakt.

5.30 ASIG-u ka dërguar⁴³ ortofoto të pallatit ku banon subjekti i rivlerësimit, me pamje të viteve 2007 dhe 2015, nga ku rezulton se në vitin 2007 pallati ka tarracë, ndërsa në vitin 2015 ka çati të kuqe njësoj si pamjet me çati të pallatit që ka depozituar ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug⁴⁴. Këto pamje krijojnë bindjen se mbi tarracën e pallatit nr. *** janë bërë shtesa në periudhën 2008 – 2015, pra brenda periudhës 2009 – 2010 që deklaroi subjekti i rivlerësimit.

5.31 Gjatë hetimit ka rezultuar se sipas kontratës së qirasë datë 3.7.2014 me afat 1-vjeçar dhe kontratës së huapërdorjes datë 10.9.2015⁴⁵ me afat 1-vjeçar, apartamenti nr. 25, rruga “***”, p. ***, shk. ***, në pronësi të vjehrrit të subjektit, është dhënë me qira nga vjehri, për dy vjet rresht në favor të personave të tjerë kundrejt shumës 35,000 lekë/muaj. Gjithashtu, bashkëshortja e subjektit deklaroi si adresë në Union Bank apartamentin nr. 25, rruga “***”, p. ***, shk. ***. Nga ana tjetër, në DIPP-në e viteve 2005 – 2008 dhe 2010 – 2012 subjekti deklaroi si adresë banimi rrugën “***”, p. ***, shk. ***, ap. ***, ndërsa në DIPP-në e vitit 2013 deklaroi rrugën “***”, p. ***, shk. ***, ap. ***.

5.32 Në lidhje me apartamentet e deklaruara me numra të ndryshëm si më lart, Komisioni ka pyetur subjektin⁴⁶ nëse vjehri i tij disponon ose jo apartamente të tjerë në pallatin nr. ***. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar⁴⁷ se deri në datën 28.1.2015 vjehri ka pasur në pronësi vetëm apartamentin nr. 27 në rrugën “***”, p. ***, hyrja ***, ku banon subjekti. Prej datës 28.1.2015 vjehri disponon me certifikatë pronësie një apartament shtesë kati + papafingo (dupleks), që gjatë kohës që ishte në proces legalizimi vjehri e ka dhënë me qira 1-vjeçare tek persona të tretë dhe meqenëse ai nuk kishte ende numër dhe as certifikatë pronësie, vjehri ka paraqitur para noterit dokumentacionin e apartamentit nr. 27. Pra, noteri ka bërë lapsus duke shënuar nr. 25 tek kontrata e parë dhe e ka përsëritur *copy-paste* në kontratën e dytë. Apartamenti nr. 22 i ndodhur në katin e dytë dhe apartamenti nr. 25 i ndodhur në katin e katërt poshtë apartamenti nr. 27 janë në pronësi të shtetasve të tjerë. Për deklarimin e apartamentit nr. 22 në DIPP-në e viteve 2005 – 2008 dhe 2010 – 2012 dhe apartamentit nr. 11 në DIPP-në e vitit 2013 nga ana e subjektit, si dhe të apartamentit nr. 25 nga ana e bashkëshortes, subjekti shpjegon se janë lapsuse. Për të provuar këto shpjegime, subjekti ka depozituar këto dokumente: faturat e UKT-së datë 28.10.2022, 28.8.2022 dhe 28.10.2022, që provojnë respektivisht se apartamenti nr. 22, kati 2, i përket shtetasit F. R. T., apartamenti nr. 25, kati 4, i përket shtetasit V. G. dhe apartamenti nr. 27 i përket shtetasit B. N.; certifikatë pronësie datë 28.1.2015 nga ZVRPP-ja Tiranë, që provon se apartamenti me sip. 153.30 m² në rrugën “***”, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. *** është në pronësi të shtetasit B. N., regjistruar me leje legalizimi nr. ***, datë 12.1.2015.

5.33 Për sa më lart, duke mbajtur parasysh faktet se: (i) apartamenti shtesë është ndërtuar kur subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij banonin në apartamentin me sip. 93 m², që i ka lënë vjehri në përdorim, ndërkohë që vetë vjehri banonte në Elbasan dhe u shpërngul në Tiranë në vitin 2015, çka duket se ky i fundit ka jetuar diku tjetër dhe nuk ka pasur nevojë të ngutshme për ndërtimin e apartamentit shtesë; (ii) vjehri nuk ka deklaruar dhe vërtetuar se e përdor apartamentin shtesë; (iii) tarifa e shërbimit për ALUIZNI-n është paguar nga subjekti i rivlerësimit; (iv) prokurën

⁴³ Me shkresën nr. *** prot., datë 1.11.2023, e ASIG-ut drejtuar Komisionit.

⁴⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 17.3.2021, e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug drejtuar Komisionit.

⁴⁵ Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.7.2014 (qiramarrës E. P. e Xh. Sh.) dhe kontratë huapërdorjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.9.2015 (qiramarrës N. M.), të nënshkruara nga shtetasja I. N. si përfaqësuese me prokurën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.7.2014, ku autorizohet të kryejë çdo veprim me këtë pronë, administruar nga notere E. T. me shkresën datë 12.4.2021.

⁴⁶ Pyetja nr. 2 e pyetësonit nr. 2.

⁴⁷ Përgjigjet nr. 3 dhe nr. 4 të pyetësonit nr. 2.

datë 3.7.2014 vjehri i subjektit të rivlerësimit ia ka dhënë vajzës së tij (bashkëshortes së subjektit) për të disponuar apartamentin nr. 25 që ka sipërfaqe 93 m², sa sipërfaqja e apartamentit ku banon subjekti i rivlerësimit dhe jo për apartamentin shtesë me sip. 153.3 m²; (v) kontrata e qirasë datë 3.7.2014 dhe kontrata e huapërdorjes datë 10.9.2015 janë lidhur për apartamentin nr. 25 me sip. 93 m² dhe në këto kontrata është cituar se qiramarrësit do të paguajnë energjinë elektrike në numrin e kontratës së furnizimit me energji elektrike *** Tiranë, kontratë kjo që i përket apartamentit që përdor subjekti i rivlerësimit; (vi) subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka asnjë kontribut financiar në krijimin e apartamentit shtesë dhe as nuk ka ndjekur punimet e kryera, madje aplikimi dhe procedura e legalizimit, si dhe certifikata e pronësisë janë bërë në emër të vjehrit të tij – Komisioni ngre dyshime se apartamenti shtesë mund të jetë pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit dhe e personit të lidhur me të, e regjistruar në emër të vjehrit të tij.

5.34 Nisur nga deklarimi i subjektit të rivlerësimit në pyetësorë, si dhe bazuar në formularin e vetëdeklarimit për legalizim datë 27.6.2013 ku deklarohet ndërtim i përfunduar, Komisioni do të konsiderojë si periudhë investimi për apartamentin shtesë me sip. 153.3 m² periudhën 2009 – 2013. Për sa i përket vlerës së apartamentit shtesë, Komisioni ka përllogaritur vlerën e saj duke u bazuar në koston mesatare të ndërtimit për vitet 2009 – 2013 referuar EKB-së⁴⁸ dhe sipërfaqes së shtesës prej 153.3 m². Nga kjo përllogaritje rezulton se vlera e shtesës është 4,465,384 lekë.

5.35 Komisioni, nisur nga faktet e renditura më lart dhe vlera e përllogaritur prej 4,465,384 lekësh për ndërtimin e apartamentit shtesë, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës që të provojë burimin e ligjshëm financiar të krijimit të apartamentit shtesë me sip. 153.3 m² në vlerën 4,465,384 lekë, si dhe të provojë tej çdo dyshimi që nuk ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, dhe pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë konstatim

5.36 Në lidhje me vlerën 4,465,384 lekë të përllogaritur nga Komisioni për ndërtimin e apartamentit shtesë dhe papafingo, në periudhën 2009 – 2013, të vlerësuar nga Komisioni bazuar në hetimin e kryer, subjekti ka shpjeguar në prapësime, njëlloj si gjatë hetimit⁴⁹, se ndërtimi është kryer në vitet 2009 – 2010, por nuk disponon dokumentacion sepse janë ndërtuar në mënyrë informale dhe sipas deklarimeve të vjehrit ka shpenzuar rreth 1,700,000 lekë për ndërtimin e kësaj shtese, pasi shpenzimet kanë qenë minimale, sipas mundësisë për kursim ndër vite dhe materialeve që siguronte në ndërtimet e tjera që kryente.

5.37 Për të kundërshtuar barrën e provës së ngarkuar nga Komisioni, për sa i përket koston së ndërtimit të shtesës, subjekti ka shpjeguar në prapësime se shtesa dhe papafingoja nuk janë ndërtim standard, për shkak të karakteristikave të veçanta e të përgjithshme që paraqesin. Bashkëlidhur, subjekti ka depozituar raport-vlerësimin teknik të datës 9.1.2024 të ekspertes S. M..

5.38 Sipas këtij raporti, ekspertja konstaton se fillimisht janë bërë punime me leje të dhënë nga Bashkia Tiranë për rregullim e izolim të tarracës së amortizuar, e cila përcillte tek apartamentet poshtë saj lagështirën e krijuar nga depozitat e shumta të ujit të vendosura mbi tarracë (evidentuar edhe nga këqyrja që ekspertja i bëri tarracës së parikonstruktuar në hyrjen tjetër të pallatit). Pavarësisht këtij izolimi, kishte sërish probleme. Për këto arsye, shtetasi B. N. u dakordësua me fqinjën e tij në të njëjtin kat, shtetasin S. C., dhe ndërtuan shtesë kati me material të lehtë metalik dhe *sandwich*. Sipas investitorit B. N., punimet që filluan në vitin 2009 dhe përfunduan në vitin

⁴⁸ Udhëzim nr. 1, datë 20.8.2008, nr. 3, datë 3.2.2010, nr. 4, datë 23.11.2011 dhe nr. 1, datë 8.5.2013, për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit “k”.

⁴⁹ Në përgjigje të pyetësorit nr. 4.

2010 janë kryer nga shoqëria “****” sh.p.k. me punëtorët dhe mjetet e saj, duke punuar në periudha të ndryshme kohore me ndërprerje midis tyre. Sipas vëzhgimit të bërë nga ekspertja, është konstatuar se shtesa është ndërtuar me materialet e ndërtimit që investitorit i tepronin nga punimet e ndryshme që ai bënte nëpër ndërtimet e reja dhe rikonstruksione të objekteve të tjera. Nga këqyrja në vend e apartamentit duket se këto materiale janë marrë para se të prisheshin ndërtesat e tjera të përdorura më parë, ndërsa sipas deklarimeve të shtetasit B. N. materialet janë marrë nga tregu i pajisjeve të përdorura ose nga ndërtesa që i ka demoluar apo rikonstruktuar ai vetë, për të cilat nuk lëshohen dëftesa tatimore shitjeje. Me sy të lirë, ekspertja ka konstatuar se asnjë element derë - dritare në këtë shtesë kati nuk është njësoj në madhësi, material, funksion dhe ngjyrë (fakt ky që provohet edhe nga fotot bashkëlidhur raportit teknik). Konstruksioni i objektit është metalik me kolona metalike, mbuluar me kapriatë metalike dhe lloji i mbulesës është panel *sandwich*.

5.39 I pyetur nga ekspertja, shtetasi B. N. ka shpjeguar se kostoja e harxhuar për ndërtimin e pjesës së shtesës në pronësi të tij nuk e kalonte shumën 1,700,000 lekë në atë kohë dhe po kaq ka harxhuar edhe fqinji i tij S. C..

5.40 Në lidhje me apartamentin shtesë me sip. 80.60 m², sipas përlllogaritjeve në raportin e vlerësimit teknik, duke iu referuar udhëzimit nr. 1, datë 20.8.2008 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB për vitin 2008”, si dhe faktit që apartamenti shtesë është ndërtuar me material të lehtësuar në konstruksion metalik, me kolona metalike, kapriatë metalike, gips, mbulesë *sandwich* dhe shkallë druri, pa përdorur tulla, beton, suva e fino (duke ulur 30% çmimin referencë të EKB-së), ekspertja ka konkluduar se kostoja e ndërtimit të apartamentit shtesë me sip. 80.60 m² është 1,548,108 lekë.

5.41 Subjekti i rivlerësimit nga ana e tij në prapësime i është referuar edhe vendimit nr. 6, datë 17.3.2022, paragrafi 14.8 i Kolegjit, që ka mbajtur qëndrimin se nga çmimi i EKB-së duhet të zbriten elementet e fitimit të planifikuar dhe fondit rezervë, që janë në masën 10% e kostos së ndërtimit. Gjithashtu, duhet të mbahet parasysh konstruksioni i ndërtimit dhe elementet që janë përdorur për ndërtimin shtesë. Jo në çdo rast kostoja e ndërtimit është ajo e përcaktuar nga EKB-ja, pasi ndryshon baza e përlllogaritjes, lloji i ndërtimit ndërmjet ndërtimeve të kryera nga EKB-ja dhe ndërtimit shtesë të kryer nga prindërit e bashkëshortes.

5.42 Në lidhje me koston e ndërtimit të papafingos me sip. 72.70 m², në raportin e vlerësimit teknik argumentohet se në periudhën e ndërtimit të tij nuk ka pasur referenca për përcaktimin e kostove të ndërtimit për objektin papafingo, prandaj janë marrë në analizë raste të objekteve që nuk përlllogariten me koston e plotë të ndërtimit, siç janë karabinaja apo garazhi, për të dalë në një vlerësim më të përafërt dhe të saktë të kostos së objektit papafingo.

5.43 Referuar udhëzuesit për zbatimin e VKM-së nr. 173, datë 29.3.2006 “Për miratimin e kostos minimale fiskale në ndërtim dhe për mënyrën e përcaktimit të çmimit të shitjes së banesave”, si dhe marrëveshjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë, parashikohet se në praktikë kërkohet analizë më e thellë e strukturës dhe e kostove të ndërtimit, sipas fazës së ndërtimit të objektit, duke paraqitur një orientim për përcaktimin e kostos së ndërtimit të garazheve për qëllime fiskale, përafërsisht sa ½ e kostos për metër katror të ndërtimit të përfunduar, të cilit i përket ky garazh. Pra, kostoja e një ndërtimi të tipit garazh, të cilit i mungojnë shumë elemente strukturore në raport me një objekt të përfunduar banesë, për të cilin EKB-ja përcakton çmime referencë, është pa dyshim e ndryshme dhe duhet të trajtohet si e tillë edhe për qëllime fiskale, diferencë e cila orientohet të jetë në masën 50% të çmimit referues.

5.44 Papafingoja me sip. 72.70 m² është shumë e ulët dhe mund të qëndrohet vetëm duke përkulur plotësisht trupin dhe kokën, ka funksion “depo”, nuk ka mure ndarëse, nuk ka investim në pajise

elektrike dhe hidraulike, prandaj për këto arsye kostoja e ndërtimit nuk mund të merret sa kostoja e EKB-së. Kostoja e ndërtimit për këtë sipërfaqe është përlllogaritur 797,926.12 lekë (60% më pak se çmimi referencë 10,975.6 lekë i EKB-së, duke marrë parasysh që është material i lehtësuar dhe me funksion depo e jo banim).

5.45 Përfundimisht, sipas raportit të vlerësimit teknik, vlera e ndërtimit të apartamentit shtesë + papafingo është 2,346,034 lekë.

5.46 Subjekti nga ana e tij i është referuar vendimit nr. 34/2022, paragrafi 15.2 i Kolegjit, që ka sanksionuar se: *“...Në vijim, Komisioni duhet të kryejë një analizë të kuadrit ligjor rregullator të kostove të ndërtimit në kohën respektive. Nuk gjenden referenca për përcaktimin e kostove të ndërtimit për objektin “papafingo”. Sa rezulton, Komisioni duhet të vendosë të analizojë raste të objekteve që nuk përlllogariten me koston e plotë të ndërtimit, siç janë “karabinaja” apo “garazhi”, për të dalë në një vlerësim më të përafërt dhe të saktë, për përlllogaritjen e koston së ndërtimit të objektit papafingo”*.

5.47 Në lidhje me mundësinë financiare të prindërve të bashkëshortes së subjektit për të krijuar me të ardhura të ligjshme apartamentin shtesë dhe papafingo, në raportin e vlerësimit teknik datë 9.1.2024 eksperti konkludon se referuar vendimit të Komisionit nr. 166, datë 21.6.2019⁵⁰ dhe praktikës së Komisionit e të Kolegjit⁵¹, të ardhurave të krijuara nga subjekti fizik “P. N.”, për periudhën 2005 – 2010, kur janë paguar detyrimet tatimore, duhet përcaktuar që fitimi neto për çdo vit ushtrimor të jetë 75% e qarkullimit, prandaj fitimi neto për këtë periudhë ka rezultuar 6,750,000 lekë.

5.48 Në formë tabelare, ekspertja ka paraqitur qarkullimin e deklaruar, tatimin e paguar dhe fitimin neto, të realizuar nga vjehrra e subjektit, bazuar në marzhin e fitimit 75% të qarkullimit. Përlllogaritja është kryer për vitet 2005 – 2010 dhe jo për vitet e mëparshme, kur rezulton që janë paguar taksa për biznes, por nuk është paguar tatimi i biznesit të vogël.

5.49 Sikurse rezulton, fitimi neto i realizuar nga nëna e bashkëshortes së subjektit dhe familjes së bashkëshortes për periudhën 2005 – 2010 është në shumën 6,750,000 lekë, të ardhura të cilat tejkalojnë tri herë vlerën e ndërtimit të përlllogaritur nga ekspertja, por tejkalojnë gjithashtu edhe koston e ndërtimit të përlllogaritur dhe në versionin e Komisionit, në shumën 4,018,846 lekë (4,465,384 lekë – 10% të kësaj shume).

5.50 Për sa më lart, prindërit e bashkëshortes së subjektit kanë pasur mundësinë financiare të kryejnë këtë investim dhe nuk kanë pasur nevojë për financim në ndërtimin shtesë.

5.51 Në prapësime, subjekti ka dhënë pothuajse të njëjtat shpjegime që ka dhënë gjatë hetimit administrativ, për të provuar faktin se apartamenti shtesë plus papafingo është investim i kryer nga vjehrra i tij B. N., i cili deri në datën 28.1.2015, kur vjehrra ka regjistruar pronësinë e tij mbi këtë apartament, tashmë të legalizuar, ka pasur në pronësi vetëm apartamentin nr. 27 në adresën Njësia Administrative Nr. ***, rruga “****”, p. ***, h. *** dhe subjekti me bashkëshorten e dy fëmijët e tij që nga viti 2006 e deri aktualisht kanë banuar vetëm në apartamentin nr. 27 dhe nuk kanë apartament të investuar prej tyre të fshehur.

5.52 Në lidhje me faktet që Komisioni ka mbajtur parasysh në konkluzionin e tij të ngarkuar si barrë prove, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet e tij në prapësime:

⁵⁰ Vendimi i Komisionit nr. 166, datë 21.6.2019, ka përcaktuar se marzhi i fitimit për aktivitetin e stomatologut është 75%-80%, pasi Komisioni ka marrë edhe opinion pranë Urdhrit të Stomatologut.

⁵¹ Bazuar në vendimmarjen e Komisionit dhe Kolegjit, rastet e aktiviteteve të shërbimit janë marrë me një marzh fitimi neto në masën 80% të qarkullimit.

a) Për faktin se *apartamenti shtesë është ndërtuar kur subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij banonin në apartamentin me sipërfaqe 93 m² që i ka lënë vjehri në përdorim, ndërkohë që vetë vjehri banonte në Elbasan dhe u shpërngul në Tiranë në vitin 2015, çka duket se ai ka jetuar diku tjetër dhe nuk ka pasur nevojë të ngutshme për ndërtimin e apartamentit shtesë*, subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime sikurse gjatë hetimit administrativ, si dhe ka theksuar se pas datës 28.1.2015, për shkak të moshës, distancës së afërt dhe mundësisë për t’u kujdesuar për fëmijët e tij dhe fëmijët e kunatës, vjehri dhe vjehrra jetojnë edhe në Tiranë në apartamentin nr. 29 (shtesë + papafingo). Qëllimi kryesor përse vjehri e vjehrra ndërtuan këtë apartament shtesë ka qenë edhe që të pleqëronin në Tiranë pranë vajzave të tyre, meqë edhe vajza tjetër e martuar jeton po aty pranë dhe për çdo problem shëndetësor të ishin pranë tyre, madje për këtë arsye vjehri mbylli edhe shoqërinë e tij të ndërtimit dhe nisi të shesë asetet, ndërsa vjehrra mbylli aktivitetin e saj si dentiste. Gjithashtu, subjekti shpjegon se vjehri dhe vjehrra banojnë në katin shtesë me sipërfaqe banimi 80.60 m², ndërsa papafingon me sip. 72.70 m² e përdorin vetëm si depo, pasi është e pabanueshme për shkak të konstruksionit të saj.

Për të provuar këto shpjegime, subjekti i ka bashkëlidhur prapësimeve këto dokumente: (i) fotot e pasqyruara në akti raportin teknik, ku duken qartë materialet me të cilat është ndërtuar kjo papafingo dhe objektet e vjetra të vendosura aty për ruajtje e magazinim; (ii) deklaratën noteriale⁵² datë 13.1.2024, ku shtetasi N. M. deklaroi se në datën 10.9.2015 me shtetasin B. N., që njihej më parë nga marrëdhëniet e biznesit, ka lidhur një kontratë huapërdorjeje me afat njëvjeçar, pa kundërshtim, për të jetuar bashkë me familjen e vet në një apartament, pronë e shtetasit B. N. në Tiranë, në adresën Njësia Administrative Nr. ***, rruga “****” nr. ***, hyrja ***, pa numër apartamenti në atë kohë, shtesë kati ndërtuar mbi apartamentin ekzistues nr. 27, pronë e B. N.; (iii) deklaratën noteriale⁵³ datë 13.1.2024, ku shtetasi S. C. deklaroi se prej vitit 2001 apartamenti nr. 27, kati ***, që është përballë apartamentit ku ai banon, është blerë nga shtetasi B. N., në të cilin ka jetuar e vetme vajza e tij I. N. deri në vitin 2006. Bashkëlidhur edhe certifikata e pronësisë datë 20.2.2002 nga ZVRPP Tiranë, për regjistrimin e apartamentit me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, rruga “****”, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, me sip. 93 m², në pronësi të shtetasit S. C.; (iv) deklaratën noteriale⁵⁴ datë 13.1.2024, ku shtetasi S. G. deklaroi se apartamenti sipër apartamentit të tij është blerë nga shtetasi B. N. që në vitin 2001, në të cilin ka jetuar vetëm vajza e tij I. N. deri në vitin 2006. Më pas, kur ajo u martua me shtetasin Dritan Nushi e deri sot, ky çift jeton në atë apartament me dy fëmijët e tyre të vegjël. Bashkëlidhur deklaratës është certifikata e pronësisë datë 22.7.2004 nga ZVRPP Tiranë, për regjistrimin e apartamentit me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, rruga “****”, p. ***, shk. ***, k.***, ap. 25, me sip. 93 m², në pronësi të shtetasve S. e F. G.; (v) shkresën nr. *** prot., datë 12.1.2024, nga FSHU-ja, me faturat e energjisë të paguara për periudhën gusht 2014 – nëntor 2016 për dy kontratat nr. *** dhe nr. *** në emër të shtetasit B. N., që edhe sipas shpjegimeve të subjektit provojnë se në apartamentin nr. 27 (ku ka jetuar dhe jeton familja e subjektit) dhe në apartamentin nr. 29 (gjatë periudhës kur është dhënë një herë me qira dhe një herë me huapërdorje) ka pasur frekuentim të rregullt dhe pa ndërprerje, me përjashtim të një uljeje pagese tek apartamenti nr. 27 gjatë muajit gusht në të dyja vitet, kur për shkak të mbylljes së gjykatave subjekti merr pushime vjetore të plota dhe bashkë me familjen largohet nga Tirana.

b) Për faktin se *tarifa e shërbimit për ALUIZNI-n është paguar nga subjekti i rivlerësimit*, në prapësimet e tij subjekti ka shpjeguar se gjatë krijimit të apartamentit shtesë i vetmi moment kur përmendet emri i tij është pagesa në vlerën 16,000 lekë si tarifë e shërbimit për legalizimin e

⁵² Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.1.2024, nga shtetasi N. M..

⁵³ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.1.2014, nga shtetasi S. C..

⁵⁴ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.1.2024, nga shtetasi S. G..

apartamentit shtesë + papafingo, e kryer prej tij sipas faturës për arkëtim nr. ***, datë 12.1.2015. Në këtë datë, subjekti ka shoqëruar vjehrrin i tij në zyrat e ALUIZNI-t për kryerjen e procedurave, meqë zyrat ishin pranë Gjykatës Penale Tiranë, ku atë ditë subjekti kishte seanca gjyqësore. Gjatë aplikimit, vjehrrit i është treguar tarifa e shërbimit prej 16,000 lekësh, por as ai as subjekti nuk e dispononin me vete këtë shumë. Meqë ALUIZNI kishte vënë në dispozicion të qytetarëve një sportel të Raiffeisen Bank, ku subjekti kishte llogari, atëherë pagesa është bërë nëpërmjet llogarisë së tij me qëllim për të përfunduar procedurën dhe vjehrrin i tij të pajisej brenda ditës me leje legalizimi. Këtë pagesë më pas vjehrrin ia ka kthyer *cash*. Emergjenca e pagesës ishte që subjekti të ndihmonte vjehrrin e tij për të mos vajtur sërish në Elbasan për të marrë paratë, si dhe për të marrë sa më shpejt lejen e legalizimit e për të vazhduar me procedurën e regjistrimit të saj në ZRPP pa penalitete për vonesa. Ky fakt provohet nga leja e legalizimit që mban të njëjtën datë, 12.1.2015, si data e faturës së pagesës prej 16,000 lekësh.

c) Për faktin se *prokurën datë 3.7.2014, vjehrrin i subjektit të rivlerësimit ia ka dhënë vajzës së tij (bashkëshortes së subjektit) për të disponuar apartamentin nr. 25, me sip. 93 m², sa sipërfaqja e apartamentit ku banon subjekti, dhe jo për apartamentin shtesë me sipërfaqe 153.3 m², si dhe për faktin se kontrata e qirasë datë 3.7.2014 dhe kontrata e huapërdorjes datë 10.9.2015 janë lidhur për apartamentin nr. 25 me sip. 93 m² dhe në këto kontrata është cituar se qiramarrësit do të paguajnë energjinë elektrike në numrin e kontratës së furnizimit me energji elektrike *** Tiranë, kontratë kjo që i përket apartamentit që përdor subjekti i rivlerësimit, në prapësime subjekti ka shpjeguar se në lidhje me apartamentin që sipas kontratave të qirasë dhe huapërdorjes u është dhënë në përdorim personave të tretë, ka një pasaktësi sepse gabimisht ky apartament është shënuar me nr. 25, meqë në kohën e nënshkrimit të kontratave ai nuk kishte numër. Faktikisht ky apartament është me nr. 29 dhe i përket shtesës së katit. Apartamenti nr. 29 i është dhënë me qira vetëm për një vit kundrejt vlerës 35,000 lekë/muaj disa studentëve, të cilët kërkonin patjetër një dokument të saktë qiraje, por duke qenë se apartamenti i ri nuk kishte akoma certifikatë pronësie me numër apartamenti, vjehrrin ka paraqitur tek noterja të dhënat që dispononte për apartamentin ekzistues poshtë katit ku jeton subjekti dhe familja e tij. Në datën 3.7.2014, kur vjehrrin ka qenë në Tiranë, është firmosur tek e njëjta notere kontrata e qirasë dhe prokura e posaçme nr. *** rep., me të cilën ai ka autorizuar si përfaqësuese të posaçme vajzën e tij I. N. (N.) që ta përfaqësojë në mungesë, në lidhjen e kontratës së qirasë për pasurinë apartament në adresën rruga “***”, p. ***, ap. 25, Tiranë.*

Vitin tjetër, apartamenti nr. 29 i është dhënë me huapërdorje pa kundërshtim shtetasit N. M., i cili në deklaratën noteriale datë 13.1.2024, të lartpërmendur, ka deklaruar se *ka jetuar në apartamentin shtesë kati mbi apartamentin nr. 27, pronë e B. N.*

Pra, ka qenë pikërisht noterja që e ka përmendur për herë të parë “nr. 25” në këto akte e më pas duket se ajo e ka vendosur këtë numër apartamenti në kontratën e qirasë dhe kontratën e huapërdorjes, duke përdorur shabllon të njëjtin dokumentacion, prokurën dhe kontratën e vitit 2014.

Bashkëlidhur këtij shpjegimi, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën noteriale⁵⁵ të noteres E. T., e cila ka hartuar këto akte (prokurën e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.7.2014, kontratën e qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.7.2014 dhe kontratën e huapërdorjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.9.2015) në lidhje me apartamentin shtesë. Në deklaratë, noterja deklaroi se në datën 3.7.2014, në zyrën e saj noteriale, shtetasi B. N. ka kërkuar hartimin e prokurës së posaçme për përfaqësuesin (I. N.) që do të kryejë tagrat e caktuara mbi pasurinë pronë e tij, si dhe

⁵⁵ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.1.2023.

ka deklaruar të dhënat e pasurisë të pasqyruara në prokurë lidhur me numërtimin dhe adresën e pasurisë. Në “prokurën e posaçme”, që ka formën e një deklarimi personal, nuk verifikohen të dhënat konkrete të pasurisë, por gjeneralitetet dhe tagrat e përfaqësimit. Më pas, përfaqësuesja e pronarit ka lidhur kontratën e qirasë dhe kontratën e huapërdorjes, ku të dhënat e pasurisë referuar certifikatës së pronësisë janë zona kadastrale, volumi dhe faqja, si të dhëna unike të regjistrit të pasurive të paluajtshme, ndërsa detajeve të tjera si përshkrimi i pasurisë apo numër konkret apartamenti, nuk u është dhënë rëndësia e duhur për t’i verifikuar, por këto të dhëna janë kopjuar nga akti i mëparshëm “prokura e posaçme”. Në biseda paraprake, palët diskutonin se me qira apo huapërdorje jepej shtesa e katit të sipërm mbi pasurinë ekzistuese, që nuk ishte regjistruar në regjistrat publikë sepse ishte në proces legalizimi. Referuar praktikave të ASHK-së, ku shpesh legalizimi i shtesës së katit bëhej me të njëjtin numër pasurie (si një e vetme me pasurinë bazë), në kontratat e qirasë dhe huapërdorjes janë vënë të dhënat e pasurisë bazë, konkretisht z. k. ***, vol. ***, f. ***, duke u kopjuar të dhënat e mbartura nga prokura.

Pra, ka shpjeguar subjekti, për sa i përket “nr. 25” të apartamentit të përmendur në kontratën e qirasë datë 3.7.2014 dhe në kontratën e huapërdorjes datë 10.9.2015, janë lapsuse të vëna aty nga noteri, por ai personalisht nuk ka qenë palë e këtyre akteve dhe nuk i ka nënshkruar ato.

Gjithashtu, gjatë hetimit është provuar që apartamenti nr. 25 është në pronësi të shtetasit S. G. në katin e katërt, poshtë katit ku banon subjekti, referuar deklaratës noteriale datë 13.1.2024 të fqinjit S. G. dhe certifikatës së pronësisë ku ai figuron pronar i apartamentit nr. 25 të së njëjtës shkallë ku banon subjekti i rivlerësimit. Nga ana tjetër, ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri konfirmon se në pallatin me adresë rruga “****”, z. k. ***, shtetasi B. N. ka vetëm dy apartamente të regjistruara me nr. pasurie ***, vol. ***, f. *** dhe nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***.

ç) Për faktin se *subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka asnjë kontribut financiar në krijimin e apartamentit shtesë dhe as nuk ka ndjekur punimet e kryera, madje aplikimi dhe procedura e legalizimit, si dhe certifikata e pronësisë janë bërë në emër të vjehrrit të tij*, në prapësime subjekti ka shpjeguar, sikurse gjatë hetimit administrativ, se ndërtimi është kryer në mënyrë informale mbi shtëpinë e blerë më parë dhe, për këtë arsye, shpenzimet kanë qenë minimale, sipas mundësisë së kursimit të vjehrrit dhe vjehrrës së tij ndër vite dhe parave që kishin akumuluar *cash* në shtëpi. Prindërit e bashkëshortes e kanë pasur mundësinë financiare të kryejnë këtë investim dhe nuk kanë pasur në asnjë moment nevojë për financim në ndërtimin shtesë.

Vlerësimi i Komisionit

5.53 Në lidhje me burimin e ligjshëm financiar të krijimit të apartamentit shtesë plus papafingo, me sip. 153.3 m², në vlerën 4,465,384 lekë, të përlllogaritur nga Komisioni, duke iu referuar kuadrit ligjor (vendimit nr. 6, datë 17.3.2022, paragrafi 14.8 i Kolegjit), që ka mbajtur qëndrimin se nga çmimi i EKB-së duhet të zbriten elementet e fitimit të planifikuar dhe fondit rezervë, që janë në masën 10% e koston së ndërtimit, duhet të mbahet parasysh: konstruksioni i ndërtimit dhe elementet që janë përdorur për ndërtimin shtesë; udhëzuesi për zbatimin e VKM-së nr. 173, datë 29.3.2006 “Për miratimin e koston minimale fiskale në ndërtim dhe për mënyrën e përcaktimit të çmimit të shitjes së banesave”, si dhe marrëveshja e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë, parashikohet se në praktikë kërkohet analizë më e thellë e strukturës dhe e kostove të ndërtimit, sipas fazës së ndërtimit të objektit, duke paraqitur një orientim për përcaktimin e koston së ndërtimit të garazheve për qëllime fiskale, për afërsisht sa ½ e koston për metër katror të ndërtimit të përfunduar, të cilit i përket ky garazh; vendimi nr. 34/2022, paragrafi 15.2 i Kolegjit, që ka sanksionuar se “...Në vijim, Komisioni duhet të kryejë një analizë të kuadrit ligjor rregullator të kostove të ndërtimit në kohën respektive. Nuk gjenden referenca për

përcaktimin e kostove të ndërtimit për objektin “papafingo”. Sa rezulton, Komisioni duhet të vendosë të analizojë raste të objekteve që nuk përllogariten me koston e plotë të ndërtimit, siç janë “karabinaja” apo “garazhi”, për të dalë në një vlerësim më të përafërt dhe të saktë për përllogaritjen e kostos së ndërtimit të objektit papafingo”; referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti, fotove të vëna në dispozicion prej tij që provojnë gjendjen faktike të ndërtimit, nga ku rezulton se për ndërtim janë përdorur materiale të lehtësuara dhe një pjesë e banesës shërben si depo; referuar raportit teknik vlerësues të paraqitur nga ekspertja, si dhe duke marrë në konsideratë se personi tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, vjehri i tij, duke qenë me profesion inxhinier ka ushtruar aktivitet privat në fushën e ndërtimit dhe ka kryer vetë punimet e ndërtimit të apartamentit shtesë dhe papafingos. Komisioni vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti në prapësime në lidhje pasurinë objekt verifikimi me sip. 153.3 m² janë të besueshme dhe të logjikshme.

5.54 Për sa më sipër, në lidhje me koston e ndërtimit të kësaj pasurie, pas ripërllogaritjes, duke marrë në konsideratë: raportin teknik të hartuar nga eksperti i licensuar, i depozituar në prapësime; mesataren e kostove të ndërtimit për vitet 2009 – 2010 (referuar udhëzimit nr. 1, datë 20.8.2008, të EKB-së), meqenëse kjo është periudha e deklaruar nga vjehri i subjektit dhe brenda periudhës së provuar me foto nga ASIG-u; faktin se kemi të bëjmë me shtesë kati mbi ndërtim ekzistues dhe jo ndërtim të ri nga themelet; përdorimin e materialeve të lehtësuara dhe të përdorura, si dhe diferencimit të ndërtimit ku vetëm 80.6 m² është ndërtim i mirëfilltë me të gjitha elementet dhe 72.7 m² është papafingo, që shërben si depo, me mure të ulëta, pa investim në pajisje elektrike dhe hidraulike, çka dikton nevojën për të marrë në konsideratë uljen e përqindjes së vlerës mesatare të kostove të ndërtimit që sugjeron ekspertja në aktin e saj (60% për koston e papafingos dhe 30% për koston e apartamentit) – atëherë Komisioni bëri përllogaritjet përkatëse, nga ku rezultoi⁵⁶ se vlera e ndërtimit shtesë (apartament plus papafingo) të kryer në vitet 2009 – 2010 nga vjehri i subjektit është 2,384,253 lekë.

5.55 Në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të përdorura për këtë ndërtim me burim të ardhurat nga aktiviteti privat i vjehrrës së subjektit si ndihmës stomatologe, subjekti, ashtu sikurse ka konfirmuar edhe Komisioni, ka provuar ushtrimin e aktivitetit dhe pagesën e detyrimeve tatimore dhe në një vlerësim alternativ të fitimit të realizuar, në mungesë të të dhënave tatimore nga institucionet përkatëse, bazuar edhe në praktikën e Kolegjit⁵⁷ se marzhi i fitimit për aktivitetin e stomatologut është 80%, rezulton se ka pasur burime të ligjshme për ndërtimin e këtij objekti.

5.56 Në lidhje me barrën e ngarkuar nga Komisioni për të provuar tej çdo dyshimi që për apartamentin shtesë plus papafingo me sip. 153.3 m², subjekti nuk ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, si dhe pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni, duke iu referuar dokumenteve dhe prapësimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, i cili arriti të krijojë bindjen se vjehri i tij ka në pronësi apartamentin nr. 27 dhe apartamentin shtesë e papafingo nr. 29 në Tiranë, rruga “****”, p. ***; as subjekti, as bashkëshortja e tij dhe as personat e tjerë të lidhur me subjektin nuk kanë në pronësi pasuri tjetër, madje citimi i apartamentit nr. 25 në disa akte noteriale nga vjehri i subjektit u provua që është gabim, i bërë

⁵⁶ Sipas EKB-së, kostoja e ndërtimit për vitin 2009 është 27,439 lekë/m², për vitin 2010 është 28,333 lekë/m². Mesatarja e kostos së këtyre dy viteve është 27,886 lekë/m². Për apartamentin me sip. 80.60 m² x 27,886 lekë/m² = 2,247,611.6 lekë – 674,283.48 lekë (30%) = 1,573,328.12 lekë. Për papafingon me sip. 72.70 m² x 27,886 lekë/m² = 2,027,312.2 lekë – 1,216,387.32 lekë (60%) = 810,924.88 lekë. Në total, vlera e ndërtimit shtesë (apartament 1,573,328.12 lekë + papafingo 810,924.88 lekë) është 2,384,253 lekë.

⁵⁷ Vendimi i Komisionit nr. 166, datë 21.6.2019, ka përcaktuar se marzhi i fitimit për aktivitetin e stomatologut është 75%-80%, pasi Komisioni ka marrë edhe opinion pranë Urdhrit të Stomatologut. Bazuar në vendimmarrjen e Komisionit dhe Kolegjit, rastet e aktiviteteve të “shërbimit” janë marrë me një marzh fitimi neto në masën 80% të qarkullimit.

fillimisht në prokurën e posaçme nga noterja ose nga shtetasi B. N. gjatë deklarimit të të dhënave të apartamentit ekzistues. Një gabim i kësaj natyre konsiderohet i paqëllimshëm, duke pasur parasysh që meqë vjehri nuk ka banuar asnjëherë aty, mundësia për të mbajtur mend numrin e saktë të këtij apartamenti është pothuajse e pamundur; subjekti banon pa shpërblim me familjen e tij në apartamentin nr. 27 që vjehri i ka lënë në përdorim pa shpërblim vajzës së tij, që është edhe bashkëshortja e subjektit; subjekti nuk ka kontribuar financiarisht dhe as ka përfituar të ardhura nga asnjëri nga këto dy apartamente; për apartamentin nr. 29, bashkëshortja e subjektit ka vepruar si përfaqësuese e babait të saj B. N. sipas prokurës së posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.7.2014, për të arkëtuar në emër dhe për llogari të babait të saj vlerat e përfituara nga qiraja e apartamentit shtesë plus papafingo; bashkëshortja e subjektit nuk ka tagra tjetërsimi pasurie në prokurë – vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, si dhe pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

5.57 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar apartamentin shtesë dhe papafingon që në pyetësinorin standard, duke dhënë shpjegime e prova të tjera gjatë hetimit me qëllim pasqyrimin e vërtetë të rrethanave të krijimit dhe disponimit të kësaj pasurie, duke qenë transparent për çdo detaj dhe nuk ka tentuar të fshehtë asnjë situatë në lidhje me këtë pasuri.

5.58 Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë kryer fshehje të pasurisë apartament dhe papafingo nr. 29 në pallatin nr. ***, rruga “***”. Kjo pasuri është në pronësi faktike dhe ligjore të vjehrit dhe vjehrrës së subjektit të rivlerësimit dhe është krijuar me burim nga të ardhura të ligjshme të tyre.

6. Depozitë rrjedhëse e pagës në Credins Bank, me gjendje 75 lekë në datën 23.1.2017. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: paga e subjektit.

6.1 Credins Bank⁵⁸ konfirmon llogarinë e pagës së subjektit me gjendje në datën 31.12.2016 në shumën 75.55 lekë.

6.2 Nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë deklaram.

❖ Pasuri të deklaruara nga shtetasja I. N., bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit

7. Depozitë bankare në euro, me afat 1-vjeçar në Intesa Sanpaolo Bank, krijuar në datën 18.5.2011 nga të ardhurat personale (deri në datën 24.1.2017). Vlera: 11,556.75 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat personale.

7.1 Intesa Sanpaolo Bank⁵⁹ konfirmon depozitë në emër të bashkëshortes së subjektit, me gjendje 11,556.75 euro në datën 31.12.2016. Nga veprimet bankare rezulton se depozita është krijuar në datën 18.5.2009 në shumën 5,789.29 euro, e cila është transferuar nga një llogari tjetër⁶⁰ e bashkëshortes së subjektit, gjithashtu në Intesa Sanpaolo Bank dhe është futur në depozitë me afat 1-vjeçar. Kjo depozitë është shtuar ndër vite jo vetëm nga gjenerimi i interesave, por edhe nga depozitimet *cash*⁶¹ apo transferimet bankare⁶² dhe në datën 18.5.2011 arrin vlerën 10,721.9 euro. Në vazhdim kjo depozitë është rinovuar dhe shtesat e saj janë vetëm nga interesat bankarë, duke arritur në deklaratën *Vetting* me gjendje 11,556.75 euro.

⁵⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 26.3.2021.

⁵⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.2.2021.

⁶⁰ Transferuar nga llogaria në monedhën euro në Intesa Sanpaolo Bank me nr. ***, në llogarinë me nr. ***.

⁶¹ Në llogarinë nr. *** në datën 18.5.2010 janë depozituar *cash* 855 euro (tërhequr nga llogaria e pagës në Credins Bank 70,000 lekë); në datën 18.5.2011 janë depozituar 2,000 euro (tërhequr nga llogaria e pagës në Credins Bank 290,000 lekë).

⁶² Transferuar nga llogaria nr. *** në datën 18.5.2011 shuma 2,539.61 euro dhe në datën 30.6.2010 shuma 1,003.25 euro.

7.2 Komisioni ka verifikuar të gjitha veprimet bankare në llogarinë rrjedhëse me nr. *** deri në krijimin e shumës 5,789.29 euro, e cila në datën 18.5.2009 u transferua në llogarinë e depozitës.

7.3 Në DIPP-në e vitit 2007, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “*Llogari kursimi në Bankën Amerikane të Shqipërisë, krijuar në datën 21.11.2007. Vlera: 3,610 euro*”.

7.4 Në pyetësin nr. 2, subjekti ka shpjeguar se bashkëshortja e tij e ka deklaruar për herë të parë krijimin e llogarisë së kursimit në vitin 2007, kur ka lindur detyrimi ligjor për deklarim si person i lidhur për shkak të martesës ligjore. Për depozitimin e shumës 2,600 euro në datën 21.11.2007, në llogarinë e kursimit, burimi i krijimit ka qenë shuma prej 250,000 lekësh, e tërhequr nga llogaria e pagës në Intesa Sanpaolo Bank në datën 13.4.2007 dhe pjesa tjetër janë të ardhura nga paga e shpërblime nga puna. Shuma 1,000 euro e transferuar në datën 21.11.2007 ka si burim shumën 123,560 lekë, të kaluar nga llogaria e pagës në llogarinë e kursimit. Në datën 8.4.2009, bashkëshortja ka depozituar *cash* shumën 3,150 euro.

7.5 Intesa Sanpaolo Bank⁶³ konfirmon veprimet e datës 13.4.2007 për tërheqjen e shumës 250,000 lekë dhe veprimin e datës 21.11.2007 të transferimit të shumës 1,000 euro, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi.

7.6 Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij për të depozituar *cash* shumën 3,150 euro në datën 8.4.2009 në llogarinë e kursimit dhe rezultoi se kishin mundësi me të ardhura të ligjshme⁶⁴.

7.7 Pas kryerjes së këtyre transaksioneve, gjendja e llogarisë së kursimit në datën 30.4.2009 është në shumën 7,639.29 euro, nga ku më pas, në datën 18.5.2009, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka transferuar në llogarinë e depozitës⁶⁵ shumën 5,789.29 euro.

7.8 Për sa më lart, nuk konstatohen problematika në lidhje me depozitën bankare.

8. Depozitë bankare në lekë me afat 1-vjeçar në Union Bank, krijuar në datën 27.4.2016 nga të ardhurat personale (deri në datën 24.1.2017). Vlera: 400,000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat personale.

8.1 Union Bank⁶⁶ konfirmon depozitën bankare me afat 1-vjeçar të hapur në datën 27.4.2016.

8.2 Llogaria e kursimit është furnizuar me transfertë mujore nga llogaria e pagës dhe me një pjesë të gjendjes së akumuluar në llogarinë e kursimit bashkëshortja e subjektit ka hapur depozitën e mësipërme në shumën 400,000 lekë, në datën 27.4.2016.

8.3 Në pyetësin nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo depozitë është krijuar nga kalimi i fondit 400,000 lekë, të grumbulluar në llogarinë e kursimit nr. *** në lekë, në Union Bank, të bashkëshortes së tij, nga kalimet periodike të pagës së saj.

8.4 Për sa më lart, nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë depozitë bankare.

9. Llogari kursimi në euro në Union Bank, në datën 3.3.2014, krijuar nga të ardhurat personale (deri në datën 24.1.2017). Vlera: 343,04 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat personale.

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 26.2.2021.

⁶⁴ Në datën 8.4.2009 ekziston kjo gjendje: (1) të ardhura 630,352 lekë (292,036 lekë të ardhura nga paga e subjektit + 338,316 lekë të ardhura nga paga e bashkëshortes së subjektit); (2) detyrime 0 (zero); (3) shpenzime jetike 108,922 lekë; (4) pasuri -525,844 lekë (957,929 lekë ndryshim likuiditeti (*gjendje likuiditeti në fund - gjendje likuiditeti në fillim*)); depozitim në datën 8.4.2009 i shumës 3,150 euro ose 432,086 lekë; të ardhura + detyrime - shpenzime - pasuri = 1,047,274 lekë.

⁶⁵ Llogari nr. ***.

⁶⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 19.2.2021.

9.1 Union Bank⁶⁷ konfirmon llogarinë e kursimit në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me gjendje 343.04 euro në datën 24.1.2017. Kjo llogari është hapur në datën 3.3.2014 me depozitimin *cash* të shumës 1,210 euro dhe më pas, në mënyrë periodike, nga llogaria e pagës kanë kaluar pagesa në shumën 18,000 lekë/muaj.

9.2 Nga veprimet bankare rezulton se për periudhën 1.1.2014 – 3.3.2014, kur është depozituar shuma 1,210 euro, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë tërhequr *cash* nga llogaritë e tyre të pagës shumën totale 256,000 lekë, që është e mjaftueshme për të përballuar shpenzimet jetike dhe për të mbuluar depozitimin *cash* të shumës 1,210 euro ose 169,521 lekë në datën 3.3.2014.

9.3 Për sa më lart, nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

10. Llogari personale në lekë në Union Bank, për pagesën e kredisë, hapur në datën 14.7.2014, krijuar nga të ardhurat personale (deri në datën 24.1.2017), me gjendje 40,271.91 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat personale.

10.1 Union Bank⁶⁸ konfirmon llogari bankare në emër të bashkëshortes së subjektit, me gjendje 40,271.91 lekë në datën 24.1.2017. Kjo llogari është hapur në datën 14.7.2014, kur është disbursuar kredia 1,000,000 lekë, e cila është mbyllur para afatit, në datën 30.8.2016, me marrjen e kredisë së re në vlerën 950,000 lekë, në vitin 2016, nga bashkëkredimarrëset I. N. dhe L. V.⁶⁹ (L. V. është motra e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. I. N.). Pas pagesës së kredisë së vjetër (1,000,000 lekë), pjesa e mbetur e shumës së disbursuar është tërhequr *cash* nga shtetasja L. V. në vlerën 550,000 lekë.

10.2 Gjithashtu, nga veprimet bankare rezulton se e gjithë kredia prej 1,000,000 lekësh është tërhequr nga shtetasja L. V.. Bashkëshortja e subjektit, në datën 14.7.2014 ka autorizuar shtetasen L. V. për të vepruar me fondet e llogarisë (të kryejë depozitime, pagesa të ndryshme, transferata bankare, të mbyllë llogarinë bankare etj.).

10.3 Në këtë llogari, pagesat e kësteve të kredisë janë bërë nëpërmjet depozitimeve *cash* nga shtetasit G., L. dhe M. V. dhe për periudhën 4.8.2014 – 23.12.2016 këto pagesa janë në shumën 1,021,400 lekë. Për këtë fakt, në pyetësin nr. 2 subjekti ka shpjeguar⁷⁰ se kredia është marrë dhe përdorur tërësisht nga shtetasja L. V. për interesa personale e familjare. Shtetasit G. e M. V. janë përkatësisht bashkëshorti dhe vjehrra e shtetasës L. V. (N.). Në kushtet kur kredia është përdorur tërësisht nga shtetasja L. V., pagesat e kësteve të kredisë janë bërë prej saj, bashkëshortit dhe vjehrrës së saj. Llogaria bankare e cituar nga Komisioni është llogaria nr. ***, e dedikuar e hapur nga banka për këtë kredi, llogari e cila rezulton e mbyllur me shlyerjen e kredisë. Bashkëlidhur, subjekti ka depozituar disa dokumente për të provuar përgjigjet e tij⁷¹.

10.4 Për sa më lart, nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

⁶⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 19.2.2021.

⁶⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 19.2.2021.

⁶⁹ Kontratë kredie konsumatore e datës 29.8.2016, e lidhur midis Union Bank si kredihënëse dhe shtetaseve I. N. e L. V. si kredimarrëse për shumën 950,000 lekë.

⁷⁰ Përgjigja në faqen 19 të pyetësin nr. 2.

⁷¹ Bashkëlidhur: (1) kontrata e kredisë datë 14.7.2014, midis Union Bank dhe shtetaseve I. N. e L. V.; (2) certifikata e trungut familjar të shtetasës L. V.; (3) certifikata që vërteton mbiemrin para martesë të shtetasës L. V.; (4) deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.11.2022, nga shtetasja L. V.; ekstrakt *statement* i llogarisë së kredisë nr. *** në Union Bank; (5) deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.11.2022, nga shtetasja M. V. dhe deklarata datë 20.7.2020 nga shtetasi E. R. (vëllai i znj. M. V.), që deklarojnë se M. është vjehrra e L. V. dhe në datën 21.1.2014 ka marrë dorazi nga I. N. shumën 7,880 euro. Këtë shumë shtetasi E. R., rezident në Itali (vëllai i M.), ia ka dërguar shtetasës M. V. për t'i shlyer borxhin që i kishte me transfertë nga llogaria e tij në llogarinë e I. N., meqenëse në atë kohë as ajo dhe as familjarët e saj nuk dispononin një llogari bankare në euro; (6) përshkrimi i llogarisë datë 31.3.2014 nga Banka Popullore ***, ku figuron transferata bankare e shumës 7,900 euro nga llogaria e shtetaseve E. e V. R. tek llogaria e shtetasës I. N.

11. Llogari kursimi në lekë në Union Bank, krijuar në datën 14.7.2014 nga të ardhurat personale (deri në datën 24.1.2017). Vlera: 168,661.97 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat personale.

11.1 Union Bank⁷² konfirmon llogari në emër të bashkëshortes së subjektit, me gjendje 143,661.97 lekë në datën 31.12.2016 dhe 168,661.97 lekë në datën 24.1.2017. Kjo shumë është krijuar kryesisht me kursimet nga llogaria e pagës, të transferuara nëpërmjet pagesave periodike.

11.2 Nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

12. Llogari rrjedhëse page në lekë në Union Bank, krijuar në datën 22.9.2009 (deri në datën 24.1.2017). Vlera: 29,654.14 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga.

12.1 Kjo llogari nuk është deklaruar në DIPP-në e vitit 2009.

12.2 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* një përshkrim llogarie datë 24.1.2017 nga Union Bank, që vërteton deklarinimin e bashkëshortes së subjektit.

12.3 Union Bank⁷³ konfirmon llogarinë e pagës së shtetasës I. N., me gjendje 29,654.14 lekë në datën 24.1.2017.

12.4 Nuk konstatohen problematika për këtë llogari bankare.

13. Llogari rrjedhëse për kartën e kreditit në Union Bank, hapur në datën 14.7.2016, krijuar nga të ardhurat personale (deri në datën 24.01.2017). Vlera me gjendje -56,539 lekë. Pjesa takuese 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat personale.

13.1 Union Bank⁷⁴ konfirmon llogarinë bankare të kartës së kreditit, me limit në shumën 100,000 lekë, me gjendje -58,133 lekë në datën 31.12.2016.

13.2 Nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

14. Kredi afatmesme në lekë në Union Bank. Kohëzgjatja 30 muaj. Afati 30.8.2016 – 28.2.2019. Principali: 950,000 lekë. Detyrimi financiar pa u shlyer: 836,730.84 lekë.

14.1 Në DIPP-në e vitit 2016, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “*Kredi në Union Bank në lekë. Mbetur pa shlyer deri në datën 31.12.2016 shuma 711,976.29 lekë*”.

14.2 Sipas dokumentacionit provues që ka depozituar subjekti, rezulton se me kontratën e kredisë konsumatore datë 29.8.2016, të lidhur me kredihënësin Union Bank, kredimarrëset I. e L. V. kanë marrë kredinë në shumën 950,000 lekë për shpenzime personale.

14.3 Union Bank konfirmon dhënien e kredisë në datën 30.8.2016 në shumën 950,000 lekë, sipas kontratës si më lart. Nga veprimet bankare rezulton se nga shuma 950,000 lekë e disbursuar janë përdorur 353,889.58 lekë për shlyerjen e huas 1,000,000 lekë të marrë në vitin 2014, ndërsa 550,000 lekë janë tërhequr *cash* nga shtetasja L. V. dhe diferenca e mbetur është përdorur për shlyerjen e këstit të radhës së kredisë së re.

14.4 Sipas veprimeve bankare, rezulton se pagesat e kësteve të kredisë janë likuiduar nga shtetasit L. e G. V. për periudhën 2016 – 2019.

⁷² Shkresë nr. *** prot., datë 19.2.2021.

⁷³ Shkresë nr. *** prot., datë 19.2.2021

⁷⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 19.2.2021

14.5 Në pyetësoin nr. 2, subjekti ka shpjeguar⁷⁵ se kontrata e kredisë datë 29.8.2016, me vlerë 950,000 lekë, është rifinancim me shtesë e kredisë së marrë me kontratën datë 14.7.2014 në vlerën 1,000,000 lekë. Qëllimi i kredisë datë 29.8.2016 është përdorimi i saj nga shtetasja L. V. për nevoja personale e familjare, e cila e ka përdorur tërësisht vetë dhe pagesat e kësteve të kredisë janë bërë prej saj. Kjo provohet nga *statement*-i i llogarisë së kredisë nr. *** në Union Bank. Bashkëlidhur subjekti ka depozituar disa dokumente për të provuar deklaratimet e tij⁷⁶.

14.6 Për sa më lart, nuk konstatohen problematika në lidhje me kredinë e marrë në Union Bank në shumën 950,000 lekë, ku shtetasja I. N. është bashkëkredimarrëse, pasi kredia dhe pagesat për likuidimin e saj janë kryer nga shtetasja L. V. (motra e saj).

❖ Konstatime të tjera për pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij

15. Dhurata e trajtime preferenciale në vlerën totale 590,000 lekë. Burimi i krijimit: nga të afërm të subjektit dhe bashkëshortes së tij.

15.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto dhurime:

- Në DIPP-në e vitit 2007: *“Dhuratë nga djemtë e dajave refugjatë..., në vlerën 120,000 lekë. Shpërblim që ka marrë gruaja I. N. për lindje fëmije në vlerën 180,000 lekë. Dhuratë nga prindërit e mi për lindje fëmije në vlerën 50,000 lekë. Dhuratë nga prindërit e gruas për vajzën, në vlerën 98,000 lekë”*. Pra, në total, ka deklaruar dhurata monetare në vlerën totale 448,000 lekë.
- Në DIPP-në e vitit 2008: *“Të ardhura të grumbulluara nga festat e ditëlindjet prej familjes, të afërm, shokë, në vlerën 50,000 lekë. Të ardhura të grumbulluara nga 1-vjetori i vajzës prej familjes, të afërm, shokë, në vlerën 92,000 lekë”*.

15.2 Pra, subjekti në total ka deklaruar dhurata në vlerën 142,000 lekë.

Analiza financiare e mundësive për krijimin e të ardhurave

15.3 Në llogarinë bankare të subjektit në Raiffeisen Bank rezulton se në vitin 2007 ai ka depozituar *cash* shumat 120,000 lekë⁷⁷, 180,000 lekë⁷⁸, 50,000 lekë⁷⁹ dhe 98,000 lekë⁸⁰, ndërsa në vitin 2008 ka depozituar shumat 50,000 lekë⁸¹ dhe 92,000 lekë⁸². Duket se këto depozitime të shumave në vitet 2007 e 2008 nuk janë bërë afër datave të martesës së subjektit dhe të lindjes së vajzës së tij.

15.4 Në lidhje me burimin e krijimit të këtyre dhurimeve, subjekti ka shpjeguar⁸³ në pyetësoin nr. 2 se në vitin 2007, për shkak të gëzimit të dyfishtë (martesa e tij dhe lindja e fëmijës së parë), familja dhe kushërinjtë e tij i dhuruan sipas zakonit dhe mundësive shuma të ndryshme monetare, të cilat subjekti i ka mbledhur dhe depozituar në të vetmen llogari bankare që kishte, me qëllim për të mos i mbajtur në shtëpi. Subjekti nuk disponon dokumentacion ligjor për këto shuma, përveç

⁷⁵ Përgjigjja në faqen 21 të pyetësoin nr. 2, dërguar nga subjekti.

⁷⁶ (1) Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.11.22, e shtetases L. V., ku deklaroi se meqë Union Bank ishte banka më e shpejtë në procedurat e dhënies së kredisë dhe motra e saj I. N. ishte pagamarrëse me pagë të lartë në këtë bankë, vendosën që të merrnin kredi duke nënshkruar kontratat e kredisë në datat 14.7.2014 dhe 29.8.2016 si bashkëkredimarrëse. Këto kredi janë tërhequr, përfituar dhe përdorur tërësisht nga shtetasja L. V. për nevoja të saj personale e familjare dhe janë shlyer tërësisht nga të ardhurat nga puna e saj; (2) kontratë kredie datë 14.7.2014; (3) kontratë kredie datë 29.8.2016; (4) *statement* i llogarisë nr. *** në Union Bank.

⁷⁷ Depozituar *cash* nga subjekti në datën 29.5.2007.

⁷⁸ Depozituar *cash* nga subjekti në datën 23.10.2007.

⁷⁹ Depozituar *cash* nga subjekti në datën 6.12.2007.

⁸⁰ Depozituar *cash* nga subjekti në datën 26.12.2007.

⁸¹ Depozituar *cash* nga subjekti në datën 28.5.2008.

⁸² Depozituar *cash* nga subjekti në datën 16.9.2008.

⁸³ Përgjigjja nr. 1/b e pyetësoin nr. 2.

ekstraktit bankar, certifikatës së tij të martesës dhe certifikatës së lindjes së vajzës. Në lidhje me dhurimet e shumës 50,000 lekë, dhuruar nga prindërit e tij, dhe shumës 98,000 lekë, dhuruar nga prindërit e gruas, subjekti ka paraqitur deklaratat⁸⁴ noteriale të nënës dhe vjehrrit të tij. Në lidhje me shumën 180,000 lekë, bashkëshortja i ka sqaruar subjektit se në vitin 2007 ka përfituar nga kompania punëdhënëse e saj *** sh.a. dy shpërblime monetare, njëri për martesë dhe tjetri për lindjen e fëmijës, në total në shumën 200,000 lekë, që janë tërhequr dhe depozituar nga subjekti në llogarinë e tij për arsye shëndetësore të bashkëshortes.

15.5 *** konfirmon⁸⁵ se në zbatim të kontratës kolektive të punës i ka dhënë të punësuarës (I. N. N.), për shkak të martesës dhe lindjes së fëmijës në vitin 2007, shumën 200,000 lekë bruto ose 180,000 lekë neto.

Analiza financiare e mundësisë së dhuruesve për t'i dhuruar subjektit shumat si më lart

15.6 Referuar shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti, si dhe dokumentacionit të administruar nga Komisioni në lidhje me të ardhurat e prindërve të subjektit⁸⁶, rezulton se shuma 50,000 lekë, që ata i kanë dhuruar subjektit, është me të ardhura të ligjshme.

15.7 Nga dokumentacioni i disponuar për prindërit e bashkëshortes së tij duket se shuma 98,000 lekë e dhuruar prej tyre ka si burim të ardhurat e ligjshme nga punësimi i shtetasit B. N.⁸⁷ dhe nga aktiviteti privat i shtetasës P. N..

15.8 Shuma 180,000 lekë që bashkëshortja e subjektit ka marrë si dhuratë nga punëdhënësi *** sh.a., referuar vërtetimit të lartpërmendur, është e ardhur e ligjshme, prandaj është përfshirë në analizë financiare.

15.9 Në lidhje me shumën 120,000 lekë, dhuratë nga djemtë e dajave të tij, G. e A., të cilët janë refugjatë, subjekti i rivlerësimit nuk provoi burimin e ligjshëm të saj, prandaj nuk është përfshirë në analizën financiare të vitit 2007.

15.10 Në lidhje me shumat e dhuruara në vitin 2008, Komisioni, duke marrë në konsideratë deklarinimin e tyre në DIPP-në e vitit 2008 nga subjekti, vlerën totale të këtyre dhurimeve, si dhe faktin që këto shuma janë dhuruar nga disa persona, i ka përfshirë ato në analizën financiare.

15.11 Për sa më lart, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të shumës 120,000, të dhuruar nga kushërinjtë refugjatë në vitin 2007.

15.12 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 për konstatimet e lartpërmendura, por subjekti nuk ka dhënë shpjegime për këtë konstatim.

15.13 Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të shumës 120,000, të dhuruar nga kushërinjtë në vitin 2007, por duke qenë se kemi të bëjmë me një vlerë minimaliste, Komisioni e konsideroi si të papërfillshme peshën që zë kjo shumë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe

⁸⁴ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.11.2022, e shtetasës A. N., e cila deklaroi se me rastin e martesës së djalit dhe lindjes së vajzës së tij i ka dhuruar me bashkëshortin shumën *cash* prej 50,000 lekësh; deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.11.2022, e shtetasve B. dhe I. N. (babai dhe xhaxhai i I. N.), të cilët deklarojnë se së bashku me motrën e tyre F. L., me rastin e martesës dhe lindjes së vajzës së I. N., në vitin 2007 i kanë dhuruar shumën 100,000 lekë.

⁸⁵ Me vërtetimin nr. *** prot., datë 18.11.2022, të ***, depozituar nga subjekti në pyetësorin nr. 4.

⁸⁶ (i) Shkresë nr. *** prot., datë 18.11.2022, nga Spitali Rajonal ***, për të ardhurat nga punësimi për shtetasen A. N.; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 18.11.2022, nga Spitali Rajonal ***, për të ardhurat nga punësimi për shtetasin N. N.; (iii) llogari e pagës në Credins Bank, në të cilën kreditohen për llogari të shtetasit N. N. pagat nga Poliklinika e Specialiteteve nr. *** për periudhën janar 2007 – dhjetor 2010.

⁸⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 10.11.2022, nga DRSSH Elbasan.

personit të lidhur me të, duke mos ndikuar në një vlerësim të subjektit të rivlerësimit në lidhje me kriterin e pasurisë, parë kjo edhe nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit.

16. Bashkëpronar me 1/3 të një apartamenti me sip. 153 m², i pahipotekuar, në Tiranë, me adresë: Njësia Administrative nr. *, rruga ****, p. ***, ap. *** (vendimi nr. ***, regjistri ***, datë 22.6.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier). Burimi i krijimit: me trashëgimi ligjore pas vdekjes së babait, sipas vendimit nr. ***, datë 22.6.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier “Për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë”.**

16.1 Në pyetësin standard⁸⁸, subjekti ka deklaruar se në fillim të vitit 2004 deri fundi i vitit 2005 ka jetuar në Tiranë, në rrugën ****, p. ***, kati *** i banimit, ap. ***, që ka prenotuar babai i tij në vitin 2002 dhe që është bërë i banueshëm në fillim të vitit 2004. Bashkëlidhur, subjekti ka depozituar: (i) aktmarrëveshjen datë 19.10.2002, të lidhur midis sipërmarrësit, shoqëria **** sh.p.k., dhe porositësit N. N., për ndërtimin e apartamentit nr. *** (3+1) kati 1, me sip. 152 m², kundrejt vlerës 58,000 USD. Në aktmarrëveshje përcaktohet se: “Me lidhjen e kontratës derdhen 50,000 USD. Pjesa tjetër 8,000 USD derdhet me lidhjen e kontratës përfundimtare të shitblerjes”; (ii) kontratën e shitjes datë 15.6.2012⁸⁹, lidhur midis shitësit, shoqëria **** sh.p.k., dhe blerëses A. N., për blerjen e apartamentit nr. ***, me sip. 158.4 m², kati ***, me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në rrugën ****, ku citohet se çmimi 58,000 USD është likuiduar jashtë zyrës noteriale; (iii) mandatin datë 18.6.2012 nga Credins Bank, ku shtetasja A. N. ka paguar taksën e shitblerjes së pasurisë në favor të buxhetit të shtetit, në shumën 158,400 lekë; (iv) vërtetimin e pronësisë datë 18.6.2012 dhe hartën treguese për ap. ***, me sip. 158.4 m², kati ***, në rrugën ****, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në emër të shtetasës A. N. si pronare e vetme; (v) librezën e furnizimit me ujë në emër të shoqërisë **** sh.p.k., lëshuar sipas kontratës nr. *** për apartamentin nr. ***, shk. ***.

16.2 ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Veri⁹⁰ konfirmon pasurinë apartament nr. ***, p. ***, shk. ***, kati ***, me sip. 158.4 m², të regjistruar në datën 21.8.2013 në emër të shtetasës A. K. N., me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***.

16.3 Referuar çmimit të EKB-së për vitin 2002, për zonën e Tiranës, si dhe kursit këmbimit në datën e aktmarrëveshjes për prenotim apartamenti, rezulton⁹¹ se çmimi i blerjes së këtij apartamenti 58,000 USD është më i lartë se çmimi referencë, pra nuk kemi situatë të çmimit preferencial.

16.4 FSHU-ja (OSHE) konfirmon⁹² se me emër të shtetasit N. N. identifikohet kontrata e furnizimit nr. *** në instancën Tiranë, rruga ****, e hapur në datën 4.11.2002.

Gjithashtu, FSHU-ja ka depozituar⁹³ pranë Komisionit të dhëna mbi konsumin dhe pagesat e energjisë elektrike për periudhën janar 2007 – tetor 2023, ku nuk ngrihen dyshime që ky apartament mund të jetë përdorur nga subjekti dhe familja e tij (bashkëshortja e fëmijët).

16.5 Në pyetësin nr. 2, subjekti shpjegon se kjo kontratë me FSHU-në i përket banesës në pronësi 100% të nënës së tij, banesë të cilën ajo e ka blerë me kontratë shitjeje datë 15.6.2012 nga firma ndërtuese pasi ka paguar edhe këstin e tretë. Në këtë banesë banon nëna dhe motra e tij.

⁸⁸ Përgjigja nr. 1 e pyetësit standard.

⁸⁹ Kontratë shitjeje nr. ***, datë 15.6.2012, e noteres M. D..

⁹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 18.3.2021, e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri, drejtuar Komisionit.

⁹¹ Çmimi i EKB është $46,574 \text{ lekë/m}^2 \times 158.40 \text{ m}^2 = 7,377,321.6 \text{ lekë}$ / çmimi i blerjes së apartamentit $58,000 \text{ USD} \times 139,46 \text{ kurs}$ këmbimit = 8,088,680 lekë.

⁹² Me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2021, të FSHU-së.

⁹³ Me shkresën nr. *** prot., datë 10.11.2023, të FSHU-së, drejtuar Komisionit.

16.6 Në pyetësonin nr. 2, subjekti ka deklaruar⁹⁴ se kjo pasuri është porositur nga babai i tij në vitin 2002, kur objekti ishte në fazë ndërtimi dhe i ati i ka paguar vetë dy këstet e para. Apartamenti u porosit sepse prindërit jetonin në Fier dhe po përgatiteshin të transferoheshin në Tiranë, ku erdhën në shkurt të vitit 2005. Apartamenti është bërë i banueshëm në mars të vitit 2004, sikurse provohet nga librezja e ujësjellësit. Pas vdekjes së babait, nëna është pronare e vetme e apartamentit pasi ka paguar këstin e tretë dhe ka lidhur kontratën e shitblerjes datë 15.6.2012, që e ka regjistruar në ZVRPP-në Tiranë. Pasi është njohur me vendimin⁹⁵ gjyqësor datë 22.6.2010 për çeljen e dëshmisë së trashëgimisë, subjekti, pa u konsultuar me nënën dhe duke menduar se e gjithë vlera ishte likuiduar nga babai i tij, ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2010 se është bashkëpronar i 1/3 së këtij apartamenti. Më vonë, pasi mori vesh statusin e kësaj prone, nuk e ka deklaruar më bashkëpronësinë, duke e konsideruar deklarin e vitit 2010 një gabim të tij.

16.7 Në vijim të përgjigjes, subjekti shpjegon se prindërit i kanë pohuar se burim të ardhurash për krijimin e apartamentit kanë qenë:

- a) të ardhurat nga puna e babait si mjek kirurg-urolog nga viti 1994, në shtet e privat, në Fier e Tiranë;
- b) të ardhurat nga puna e nënës si mjek laborante anatomo-patologe që nga viti 1974 në Fier etj.;
- c) të ardhurat e fituara nga depozitimi e një sasive parash në firmat piramidale në Fier dhe Vlorë nga babai gjatë viteve 1994 – 1997 (provuar me dokumentet bashkëlidhur);
- d) të ardhura të tjera të akumuluar si kursime ndër vite nga familja e origjinës;
- e) shumat monetare që babai ka marrë hua nga persona të ndryshëm.

16.8 Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti ka depozituar dokumentacionin provues: (i) leje datë 3.4.2009, për ushtrim profesioni si mjek nga shtetasi N. N.; (ii) kontratë shitblerjeje apartamenti datë 15.6.2012; (iii) vendim gjyqësor datë 22.6.2010, për çelje dëshmie të trashëgimisë ligjore; (iv) kopje e librezës nr. *** për furnizimin me ujë në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., për ap. **, ku figuron i paguar konsumi për periudhën mars 2004 – dhjetor 2005; (v) librezë pune në emër të shtetasit N. N., që provon se ky shtetas ka punuar si mjek vetëm në institucione shëndetësore shtetërore; (vi) mandatar-këtimin nr. **, datë 11.2.1997, të shoqërisë “****” për depozitim e shumës 1,290,000 lekë nga shtetasi N. N. dhe mandatpagesën e kreditorëve të kësaj shoqërie për shumën 110,000 lekë, tërhequr në BKT në datën 5.7.2005 nga ky shtetas.

16.9 Administratori i shoqërive huamarrëse konfirmon⁹⁶ se shtetasi N. N. ka depozituar kapital në shumën 1,290,000 lekë në datën 11.2.1997, ka tërhequr interesa 290,000 lekë (datë s’ka) dhe ka mbetur gjendje 1,000,000 lekë. Shtetasi N. N. ka përfituar si kreditor me koeficient shpërndarjeje 11%, shumën 110,000 lekë që e ka tërhequr pranë BKT-së.

16.10 Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti dhe atij që ka administruar Komisioni, nuk u provua huamarrja e shumave nga babai i subjektit tek persona të tretë dhe as punësimi i babait të tij në aktivitet privat.

16.11 Për të rikonfirmuar pagesën e këstit 8,000 USD nga nëna e tij për blerjen e apartamentit, në pyetësonin nr. 3, subjekti ka shpjeguar⁹⁷ se shënimi “Çmimi i blerjes 58,000 USD është likuiduar nga blerësja jashtë zyrës noteriale” në kontratën e blerjes datë 15.6.2012 është bërë për të dokumentuar likuidimin total të shumës që nëna si blerëse i detyrohej firmës, por në kohën e

⁹⁴ Përgjigja nr. 1/c e pyetësonit nr. 2.

⁹⁵ Vendim nr. **, datë 22.6.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁹⁶ Me shkresën nr. ** prot., datë 15.11.2022, të Ministrisë së Financave, Shoqëritë Huamarrëse në Administrim.

⁹⁷ Përgjigja nr. 1 e pyetësonit nr. 3.

lidhjes së kontratës ajo ka paguar vetëm pjesën e mbetur 8,000 USD. Në vijim, subjekti shpjegon se nuk ka asnjë tagër mbi këtë pronë, pasi është ndarë nga trangu familjar në vitin 2005, kur as prindërit e tij nuk kishin tagër pronësie mbi këtë apartament, i cili ishte në pronësi të shoqërisë ndërtuese. Nëna e tij u bë pronare e vetme vetëm në vitin 2012 (bashkëlidhur përgjigjes⁹⁸, deklarata noteriale datë 21.12.2022 e administratorit të shoqërisë “***” sh.p.k., i cili konfirmon shpjegimet e subjektit).

16.12 Për sa më lart, referuar fakteve që kjo pasuri është blerë nga prindërit e subjektit të rivlerësimit me të ardhurat nga puna e tyre dhe nuk u vërtetua që subjekti të ketë kontribuar financiarisht në krijimin e saj; pothuajse i gjithë çmimi i blerjes është paguar që në vitin e parë të subjektit në detyrë nga familja e origjinës së subjektit; kontrata e shitblerjes së apartamentit është lidhur nga nëna e tij, çka e bën atë pronare të vetme mbi këtë pasuri; subjekti ka banuar në apartament për shkak të marrëdhënies familjare vetëm në vitet 2004 – 2005 për një kohë të shkurtër, më pak se dy vjet, si pjesë e familjes së tij të origjinës dhe përpara se të lidhte martesë; subjekti që nga viti 2006 e në vazhdim ka jetuar me bashkëshorten dhe fëmijët e tij në apartamentin e blerë nga vjehri i tij B. N.; në këtë apartament kanë banuar dhe vazhdojnë të banojnë pa ndërprerje nëna dhe motra e subjektit – në përfundim të hetimit, Komisioni nuk gjeti asnjë element që e lidh subjektin e rivlerësimit me këtë pasuri, nuk konstatoi problematika të karakterit ligjor për këtë pasuri dhe nuk ngriti dyshime se ajo është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, prandaj vlerësoi të mos hetojë më tej për mundësinë financiare të krijimit të kësaj pasurie nga familja e origjinës së subjektit të rivlerësimit.

17. Automjeti tip “Volkswagen Passat”, me targë *, regjistruar në DRSHTRR-në Tiranë në vitin 2009, me emrin I. N.. Vlera: 4,500 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit:**

17.1 Kjo pasuri është deklaruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2009.

17.2 DPSHTRR-ja konfirmon⁹⁹ se në pronësi të shtetasës I. N. ka qenë i regjistruar automjeti tip “Volkswagen Passat”, me targë *** (***) dhe ka depozituar dokumentacionin, nga ku rezulton se sipas aktit të zhdoganimit datë 2.5.2002 të Doganës Fier, automjeti është zhdoganuar nga shtetasi L. I., i cili e ka sjellë nga Italia. Që nga momenti i zhdoganimit të automjetit, shtetasja I. N. është blerësja e tretë e tij sipas kontratës datë 2.11.2005¹⁰⁰ që ajo ka lidhur me shitësin S. Sh. kundrejt vlerës 4,500 euro. Sipas certifikatës së pronësisë datë 22.6.2009, shtetasja I. N. figuron pronare e këtij automjeti. Me kontratën datë 20.2.2012¹⁰¹, shtetasja I. N. ia shet automjetin blerësve F. R. dhe D. L. me vlerën 630,000 lekë, shitje që shtetasja I. N. e ka deklaruar edhe në DIPP-në e vitit 2012.

17.3 Komisioni hetoi¹⁰² për ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit S. Sh., por nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

⁹⁸ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.12.2022, ku administratori i shoqërisë “***” sh.p.k. deklaroi se me lidhjen e aktmarrëveshjes datë 19.10.2002 ka marrë nga shtetasi N. N. shumën 50,000 USD me dy këste, ndërsa me lidhjen e kontratës së shitblerjes datë 15.6.2012 ka marrë nga shtetasja A. N. kështu e tretë prej 8,000 USD jashtë zyrës noteriale dhe është likuiduar plotësisht çmimi i apartamentit.

⁹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 19.2.2021, e DPSHTRR-së drejtuar Komisionit.

¹⁰⁰ Kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.11.2005.

¹⁰¹ Kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.2.2012.

¹⁰² Shkresë nr. *** prot., datë 17.11.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe shkresë nr. *** prot., datë 14.11.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

17.4 Për sa më lart, rezultoi se personi i lidhur I. N. nuk e ka deklaruar këtë automjet në DIPP-në e viteve 2005 – 2008, si dhe nuk ka deklaruar burim krijimi dhe as dokument provues për këtë mjet. Gjithashtu, diferenca midis çmimit të blerjes dhe çmimit të shitjes është 76,860 lekë¹⁰³, por nuk rezulton që subjekti të ketë paguar tatimin mbi të ardhurat nga kjo diferencë. Për këto, Komisioni i kërkoj shpjegime subjektit në pyetëtorin nr. 2.

17.5 Në pyetëtorin nr. 2, subjekti ka deklaruar¹⁰⁴ se ky automjet është blerë nga bashkëshortja në vitin 2005 para se të martohet me të, pra është pasuri paramartesore. Automjeti me vlerën 4,000 euro është blerë me të ardhurat personale të saj ndër vite (paga, shpërblime, orë jashtë orarit, dieta e kursime të saj dhe të familjes së saj), ndërsa për diferencën 500 euro ajo i ka dhënë shitësit dy aparate celularë të përdorur, që asaj ia kishin falur. Mjeti është shitur nga bashkëshortja në datën 20.2.2012 në vlerën 630,000 lekë sipas kontratës, por realisht është shitur në euro dhe bashkëshortja ka marrë 4,500 euro, ndërsa noterja ka shkruar ekuivalencën në lekë me kursin e tregut të lirë të ditës për efekt akti (kursi i këmbimit 139.32 lekë). Nga krahasimi i çmimit të shitjes me çmimin e blerjes rezulton se automjeti është shitur pothuajse sa është blerë dhe pa fitim, prandaj nuk është paguar tatim-fitimi mbi diferencën shitje-blerje.

17.6 Në vijim të përgjigjes, subjekti ka deklaruar¹⁰⁵ se pasi bashkëshortja e tij ka blerë automjetin në vitin 2005, është paraqitur në DPSHTRR për të regjistruar kontratën e shitjes, por aty ka mësuar se automjeti ka pasur probleme me dokumentet dhe dosja e tij ishte sekuestruar nga Prokuroria e Rrethit Fier. Në këto kushte, ajo ka kontaktuar me personin që ia shiti automjetin dhe ka kërkuar ta kthejë atë dhe të marrë prej tij shumën e parave që ajo i pagoi. Shitësi i ktheu një pjesë të parave, duke pretenduar se pjesën tjetër e kishte harxhuar. Në pritje për të marrë pjesën tjetër të parave, bashkëshortja nuk e ka përdorur automjetin, por i ktheu shitësit kopjen e saj të kontratës së shitjes deri kur në vitin 2009 është njoftuar nga shitësi se automjeti është i lirë nga çdo barrë e problem e nëse ajo donte ta merrte sërish me të njëjtin çmim si më parë, ai ishte dakord. Bashkëshortja i dha pjesën e parave që shitësi i kishte kthyer, u bë pronare e automjetit dhe e deklaroi këtë automjet në DIPP-në e vitit 2009, pasi u mbyllën problemet ligjore me automjetin. Pra, për arsyet që bashkëshortja nuk dispononte kontratën e shitjes, nuk ishte pronare e automjetit dhe automjeti ishte pasuri paramartesore (pasi ata lidhën martesë në gusht të vitit 2007), bashkëshortja nuk mund ta deklaronte mjetin në DIPP-në e viteve 2005, 2006, 2007 e 2008.

17.7 Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se kjo është pasuri e krijuar përpara martesës së subjektit të rivlerësimit me shtetasen I. N. dhe është shitur përpara plotësimit të deklaratës *Vetting*, prandaj subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë detyrimin ta deklarojnë atë në deklaratë, si dhe të provojnë burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie. Gjithashtu, automjeti është shitur me të njëjtin çmim që është blerë dhe për këtë pasuri nuk u konstatuan problematika. Për këto arsye, Komisioni vlerësoi të mos hetojë për mundësinë financiare të krijimit të kësaj pasurie.

18. Analiza financiare e viteve 2002 – 2016

Nga analiza e deklaratave të interesave pasurorë privatë/vjetorë dhe e deklaratës *Vetting* për periudhën e hetimit 2002 – 2016 të kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe për të krijuar pasurinë.

¹⁰³ Çmimi i shitjes 630,000 lekë - çmimi blerjes 553,140 lekë (4,500 euro llogaritur me kursin këmbimit të euros 122.92 në datën 2.11.2005) = 76,860 lekë.

¹⁰⁴ Përgjigjja nr. 1/a e pyetëtorit nr. 2 (faqja 60 e pyetëtorit nr. 2).

¹⁰⁵ Përgjigjja në faqen 16 të pyetëtorit nr. 2.

	Para 2002	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	0	0	200,000	0	581,936	1,050,364	837,357	130,597	389,585	141,782	529,548	-156,760	344,301	-189,393	615,726	251,029
Autoveturë Golf 4,me targë ***																
Apartament me sip. 62.5m2, Fier																
Apartament në përdorim me sip.93m2, adresa Rr***																
Autonjet Benz 190D me targë *** , prodhim v.1986			200,000													
Autoveturë Wolksvagen Passat me targë ***						553,140			0							
DIFERENCA LIKUIDITETI (LIK. AKTUAL - LIKUIDITETI)	0	0	0	0	581,936	497,224	837,357	130,597	389,585	141,782	529,548	-156,760	344,301	-189,393	615,726	251,029
LIKUIDITETE NË FILLIM TË VITIT		0	0	0	0	581,936	1,079,160	1,916,517	2,047,114	2,436,700	2,578,482	3,108,029	2,951,269	3,295,570	3,106,177	3,721,903
LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT		0	0	0	581,936	1,079,160	1,916,517	2,047,114	2,436,700	2,578,482	3,108,029	2,951,269	3,295,570	3,106,177	3,721,903	3,972,932
DETYRIME		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1,000,000	0	950,000
Kredi Union Bank _950,000																950,000
Kredi Union Bank _1,000,000														1,000,000		
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	0	0	200,000	0	581,936	1,050,364	837,357	130,597	389,585	141,782	529,548	-156,760	344,301	-1,189,393	615,726	-698,971
TE ARDHURA dokumentuar	1,236,588	523,556	643,730	1,005,315	790,611	2,272,700	1,634,266	2,236,786	2,046,088	2,466,717	2,641,577	3,059,856	2,589,798	3,308,290	3,557,135	3,799,340
Të ardhura nga paga si prokuror Kavajë							611,150	933,533	937,284	915,261	1,024,271	1,054,257	903,521	0		
Të ardhura nga paga si OPGJ + prokuror Tiranë	1,236,588	523,556	643,730	805,315	790,611	807,172	288,634						77,005	1,254,637	1,202,296	1,200,721
Të ardhura nga paga në OST						912,388	406,482	1,161,253	1,038,648	1,476,324	1,542,054	1,305,098	1,498,956	1,564,952	1,694,940	1,927,444
Të ardhura si anëtare Këshillit Mbikqyrës							0	0	0	0	0	0	36,000	216,000	188,000	0
Të ardhura si kryetare Këshillit Mbikqyrës							0	0	0	0	0	0	0	0	25,500	255,000
Të ardhura nga interesat bankare									70,156	75,132	75,252	70,501	74,316	55,301	31,399	27,175
Të ardhura nga dhurimet							328,000	142,000								
Të ardhura nga shija e mjeteve				200,000								630,000				
Të ardhura nga bashkëshortja para martesë/Llogari për efekt të analizës							553,140									
Të hyra nga L. V për pagesën e kredisë														217,400	415,000	389,000
SHPENZIME	502,010	93,864	93,864	93,864	167,151	435,594	561,094	409,860	656,766	412,636	1,155,276	528,840	571,107	2,079,880	1,797,554	2,570,479
Shpenzime jetike	502,010	93,864	93,864	93,864	109,557	219,114	412,944	409,860	409,860	409,860	409,860	528,840	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime udhëtimi				0	57,594	216,480	78,150	0	246,906	2,776	745,416	0	7,011	8,407	488,933	293,871
Shpenzime mobilimi							70,000									
Shpenzime këst kredisë														181,482	411,517	786,241
Tërheqje nga L. V në llogarinë e I.N														1,010,000		550,000
Llogari për efekt të analizës financiare							0									
LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT	0	0	0	0	581,936	1,079,160	1,916,517	2,047,114	2,436,700	2,578,482	3,108,029	2,951,269	3,295,570	3,106,177	3,721,903	3,972,932
Llogari page Union bank _I ***									206,031	259,095	173,739	109,863	26,538	175,872	192,755	224,497
Llogari rrjedhëse Union Bank _I Euro ***												0				
Kartë krediti MC _I Euro ***											-1,956	0				
Llogari kursimi Union _I ***														35,977	162,524	143,662
Llogari kursimi Union _I Euro ***														125,312	221,417	28,219
Llogari depozite Union _I Euro ***														0		
Llogari depozite Union _I ***																400,000
Kartë krediti MC _I Euro ***																-58,133
Llogari rrjedhëse Union Bank _I ***														35,668	38,551	40,372
Llogari page Credins _D.N														23	36	75
Depozitë Credins D.N								1,000,100	1,070,256	1,145,388	1,220,639	1,291,141	1,365,457	1,420,758	1,452,156	1,479,332
Llogari rrjedhëse Credins ***																
Llogari page RBAL DN ***					581,936	1,031,716	447,334	391,143	337,459	7,058	542,098	70,679	500	605	176,834	216,804
Depozitë RBAL DN						1,000,000										
Llogari page RBAL IN					0	0	87	87	87	87	87	87	87	87	87	87
Llogari page BKT _I														123,150	0	0
Llogari bonusi Bebe												5,000	5,000	5,000	10,000	10,000
Llogari rrjedhëse ISPB _I ***					0	47,444	32,545	200,607	1,843	0						
Llogari rrjedhëse ISPB_Euro_I ***							436,552	455,178	276,946		277,279	42,320	1,140	192,995	502	-11
Llogari rrjedhëse ISPB_USD_I ***										4,427	4,445	4,521	4,355	4,842	4,842	5,402
Llogari depozite _ISPB_Euro_I									544,077	885,148	1,126,657	1,170,442				
Llogari depozite _ISPB_Euro_I												298,396				
Llogari depozite _ISPB_Euro_I													1,577,487	1,301,531	1,462,712	1,482,615
Deklarim në DIPP																
Analiza dokumentuar	734,578	429,692	349,866	911,451	41,524	786,742	235,815	1,696,329	999,737	1,912,299	956,753	2,687,777	1,674,390	2,417,803	1,143,855	1,927,832
Analiza kumulative	734,578	1,164,270														

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë

19. Në përfundim të prapësimeve lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit pretendon se në vlerësim të argumenteve e provave bashkëlidhur këtij prapësimi, bazuar në të dhënat apo dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ rezulton se ka deklaruar me vërtetësi çdo pasuri të zotëruar prej tij dhe bashkëshortes. Të ardhurat e familjes së tij rrjedhin tërësisht nga burime të ligjshme dhe janë pasqyruar me vërtetësi në deklaratat periodike dhe atë *Vetting*. Këto të ardhura mbulojnë tërësisht vlerën e pasurisë neto të familjes së tij, si dhe kostot e nevojshme për përballimin e jetesës, në fund të secilës prej periudhave të mbyllura në datën 31 dhjetor.

20. Si konkluzion përfundimtar, bazuar në argumentet dhe provat bashkëlidhur prapësimeve, subjekti i rivlerësimit vlerëson se e kalon testin e standardit kushtetues, të provuarit bindshëm të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, sipas përcaktimit të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe, për këtë arsye, gjendet edhe në kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, duke arritur në një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë.

Vlerësimi i Komisionit në lidhje me kriterin e pasurisë

21. Në përfundim të shqyrtimit të kriterit të pasurisë, duke marrë në konsideratë rezultatet e hetimit administrativ në lidhje me pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, personat e lidhur me të dhe personat e tjerë të lidhur me të, krijimin e disa pasurive në periudhën para fillimit të detyrës dhe para lidhjes së martesës së subjektit, si dhe duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, Komisioni vlerëson se:

- Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka deklaruar saktësisht e plotësisht në këtë deklaratë pasuritë e tij, të personave të lidhur me të dhe të personave të tjerë të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- Subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara dhe nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht.
- Subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti ka treguar një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka dërguar¹⁰⁶ pranë Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Nushi, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 18.11.2022. Sipas këtij raporti, Grupi i Punës i AKSIK-së në përfundim të verifikimit ka konkluduar se:

a) Formulari i deklaramentit të subjektit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.

b) Subjekti i rivlerësimit Dritan N. Nushi ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato që ka deklaruar vetë në deklaratën për kontrollin e figurës.

c) Për subjektin e rivlerësimit Dritan N. Nushi nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të

¹⁰⁶ Me shkresat nr. *** prot., datë 30.11.2022 dhe nr. *** prot., datë 21.11.2017, të AKSIK-së.

papërshatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

2. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar konfirmon¹⁰⁷ se pranë kësaj Prokurorie dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në emër të subjektit Dritan Nushi.

3. Me shkresën nr. *** prot., datë 30.3.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton¹⁰⁸ se nga përgjigjet e dërguara nga të gjitha prokuroritë e rretheve gjyqësore, për subjektin Dritan Nushi nuk ka procedime penale të mosfilluara, të pushuara apo të pezulluara¹⁰⁹.

4. Nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së tij për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt të subjektit në veprime të dyshimta.

5. Nga hetimi i kryer, Komisioni nuk ngriti dyshime për sa i përket përshtatshmërisë së subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës në lidhje me kriterin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Grupi i Punës në KLP, në bazë të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016, ka hartuar raportin¹¹⁰ mbi aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Nushi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i miratuar me vendimin¹¹¹ nr. ***, datë 16.1.2023.

1.1 Ky raport, për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016 ka analizuar¹¹² të dhënat e rezultuara nga këto burime të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti së bashku me 3 dosjet e përzgjedhura nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjet e vëzhguara të përzgjedhura me short; (iii) të dhënat nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme; (iv) të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në KLP, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional, për të cilat Grupi i Punës ka konkluduar me një vlerësim pozitiv për subjektin e rivlerësimit¹¹³.

¹⁰⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 10.2.2021, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

¹⁰⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.3.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme.

¹⁰⁹ Shkresat e prokurorive të rretheve gjyqësore: Pogradec nr. *** prot., datë 24.2.2021; Elbasan nr. *** prot., datë 3.3.2021; Tiranë nr. *** prot., datë 19.2.2021; Krujë nr. *** prot., datë 5.3.2021; Durrës nr. *** prot., 17.2.2020; Gjirokastrë nr. *** prot., datë 18.2.2021; Korçë nr. *** prot., datë 26.2.2021; Pukë nr. *** prot., datë 18.2.2020; Tropojë nr. *** prot., datë 17.2.2020; Kavajë nr. *** prot., datë 10.3.2021; Kurbin nr. *** prot., datë 18.2.2021; Përmet nr. *** prot., datë 17.2.2020; Kukës nr. *** prot., datë 18.2.2021; Berat nr. *** prot., datë 18.2.2021; Sarandë nr. *** prot., datë 23.2.2021; Dibër nr. *** prot., datë 23.2.2021; Vlorë nr. *** prot., datë 24.2.2021; Lushnjë nr. *** prot., datë 23.2.2021; Lezhë nr. *** prot., datë 23.2.2021; Shkodër nr. *** prot., datë 24.2.2021; Fier nr. *** prot., datë 26.2.2021.

¹¹⁰ Raporti nr. *** prot., datë 16.1.2023, i KLP-së.

¹¹¹ Dërguar pranë Komisionit me shkresën nr. *** prot., datë 24.1.2023, të KLP-së.

¹¹² Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

¹¹³ **Aftësitë profesionale**, ku përfshihen: (a) *Njohuritë ligjore* dhe (b) *Arsyetimi ligjor*. Në lidhje me *Njohuritë ligjore*, subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga 5 dosjet e shortuara konstatohet se e ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret. Kështu, menjëherë pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore dhe afatin e kryerjes së tyre. Ai identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme. Në lidhje me *Arsyetimin ligjor*, subjekti shfaq aftësi në arsyetim ligjor, tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej tij të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme. Në akte, subjekti bën analizë mbi rrethanat e faktit dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore.

Formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit

2. Formulari i vetëdeklarimit paraqitet i nënshkruar dhe i plotë nga subjekti, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe i shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm. Sipas të dhënave, subjekti është diplomuar “Jurist” pranë Universitetit të Tiranës në vitin 1998 me rezultate shumë të mira, si dhe ka mbrojtur pranë këtij universiteti diplomën MND në Shkenca Penale në vitin 2011.

3. Për periudhën shkurt 2002 – maj 2007, subjekti ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa për periudhën janar 2007 – nëntor 2013 ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Nga muaji nëntor 2013 deri aktualisht, subjekti ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Subjekti ka deklaruar trajnimet e kryera brenda dhe jashtë Shkollës së Magjistraturës, shoqëruar me certifikatat përkatëse, si dhe vlerësimet e punës nga Prokurori i Përgjithshëm, ku për vitin 2016 ka marrë vlerësimin “Mjaftueshëm” nga Prokurori i Përgjithshëm.

5. Subjekti, për tri vitet e fundit të detyrës, ka deklaruar 1258 çështje penale të caktuara, 1202 çështje penale të përfunduara dhe 79 çështje penale të mbartura në vitin e fundit.

6. Tri dokumentet ligjore të përzgjedhura për vlerësim nga subjekti i rivlerësimit

Dokumenti ligjor nr. 1 – Vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2014, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Shefi i seksionit për shërbimet mbështetëse, z. P. B., ka kallëzuar se shtetasi A. M. nuk kishte dorëzuar pranë Komisarariatit të Policisë Nr. *** Tiranë armën e zjarrit pistoletë që e dispononte për shkak të funksionit si deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Pasi kishte humbur të drejtën për mbajtje armë zjarri, ishte njoftuar zyrtarisht për dorëzimin e saj, por nuk e kishte bërë. Shtetasi A. M. ka shpjeguar se kur mbante postin e ministrit të Brendshëm armën e zjarrit ia kishte dhuruar homologu i tij kroat dhe në kutinë e armës kishte edhe një dedikim personal. Konform ligjit ai ishte pajisur me leje për mbajtjen e kësaj arme dhe në pretendimin e tij e drejta për mbajtje arme nuk i është hequr në rrugë administrative.

Subjekti ka kërkuar informacion për lejen e armës dhe ka administruar nga organi kompetent vendimin

Aftësitë organizative, ku përfshihen: (a) *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*; (b) *Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*; (c) *Aftësia për të administruar dosjet*.

Në lidhje me *Aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë*, gjatë periudhës së rivlerësimit subjekti ka kryer detyrat e tij sipas pikave 2 dhe 2.1 të urdhrat nr. ***, datë 9.5.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në Prokuroritë e shkallës së parë”. Nga analiza e 5 çështjeve të përzgjedhura në short, qëndrimi i tij është brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, subjekti i rivlerësimi ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet. Në lidhje me *Aftësinë për të kryer procedurat gjyqësore*, subjekti merr pjesë në gjykim si palë dhe tregon profesionalizëm në gjykim e në qëndrimin që mban për çështjet në gjykim. Në lidhje me *Aftësinë për të administruar dosjet*, dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, tregojnë faktin penal, qëndrimin e prokurorit në prokuroritë ku ka ushtruar funksionin dhe disponimin e gjykatës.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, ku përfshihen: (a) *Etika në punë*; (b) *Integriteti*; (c) *Paanësia*. Në lidhje me *Etikën në punë*, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Në lidhje me *Integritetin*, nuk konstatohen të dhëna për imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Në lidhje me *Paanësinë*, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit, nuk ka shkaqe paanësie të dokumentuara. Në asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera ndaj grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, ku përfshihen: (a) *Aftësitë e komunikimit*; (b) *Aftësia për të bashkëpunuar*; (c) *Gatishmëria për t'u angazhuar*. Në lidhje me *Aftësinë e komunikimit*, vërehet komunikimi i qartë dhe në përputhje me etikën e prokurorit. Në lidhje me *Aftësinë për të bashkëpunuar*, nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë. Në lidhje me *Gatishmërinë për t'u angazhuar*, subjekti rezulton se ka trajnim me temë në fushën penale, të organizuar pranë programit të Shkollës së Magjistraturës, të cilat janë përshkruar më sipër.

për heqjen e së drejtës për mbajtje arme këtij shtetasi. I njohur me këtë vendim, shtetasi A. M. ka deklaruar se para prokurorit është njohur për herë të parë me këtë fakt dhe pas këtij momenti do të vepronte konform ligjit.

Subjekti i rivlerësimit ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal” për kallëzimin nr. ***/2014.

Dokumenti ligjor nr. 2 – Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2016.

Në datën 12.4.2016 është arrestuar në flagrancë shtetasi I. M. për veprën penale “Vjedhje e energjisë elektrike” (neni 137 i Kodit Penal), pasi grupi i kontrollit të OSHE-së ka konstatuar se kishte rilidhur në mënyrë të paligjshme energjinë elektrike.

Ka rezultuar se ky abonent ishte debitor dhe i pyetur si person nën hetim ka pranuar veprën penale në ngarkim të tij. Subjekti analizon se nga provat e administruara në këtë procedim penal rezultoi se shtetasi I. M. me veprimet e tij ka konsumuar veprën penale “Vjedhje e energjisë elektrike”. Subjekti ka përpiluar kërkesën për vleftësimin dhe caktimin e masës së sigurimit personal, si dhe kërkesën për gjykimin e çështjes.

Në lidhje me dy dokumentet e mësipërme ligjore, të paraqitura për vlerësim profesional nga subjekti i rivlerësimit, si nga Grupi i Punës ashtu edhe nga ana e Komisionit nuk janë konstatuar problematika në lidhje me kriterin profesional.

Dokumenti ligjor nr. 3 – Vendim “Për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2015”.

Në datën 9.3.2015 është arrestuar në flagrancë shtetasi Z. R. M., i datëlindjes 24.7.1984, lindur dhe banues në ***, Meksikë. Arrestimi i këtij shtetasi është bërë pasi është kthyer si person i kategorisë “INAD” nga Turqia, pasi dyshohej se pasaporta e tij meksikane ishte e falsifikuar. Në datën 8.3.2015 ishte nisur për në Turqi, ku edhe është ndaluar nga autoritetet atje për të njëjtën arsye. Shtetasi nuk ka pranuar që pasaporta e tij ishte e falsifikuar, pasi e kishte nxjerrë nëpërmjet Konsullatës Meksikane në Los Angeles, SHBA.

Nga punonjësit e policisë kufitare, pasaporta i është nënshtruar ekzaminimit në laboratorin e policisë kufitare, nga ku ka rezultuar se dokumenti mund të ketë ndërhyrje falsifikuese.

Në aktin e ekspertimit teknik nr. ***, datë 23.3.2015, ardhur nga DPSH-ja, konkludohet se:

- *Tek pasaporta meksikane në emër të shtetasit Z. R. M., objekt ekspertimi, konstatohen ndërhyrje falsifikuese.*
- *Falsifikimi konsiston në riprodhimin e modularit të faqes së të dhënave me anën e makinave fotokopjuese me ngjyra (përfshirë skanerin); me plotësimin e të dhënave aktuale dhe ngjitjen në faqen nr. 1 të pasaportës.*

Në datën 13.5.2015, bazuar në nenin 328/1, shkronja “a” e Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka vendosur “Pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2015” në ngarkim të shtetasit Z. R. M., pasi del qartë se fakti nuk ekziston.

Në këtë vendim, subjekti citon se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është depozituar: praktika nr. *** prot., nëpërmjet së cilës përcillet dokumentacioni në lidhje me ndalimin e shtetasit meksikan Z. R. M. në datën 9.3.2015 në aeroportin e Rinasit; kopje e informacionit të dërguar nga Konsulli i Përgjithshëm i Nderit i Shteteve të Bashkuara të Meksikës në Shqipëri; dokumente¹¹⁴ të njehsuar me origjinalin që shtetasi M. ka dorëzuar në momentin që ka aplikuar për

¹¹⁴ (1) Kopje të formularit me fotografi, i plotësuar dhe nënshkruar nga shtetasi M. në Konsullatën e *** KA për t’u pajisur me pasaportë 3-vjeçare në datën 22.5.2014; (2) certifikatë lindjeje e shtetasit M., sipas regjistrit të Gjendjes Civile të Meksikës; (3) kartë matrikulli konsullor me fotografi, me afat 4-vjeçar, lëshuar po nga Konsullata Meksikane në *** KA; (4) kupon tatimor prej 74 USD i paguar në Konsullatë në ***, po për pajisjen me pasaportën në fjalë, në datën 22.5.2014 etj.

pasaportën që ka aktualisht etj. Ndër këto dokumente, subjekti vlerëson si me shumë rëndësi për hetimin një formular aplikimi për pasaportë të zakonshme me fotografi dhe gjurmë daktiloskopike të dy gishtave të dy duarve, i cili është plotësuar në Konsullatën e Meksikës në ***, me gjeneralitetet e Z. R. M. si ato në pasaportë, si dhe foto me ngjyra që është e tij, e njëjtë me foton që gjendet edhe në pasaportën e sekuestruar.

Subjekti ka konkluduar se nga dokumentacioni i ardhur rishtazi, megjithëse jo në rrugën e duhur procedurale, provohet se të dhënat që gjenden në pasaportën meksikane objekt ekspertimi të shtetasit Z. R. M. bashkë me fotografinë e këtij shtetasi janë të njëjta me ato të dërguara nga autoritetet meksikane, nëpërmjet praktikës së Drejtorisë së Policisë së Shtetit.

Për sa më lart, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë në konsideratë kryerjen e një akti ekspertimi si një provë e rëndësishme në vepra penale të këtij lloji (falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave...), me qëllim marrjen e një vendimi të bazuar në prova dhe ligj.

Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

7. Në prapësimet e tij, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se shtetasi Z. R. M. ka deklaruar gjatë pyetjes se është emigrant ekonomik në SHBA dhe disa ditë para arrestimit ishte larguar nga SHBA-ja për një udhëtim turistik në disa vende të Evropës dhe Azisë së bashku me shokun e tij E. S. që kishte pasaportë amerikane. Në periudhën 11.2.2015 – 7.3.2015, kur ka hyrë në Shqipëri nëpërmjet një pike kalimi tokësor nga Pogradeci, këta shtetas kanë udhëtuar në disa shtete: Danimarkë - Slloveni me rrugë tokësore - Kroaci - Mal i Zi - Kosovë - Maqedoni. Nga Pogradeci ka ardhur në Tiranë ku ka qëndruar vetëm një natë, në hostel “***”. Në datën 8.3.2015, ai është nisur për në Turqi nga aeroporti i Rinasit, duke udhëtuar me linjën ajrore “***” me destinacion Stambollin, Turqi. Në aeroportin e Stambollit është ndaluar nga policia vendase, me arsyen se pasaporta e tij meksikane është e falsifikuar. Në këto kushte, punonjësit e policisë në aeroportin e Stambollit e kanë kthyer sërish në Shqipëri. Ky shtetas ka deklaruar gjithashtu se në Shqipëri ka ardhur vetëm për qëllim turistik dhe nuk njeh njeri këtu. Së bashku me shokun e tij janë orientuar nëpërmjet internetit me një kompjuter portativ që kishte me vete, duke bërë para nisjes nga SHBA-ja të gjitha rezervimet në hotel dhe pagesat e biletave të avionëve. Në lidhje me pasaportën, shtetasi Z. R. M. e mohon faktin se ajo është e falsifikuar dhe ka deklaruar se para disa kohësh ka shkuar në mënyrë ilegale në Los Angeles të SHBA-së. Në maj të vitit 2014 ka aplikuar për pasaportë në Konsullatën Meksikane në Los Angeles, ku e kanë pajisur me këtë pasaportë që ka me vete, me afat trevjeçar. Për marrjen e këtij dokumenti thotë se ka paguar shumën 72 USD, si pagesë e nevojshme për kryerjen e procedurës së pajisjes me pasaportë.

8. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se pasaporta meksikane me nr. *** në emër të shtetasit Z. R. M. i është nënshtruar aktit të ekspertimit teknik nr. ***, datë 23.3.2015, ardhur nga DPSH-ja, nga i cili ka rezultuar: *i. Tek pasaporta meksikane në emër të shtetasit Z. R. M., objekt ekspertimi, konstatohen ndërhyrje falsifikuese; ii. Falsifikimi konsiston në riprodhimin e modularit të faqes së të dhënave me anën e makinave fotokopjuese me ngjyra (përfshi skanerin); me plotësimin e të dhënave aktuale dhe ngjijtjen në faqen nr. 1 të pasaportës.*

9. Në datën 13.5.2015, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka mbërritur¹¹⁵ informacioni dhe dokumentacioni¹¹⁶ origjinal në spanjisht dhe i përkthyer në shqip, që shtetasi Z. R.

¹¹⁵ Me anë të praktikës nr. *** prot., të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shteti dhe shkresës nr. *** prot., datë 29.4.2015, të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore dhe Diasporës në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë.

¹¹⁶ (i) Kopje e formularit me fotografi, e plotësuar dhe nënshkruar nga shtetasi M. në Konsullatën e *** KA për t’u pajisur me pasaportë 3-vjeçare në datën 22.5.2014; (ii) certifikatë lindjeje e shtetasit M., sipas regjistrit të Gjendjes Civile të Shteteve të Bashkuara të Meksikës; (iii) kartë matrikulli konsullor me fotografi, me afat 4-vjeçar, lëshuar po nga Konsullata Meksikane në *** KA; (iv) kupon tatimor paguar prej 74 USD në Konsullatë në *** për pajisjen me pasaportën në fjalë, në datën 22.5.2014 etj.

M. ka dorëzuar në momentin që ka aplikuar për pasaportën që ka aktualisht etj., informacion dhe dokumentacion ky i dërguar nga Ambasada e Meksikës në Romë për Shqipërinë, pasi Roma mbulonte edhe Shqipërinë, meqë Meksika nuk kishte përfaqësi të saj në vendin tonë në atë kohë.

10. Nënshkrimi që ka bërë shtetasi Z. R. M. në aktet procedurale të marrjes në pyetje nga Policia Shqiptare dallohet edhe me sy të lirë që është i njëjtë në të gjitha rastet, me nënshkrimin që ndodhet në aktet e dërguara nga Ambasada Meksikane në Romë, në aplikimin që ai ka bërë për t'u pajisur me pasaportë në Konsullatën e Meksikës në *** SHBA, si dhe me nënshkrimin në pasaportën e sekuestruar.

11. Nga të gjitha këto prova dhe fakte provohet se të dhënat që gjendeshin në pasaportën meksikane të sekuestruar, objekt ekspertimi nr. *** në emër të shtetasit Z. R. M. bashkë me fotografinë e këtij shtetasi, ishin të njëjta me të gjitha të dhënat dhe fotografitë e dërguara nga autoritetet meksikane pranë prokurorisë, nëpërmjet praktikës së ardhur nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe të kontrolluara edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Provohet se kjo pasaportë kishte dalë nga një konsullatë e huaj jashtë territorit të Meksikës. Provohet nga dokumentacioni i ardhur zyrtarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme se shtetasi Z. R. M., që është kapur si mbajtës i kësaj pasaporte në vitin 2015, ka qenë pikërisht ai që kishte aplikuar për t'u pajisur me të në ***, Kaliforni, SHBA dhe që e ka përfituar atë në rrugë ligjore. Nëpërmjet vulave që pasaporta kishte, provohet se me këtë pasaportë shtetasi Z. R. M. kishte udhëtuar nëpër disa vende të botës, pa problem. Deklarimet dhe alibitë e tij përputhen me provat e administruara. Shtetasi Z. R. M., me ato gjeneralitete, foto apo gjurmë daktiloskopike të dhëna dhe të krahasuara në sistem, deri në momentin e marrjes së vendimit nga subjekti, nuk rezultonte i skeduar apo i dyshuar për ndonjë aktivitet kriminal apo kryerjen e ndonjë veprë penale brenda ose jashtë Shqipërisë.

12. E vetmja provë kundër të gjitha këtyre provave është akti i ekspertimit teknik, i kryer nga një ekspert i Policisë Shkencore, duke u bazuar vetëm nga pamja vizuale e dokumentit dhe pa e krahasuar atë detyrimisht, me specimenin e këtyre dokumenteve që ruhen në arkivin e institucionit ku ai punonte, me arsyen që i kishte thënë verbalisht subjektit se në atë kohë institucioni i IPSH-së nuk dispononte një specimen të tillë, pra të shtetit të Meksikës.

13. Duke iu referuar dispozitës ligjore që parashikon veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve" dhe praktikës unifikuese të Gjykatës së Lartë, subjekti shpjegon se kjo vepër nga ana subjektive kryhet me dashje direkte, me motiv dhe qëllim fitimi monetar ose të ndonjë interesi tjetër. Dashja direkte evidentohet përmes: (a) dënjës se në dokument ka të dhëna të rreme; (b) dëshirës për t'i kryer veprimet; (c) kryerjes së veprimeve me qëllim fitimi apo ndonjë interesi tjetër personal. Nëse nuk arrihet të provohet ekzistenca e motivit dhe e qëllimit përfitues nga ana e të pandehurit, në përputhje me nenin 4 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit (*in dubio pro reo*), atëherë fakti nuk përbën vepër penale dhe në bazë të nenit 387 të këtij Kodi duhet të vendoset pushimi i akuzës ose i çështjes (sipas rastit).

14. Nga pikëpamja objektive vepra penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave, vizave" realizohet me veprime aktive të falsifikimit të letërnjoftimeve ose përdorimit të letërnjoftimeve të falsifikuara. Në vendimet nr. ***, datë 8.6.2017 dhe nr. ***, datë 16.6.2010, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është shprehur se vepra penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave, vizave" në drejtim të anës subjektive kryhet në formën e dashjes direkte, çka do të thotë se i gjykuari me dashje bën ndryshime të pjesshme ose falsifikon tërësisht të dhënat në dokument, ose e përdor dokumentin e falsifikuar duke e ditur që ai dokument është i tillë. Që të arrihet në konkluzionin se jemi përpara kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal në formën e përdorimit, do të duhet së pari të provohet përdorimi i aktit, por njëkohësisht të vërtetohet dijenia e subjektit të veprës penale se akti i përdorur prej tij përmban të dhëna të rreme, sikundër të jetë evident dhe qëllimi i fitimit apo çdo lloj interesi tjetër personal nga përdorimi i këtij dokumentacioni të falsifikuar.

15. Barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili duhet nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim t'i krijojë gjykatës bindjen “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm” se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri. Subjekti e ka vlerësuar aktin e ekspertimit së bashku me provat e tjera të administruara gjatë hetimit, duke përcaktuar vlerën provuese të secilës prej tyre në raport dhe harmoni edhe me provat e tjera. Në të kundërt, do të rezultonte se ka vepruar në kundërshtim me nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale (Çmuarja e provave) dhe nuk ka bërë një analizë të saktë të elementeve të veprës penale.

16. Ky pretendim, si dhe ekzistenca e provave që ndodhen në dosjen hetimore, çojnë në përfundimin se pretendimet e policisë se i hetuari kishte kryer veprën penale për të cilën dyshohet, nuk arritën të provohen në asnjë moment në mënyrë të plotë, të qartë dhe tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Për sa më sipër, subjekti shpjegon se i qëndron me bindje vendimmarrjes së tij datë 19.5.2015, si e bazuar plotësisht në prova e në ligj dhe që qëndron në fuqi edhe sot pa u ankimuar.

Vlerësimi i Komisionit

17. Komisioni, pasi mori në shqyrtim prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, vëren se në lidhje me analizën e elementeve të veprës penale që bën subjekti në prapësimet e tij, kjo i përket anës materiale të çështjes dhe për këtë Komisioni nuk ka kompetencë shqyrtimi dhe vlerësimi, referuar nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

18. Nga ana procedurale, Komisioni vlerëson se subjekti e ka çmuar aktin e ekspertimit në raport dhe në harmoni me provat e tjera të administruara gjatë hetimit, duke respektuar nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale “Çmuarja e provave”, për të arritur në konkluzionin nëse ka apo jo elemente të veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”.

19. Sa më lart, vlerësohet se subjekti ka dhënë argumente të mjaftueshme bindëse bazuar edhe në praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë se për procedimin në fjalë nuk është bërë e mundur të provohet plotësisht tej çdo dyshimi të arsyeshëm kryerja e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve” me të gjitha elementet e saj dhe, si rrjedhojë, çdo dyshim shkon në favor të pozitës së të akuzuarit. Për këtë arsye, subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal.

Në përfundim, Komisioni vlerësoi se në veprimet e subjektit nuk rezultuan mangësi që e ngarkojnë atë me përgjegjësi në lidhje me kriterin profesional.

20. Pesë dosjet e përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe objektiv

Dosja 1 – Kallëzimi penal nr. ***, datë regjistrimi 19.12.2013. **Dokumenti ligjor** – Vendim datë 23.1.2014 “Për mosfillimin e procedimit penal”

Në datën 15.12.2013, shërbimet e policisë janë njoftuar se në banesën e saj është djegur shtetasja M. Sh., e cila jetonte e vetme. Në përfundim të hetimeve është konkluduar se shkak i vdekjes së shtetasës ka qenë paraliza e qendrës respiratore, si pasojë e asfiksionit mekanik nga mbidozimi me dioksid karboni, në një rast fatkeq që nuk është shkaktuar nga të tretët.

Bazuar në nenin 290/1, shkronja “ç” dhe neni 291 i Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. ***, datë 19.12.2013.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë konfirmon¹¹⁷ se nuk ka pasur ankim ndaj vendimit të mosfillimit.

¹¹⁷ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 27.1.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në përfundim, Komisioni vlerësoi se në veprimet e subjektit të rivlerësimit nuk u konstatuan mangësi që e ngarkojnë atë me përgjegjësi në lidhje me kriterin profesional.

Dosja 2 – Procedimi penal nr. ***, datë regjistrimi 23.4.2014. **Dokumenti ligjor** – Vendim datë 4.9.2014 “Për pushimin e procedimit penal”

Në datën 23.4.2014, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Mashtrimi në sigurime” (neni 145 i Kodit Penal).

Referuar materialit kallëzues, me vendimin datë 26.8.2001, DRSSH Tiranë i ka caktuar pension pleqërie shtetases N. G., me periudhë sigurimi 29 vjet e 8 muaj. Në bazë të urdhrit nr. ***, datë 3.10.2010, ky përfitim është mbyllur, pasi janë konstatuar parregullsi nga auditi dhe përfituesja është deklaruar debitore për shumën 742,832 lekë. Pensioni i është paguar deri në datën 30.9.2008.

Subjekti ka konkluduar se sipas aktit të verifikimit, “mashtrimi” është konstatuar në datën 1.10.2008. Në procesverbalin e shqyrtimit të dosjes datë 25.3.2014 dhe në kallëzimin e DRSSH-së Tiranë citohet se përfitimi është paguar deri në datën 30.9.2008, por meqë nga momenti i konstatimit të faktit, ndërprerjes së pagimit të pensionit ndaj shtetases e deri në momentin e regjistrimit të procedimit penal kanë kaluar mbi 5 vjet, konform nenit 66/c të Kodit Penal, ndjekja penale nuk mund të vazhdojë. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 328/1, shkronja “d” e Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka vendosur pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë konfirmon¹¹⁸ se nuk ka pasur ankim ndaj vendimit të pushimit.

Në përfundim, Komisioni vlerësoi se në veprimet e subjektit të rivlerësimit nuk u konstatuan mangësi që e ngarkojnë atë me përgjegjësi në lidhje me kriterin profesional.

Dosja 3 – Procedimi penal nr. ***, datë regjistrimi 9.7.2013. **Dokumenti ligjor** – Vendim datë 3.7.2015 “Për pushimin e procedimit penal nr. ***”

Rezulton se procedimi penal është regjistruar pa emër autori të veprës penale, mbi bazën e kallëzimit datë 24.6.2013, që ka bërë Credins Bank ndaj shtetasit A. M. për veprat penale “Mashtrim” dhe “Vjedhje e bankave” (nenet 143 dhe 136 të Kodit Penal). Deri në datën 6.12.2013 hetimet janë kryer nga një prokuror tjetër e më pas nga subjekti i rivlerësimit.

Credins Bank ka pajisur shtetasin A. M. me kartën *Visa Electron* dhe e ka regjistruar në sistemin e bankës në nëntor të vitit 2009, si klient i Credins Bank, dega ***.

Në mars 2013, shtetasi A. M. është paraqitur fizikisht në degën e bankës ku ka plotësuar formularin e humbjes së kartës, formular në të cilin ka kërkuar të pajiset me kartë të re dhe është pajisur me të tillë në datën 6.3.2013. Rreth 8 muaj nga humbja e kartës, në datën 11.4.2013, në periudhën kohore 07:13:08 – 07:25:19, me kartën e vjetër të deklaruar të humbur janë tentuar katër transaksione, të cilat kanë mbetur në tentativë pasi karta e klientit ka qenë e bllokuar në sistem. Në datën 31.5.2013, në sistem vijonin të shkonin transaksionet e klientit me kartën e debitit, me të njëjtat vlera prej 1 GBP dhe me të njëjtat parametra (kode etj.). Këto transaksione ishin kryesisht blerje jashtë vendit (International purchase) në ato njësi ku operohej me kartë. Këto lloj transaksionesh, sipas procedurave, shfaqen në llogari të klientit pas kalimit automatik 2 ditë nga kryerja e transaksionit. Klienti i ka konfirmuar bankës se i vetmi transaksion që kishte kryer ishte një derdhje në datën 27.5.2013, në sportelet e degës *** në shumën 11,000 lekë. Banka i ka kërkuar këtij shtetasi që të vinte në dispozicion kartën, por ai ka deklaruar se nuk e ka gjetur dhe ka mohuar të ketë qenë jashtë Shqipërisë në datat kur ishin tentuar transaksionet. Pas një analize, banka ka konkluduar se në rastet e transaksioneve është vepruar me kartë, të cilën personi e ka pasur fizikisht dhe në të gjitha rastet kodi

¹¹⁸ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 27.1.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

PIN i kartës ka qenë i saktë. Në të tilla raste, përgjegjësia apo detyrimi financiar bie mbi mbajtësin e kartës.

Në funksion të hetimeve, subjekti ka urdhëruar pyetjen e punonjësve të bankës, të cilët kanë dhënë një tablo të qartë të mënyrës se si funksionon marrëdhënia bankë – klient.

Shtetasi A. M., i pyetur si deklarues, ka deklaruar se pranë Credins Bank është pajisur me kartë debiti *Visa Electron* në vitin 2009, të cilën e ka humbur në vitin 2012. Në mars 2013 Credins Bank e ka pajisur me kartën e re debiti, me të cilën ka realizuar veprime në bankomatet e kësaj banke. Në fund të muajit maj 2013 është njoftuar nga Credins Bank se ishin bërë veprime me kartën e tij. Shtetasi nuk e ka pranuar pasi nuk mund të bëhej një gjë e tillë kur kartën e dispononte vetëm ai. Banka i ka kërkuar të paraqiste kartën, të cilën ai pasi e ka kërkuar në banesë, nuk e ka gjetur.

Gjatë pyetjes, shtetasi A. M. ka deklaruar se kartën dhe PIN-in e saj nuk ia kishte dhënë askujt për ta përdorur se nuk kishte qenë në Angli pas vitit 2007 kur ishte kthyer për herë të fundit në Shqipëri dhe nuk kishte familjarë apo të njohur në atë shtet.

Nga përgjigjet e operatorëve telefonikë ka rezultuar se gjatë periudhës objekt hetimi prill – maj 2013, shtetasi A. M. nëpërmjet një prej numrave të tij celularë të operatorit “****” ka komunikuar disa herë me dy numra anglezë, por pa mundur të identifikohen dhe të lokalizohet vendndodhja e tyre, pasi këto të dhëna sistemi nuk i mundëson.

Në përfundim të hetimit, subjekti, pasi ka vlerësuar se veprimet hetimore ishin të plota, ka konkluduar se Credins Bank dhe shtetasi A. M., në të vërtetë ndodhen para një marrëdhënieje juridiko-civile, pra një marrëdhënie kontraktuale mes palësh. Në vendim, subjekti argumenton se palët kanë lidhur kontrata të rregullta shkresore dypalëshe, të mbështetura në ligje specifike që rregullojnë këtë sektor, rregullore, por edhe në mirëbesim mes tyre, ku kanë përcaktuar saktë dhe qartë të drejtat, detyrimet, kushtet, mënyrën e likuidimit, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rast konflikti të lindur etj. Sipas ligjit dhe praktikës gjyqësore të unifikuar, kur mosmarrëveshje të tilla nuk zgjidhen me dialog mes palëve, këto duhet t’i drejtohen gjykatës që është kompetente për zgjidhjen.

Sa më sipër, në bazë të nenit 328/1, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale, me vendimin datë 6.5.2014, subjekti ka vendosur pushimin e hetimeve të këtij procedimi penal.

Credins Bank ka ankimuar vendimin e subjektit dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 12.11.2014, të lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 3.3.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të subjektit dhe kthimin e çështjes për rihetim me detyra konkrete, pasi nga hetimi nuk ishte verifikuar se cili apo cilët kanë qenë shtetasit që kishin numra telefoni anglez me të cilët komunikonte shtetasi A. M.; çfarë lidhjeje kishte ai me ata; ku ndodheshin në atë kohë personat dhe pasi të identifikoheshin këta, t’u merreshin deklaratimet përkatëse, etj. Gjithashtu, gjykata arsyeton se ekzistenca e një marrëdhënieje juridiko-civile midis palëve nuk e përjashton mundësinë e konsumimit të një vepre penale. Ky shtetas nuk ka deklaruar humbjen e kartës përpara datës së transaksioneve.

Në zbatim të vendimit të gjykatës, subjekti ka urdhëruar në datën 20.4.2015 vijimin e hetimeve duke kryer detyrat e lëna nga gjykata dhe nga raporti referues i OPGJ-së datë 11.6.2015 rezulton se nuk u bë e mundur gjetja dhe pyetja e shtetasit A. M., pasi ai ishte larguar në datën 23.10.2013 jashtë vendit dhe nga sistemi TIMS nuk figuron të ketë hyrë më në territorin e Shqipërisë. Gjithashtu, është këqyruar disketa e tabulateve të kompanisë celulare, por nuk është identifikuar ndonjë numër i shtetit anglez, si dhe ka rezultuar që bisedat e shtetasit A. M. ishin kryer vetëm brenda territorit të Shqipërisë.

Në përfundim të hetimeve brenda afatit ligjor 2-vjeçar, në datën 3.7.2015 subjekti i rivlerësimi me “vendimin për pushimin e çështjes”, në bazë të nenit 328, pika 1/shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale (kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale) ka vendosur të pushojë çështjen penale

nr. ***, viti 2013, me arsyetimin se marrëdhënia midis palëve është marrëdhënie kontraktore civile dhe duhet të zgjidhet nga Gjykata Civile.

Referuar shkresës nr. *** prot., datë 27.1.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se nuk ka pasur ankim ndaj vendimit të pushimit.

Nga verifikimi i dosjes në tërësi dhe pas plotësimit nga ana e subjektit të rivlerësimit të detyrave të lëna me vendim gjyqësor, Komisioni konstatoi se vendimmarrja përfundimtare e subjektit të rivlerësimit ka qenë e njëjtë me atë para ankimit dhe nuk konstatoi problematika në veprimet procedurale të subjektit, në lidhje me kriterin profesional.

Dosja 4 – Procedimi penal nr. *** për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” (neni 248 i Kodit Penal). **Dokumenti ligjor** – Kërkesë datë 19.2.2015 “Për gjykimin e procedimit penal nr. ***/2014”

Ky procedim është regjistruar në datën 7.12.2014, në ngarkim të shtetasit G. T., pasi në datën 6.12.2014 policia është njoftuar se në shkollën e mesme “****” janë vjedhur një ekran LED i markës “****”, dy laptopë dhe një videoprojektor.

I pyetur për ngjarjen, shtetasi G. T. ka deklaruar se në datën e ngjarjes ishte turni i tretë. Rreth orës 01:30 ishte shkëputur dhe larguar nga vendi i punës për rreth 40 minuta. Kur u kthye nuk kishte konstatuar gjë, pasi ka kontrolluar vetëm katin e parë të shkollës.

Nisur nga vjedhjet e përsëritura¹¹⁹, subjekti ka pyetur shtetasin G. T. si person nën hetim, i cili nuk ka dhënë shpjegime e, më pas, subjekti ka proceduar me arrestimin në flagrancë të tij.

Bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti, pasi ka marrë vendimin datë 11.2.2015 “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës” ndaj shtetasit G. T. për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” (neni 248 i Kodit Penal), i ka vënë në dispozicion të pandehurit aktet në ngarkim të tij me procesverbalin “Për njohjen e të pandehurit me aktet” dhe bazuar në nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale ka përpiluar kërkesën për gjykimin e çështjes ndaj të pandehurit.

Me vendimin nr. ***, datë 8.12.2014, gjykata ka vlerësuar të ligjshëm arrestimin dhe ka pranuar kërkesën e subjektit në lidhje me masën e sigurimit personal “Detyrim paraqitjeje në policinë gjyqësore”.

Brenda afatit ligjor, subjekti, me vendimin datë 19.2.2015 “Për dërgimin e çështjes në gjykim”, ka dërguar çështjen për gjykim dhe nga akti “Konkluzione përfundimtare” rezulton se kjo çështje është gjykuar nga gjykata.

Për sa më lart, Komisioni nuk konstatoi mangësi në veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit.

Dosja 5 – Procedimi penal nr. *** për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike” (neni 137/1 i Kodit Penal). **Dokumenti ligjor** – Kërkesë datë 20.1.2016 “Për gjykimin e procedimit penal nr. ***/2015”

Ky procedim është regjistruar në datën 8.9.2015, ndërsa emri i personit, të cilit i atribuohet vepra penale është regjistruar në datën 13.1.2016.

Në datën 28.7.2015, grupi i task-forcës, i përbërë nga OSHEE-ja dhe Policia e Shtetit ka konstatuar se në matësin që përdorte abonenti B. H. ishte rilidhur energjia në mënyrë të paligjshme, megjithëse më parë i ishte ndërprerë energjia elektrike dy herë pasi ishte debitor për shumën 520,732 lekë.

¹¹⁹ Gjatë hetimit ka rezultuar se edhe më parë në atë shkollë ishte vjedhur një aparat kompjuterik dhe sërish kur në shërbim roje ka qenë shtetasi G. T..

Subjekti, bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur “për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës” për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike” dhe i ka vënë në dispozicion aktet në ngarkim të tij, dokumentuar me procesverbalin “Për njohjen e të pandehurit me aktet”.

Hetimet janë zhvilluar brenda afateve procedurale dhe kërkesa e subjektit për gjykimin e këtij procedimi penal është pranuar për gjykim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për sa më lart, Komisioni, nga ana e tij, pasi shqyrtoi këtë dosje nuk konstatoi mangësi.

21. Të dhëna nga burime arkivore të KLP-së lidhur me masa disiplinore, ankesa dhe vlerësime

21.1 Nga verifikimi i të dhënave prej burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se me Dekretin nr. ***, datë 1.2.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, subjekti Dritan Nushi në datën 1.2.2002 është emëruar në detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Tiranë; me Dekretin nr. ***, datë 30.4.2007, subjekti është transferuar si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe me Dekretin nr. ***, datë 26.11.2013, është transferuar si prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Tiranë, ku ka ushtruar detyrën deri aktualisht.

21.2 Gjithashtu, rezulton se subjekti Dritan Nushi nuk ka pasur masa disiplinore.

21.3 Për periudhën viti 2006 – 2022, rezulton¹²⁰ se janë regjistruar 4 ankesa drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm për prokurorin Dritan Nushi sa më poshtë:

a. Praktika nr. *, datë 3.11.2010, regjistruar mbi ankesën e shtetases Q. H.**

Kjo shtetase pretendon se djali i saj K. H. është akuzuar padrejtësisht nga subjekti për një veprë penale të rëndë, për pasojë familjarisht kanë pësuar dëm moral e ekonomik dhe sa i përket veprimeve të subjektit, kjo shtetase ka parashtuar disa rrethana. Ajo pretendon se qëllimisht subjekti ka marrë në përgjegjësi penale djalin e saj për të shmangur nga akuza persona të tjerë.

Ankesa është marrë në shqyrtim dhe nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 26.11.2010, Prokuroria e Përgjithshme ka orientuar shtetasen se për sa kohë që çështja ishte në gjykim, çdo pretendim në lidhje me akuzën mund ta bënin prezent para gjykatës gjatë shqyrtimit gjyqësor të procedimit penal.

b. Praktika nr. *, datë 19.12.2012, regjistruar mbi ankesën e shtetasit K. H.**

Ky shtetas pretendon se është akuzuar padrejtësisht nga subjekti i rivlerësimit, i cili sipas ankuesit ka manipuluar provat dhe e ka akuzuar padrejtësisht me qëllim shmangien nga përgjegjësia penale e autorit të vërtetë të ngjarjes.

Kjo ankesë është marrë në shqyrtim nga Sektori i Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme, i cili me shkresën nr. *** prot., datë 9.1.2013, i ka bërë me dije shtetasit se për sa kohë ishte i dënuar me një vendim gjykate të formës të prerë, mund t'i drejtohej Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit penal.

Për të dyja praktikat më lart që kanë lidhje me njëra-tjetrën, Komisioni nuk konstatoi mangësi.

c. Praktika nr. *, datë 9.7.2014, regjistruar mbi ankesën e shtetasit K. S.**

Ky shtetas ankohet se ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Tiranë ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit të Komisarariatit nr. *** Tiranë, për veprën penale “Kryerje e veprimeve arbitrare” (neni 250 i Kodit Penal). Subjekti e ka hetuar këtë kallëzim dhe pasi nuk kishte kryer hetime të plota mbi rrethanat e kallëzuarit ka disponuar me vendim pushimi. Ankuesi citon disa veprime hetimore, për të cilat pretendon se nëse do të ishin kryer nga subjekti, hetimi do të kishte marrë rrjedhë tjetër.

¹²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 16.12.2022, e Drejtorisë së Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore e Shërbimeve Mbështetëse pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Ankesa është shqyrtuar nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme. Sipas kësaj drejtorie, rezulton se në bazë të nenit 328, pika 1/b e Kodit të Procedurës Penale (kur del qartë se fakti penal nuk ekziston), subjekti pasi ka hetuar procedimin penal nr. ***, viti 2013, në datën 30.5.2014, ka vendosur pushimin e këtij procedimi. Në përfundim, pretendimet e ankuesit për hetime të paplota janë gjetur të qenësishme, prandaj bazuar në nenin 24/5 të Kodit të Procedurës Penale, vendimi i pushimit që ka disponuar subjekti është shfuqizuar me vendimin datë __.1.2015 të Prokurorisë së Përgjithshme, e cila ka konkluduar se vendimi i pushimit vjen në kundërshtim të plotë me provat e administruara në dosje dhe kërkesat e nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale. Në vendim janë përcaktuar të gjitha detyrat që duhet të realizoheshin nga subjekti i rivlerësimit.

Referuar të dhënave në vendimin datë __.1.2015 të Prokurorisë së Përgjithshme dhe në vendimin e pushimit datë 30.5.2014 që ka disponuar subjekti i rivlerësimit, rezulton se në datën 23.5.2013, në pikën e karburantit “Kupola” që administrohej nga shtetasi K. S., rreth orës 8:00 kanë shkuar patrulla e policisë dhe pa paraqitur asnjë dokument zyrtar, në mënyrë arbitrare ka bllokuar punën në pikën e karburantit, si dhe ka shoqëruar në rajonin e policisë të gjithë punonjësit dhe administratorin e pikës së karburantit. Gjithashtu, kjo pikë karburanti është mbajtur një javë e bllokuar nën mbikëqyrjen e policisë, e rrethuar me fashat e saj, dhe gjatë kësaj kohe nga persona të paautorizuar janë dëmtuar kasat e faturimit (fiskale); nuk janë lejuar të punojnë punonjësit e karburantit duke i shkaktuar kështu një dëm të konsiderueshëm këtij biznesi.

Sipas kallëzuesit, shkak për këtë ngjarje është bërë një konflikt që shtetasi K. S. ka me shtetasin V. A., me të cilin është në proces gjyqësor civil dhe shtetasi V. A. ka shfrytëzuar njohjet e tij për të zgjidhur konfliktin civil, duke angazhuar forcat e policisë së Rajonit nr. ***, Tiranë, të cilat kanë vendosur ruajtjen e pikës së karburantit në kundërshtim me ligjin “Për policinë e shtetit”.

Në vendimin që ka marrë subjekti, konkluzioni i tij, nëse në rastin konkret ka apo jo veprë penale dhe nëse ekziston ose jo fakti penal, ka të bëjë me themelin e çështjes dhe, për këtë, Komisioni nuk ka kompetencë vlerësimi sipas nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

Nga ana tjetër, në vlerësimin tërësor të qëndrimit të subjektit lidhur me këtë çështje, si dhe duke mbajtur në konsideratë vendimin e Prokurorisë së Përgjithshme që ka shfuqizuar vendimin e subjektit të rivlerësimit, Komisioni vëren se për disa rrethana si: marrja e punonjësve të karburantit me furgonat e policisë dhe jo me mjetet e tyre private (meqë pretendon se mund të ketë qenë thirrje dhe jo shoqërim i tyre); mbajtja e tyre në komisariat për disa orë me radhë, 8:00 – 15:00; rrethimi i pikës së karburantit për disa ditë me shiritat e policisë dhe moslejimi i ushtrimit të aktivitetit të tij; përdorimi disa herë nga subjekti i shprehjeve “mund të ketë ndodhur”, “mund të jetë bërë”, “mund të ketë qenë”; “mund të ketë ardhur” dhe mosdhënia e një konkluzioni të saktë e bindës – lënë të kuptohet se nuk janë kryer hetime të plota në identifikimin e faktit nëse ka ose jo veprime arbitrare në veprimet e policisë.

Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegimet e nevojshme në lidhje me këtë situatë dhe veprimet e tij procedurale mbi bazën e të cilave ka marrë vendimin e tij për pushimin e procedimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

21.4 Në prapësimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka cituar të plotë vendimin e tij datë 30.5.2014 “Për pushimin e hetimit” në lidhje me procedimin penal nr. ***, viti 2013, duke i qëndruar argumentit që ka dhënë edhe në këtë vendim se nuk provohej që personat e përmendur në kallëzim të kishin konsumuar elementet e veprës penale të pretenduar apo të ndonjë veprë tjetër penale.

21.5 Gjithashtu, subjekti shpjegon se hetimet janë kryer të plota nga struktura të specializuara, të cilat kanë sugjeruar edhe përfundimin e hetimeve.

21.6 Në lidhje me vendimin e Prokurorisë së Përgjithshme që ka urdhëruar shfuqizimin e vendimit datë 30.5.2014 “Për Pushimin e hetimeve”, subjekti i rivlerësimit pretendon se kur është njohur me rezultatet e hetimit është vënë në dijeni se kallëzuesi K. S. ka ankimuar vendimin e subjektit jashtë afatit ligjor në datën 15.1.2015, jo në gjykatë, por te Prokurori i Përgjithshëm, i cili ka shfuqizuar vendimin e subjektit dhe ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve me tjetër prokuror. Pasi është interesuar në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, nuk ka mundur të gjejë fashikullin hetimor dhe as vendimin e Prokurorit të Përgjithshëm për të dhënë një vlerësim për këtë vendim.

Vlerësimi i Komisionit

21.7 Komisioni qartëson se Prokuroria e Përgjithshme¹²¹ ka përcjellë praktikën dhe aktet bashkëlidhur, ku rezulton se kallëzuesit K. S., në datën 16.6.2014, i është dërguar për njohje nga Prokuroria e Rrethit Tiranë kopja e vendimit datë 30.5.2014 “Për pushimin e hetimeve” dhe ankimi i kallëzuesit është depozituar në Prokurorinë e Përgjithshme në datën 9.7.2014.

21.8 Komisioni, duke iu referuar shpjegimeve të subjektit dhe përmbajtjes së vendimit të tij për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2013, nga ku rezulton se subjekti ka kryer hetimet e nevojshme dhe të gjithanshme dhe ka pasqyruar në vendim çdo veprim procedural dhe provë që ka administruar, vendimi është i kuptueshëm dhe me strukturë të qëndrueshme, por duke iu referuar edhe parashikimeve të pikave 3 dhe 4 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit: “3) *Aspekti i arsytimit ligjor të prokurorëve në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit.* 4) *Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet, atëherë Komisioni duke e riparë natyrën e veprimeve të subjektit, të cilat duket se kanë të bëjnë me themelin e çështjes, vlerëson se nuk ka kompetencë të vlerësojë korrektësinë dhe themelin e çështjes dhe as të zëvendësojë interpretimin dhe logjikën e prokurorit”.*

Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi mangësi në veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit.

d. Praktika nr. *** datë 29.9.2014, regjistruar mbi ankesën e shtetasit S. P.

Ky shtetas në ankesën e tij pretendon se pas kallëzimit të kryer nga përmbartuesi gjyqësor ndaj bashkëshortes së tij G. G. (P.), Prokuroria e Rrethit Tiranë ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, viti 2014, për veprën penale “Mosekzekutim i vendimit gjyqësor” dhe subjekti në mënyrë të kundërligjshme ka disponuar me vendim mosfillimi të procedimit penal. Ankuesi citon disa veprime hetimore, të cilat, nëse subjekti do t’i kishte kryer, nuk do të vendoste mosfillimin e procedimit, por do të regjistronte procedimin penal.

Komisioni nga ana e tij, gjatë shqyrtimit të akteve të kësaj praktike, konstatoi¹²² se subjekti ka hetuar kallëzimin penal nr. ***, datë 2.5.2014, të shoqërisë përmbartimore “****” sh.p.k. ndaj shtetasit G. G. (P.). Në datën 31.7.2014, në bazë të nenit 290/1, shkronja “e” dhe nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për këtë kallëzim. Kopja e vendimit të subjektit i është njoftuar palëve, të cilat nuk kanë bërë ankim ndaj këtij vendimi.

Ankesa e shtetasit S. P. është marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 3.7.2015, i ka bërë me dije këtij shtetasi se pas shqyrtimit të materialeve të kallëzimit penal në fjalë dhe të ankimit ndaj

¹²¹ Pjesë e akteve bashkëlidhur raportit të vlerësimit profesional nr. ***, datë 16.1.2023, të dërguar nga KLP-ja pranë Komisionit me shkresën nr. *** prot., datë 24.1.2023.

¹²² Shkresë nr. *** prot., datë 20.4.2015, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe shkresë nr. *** prot., datë 4.5.2015, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

vendimit për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me këtë kallëzim, është konkluduar se nuk ekzistojnë shkaqe ligjore për shfuqizimin e këtij vendimi.

Për sa më lart, Komisioni nuk konstatoi ndonjë mangësi.

22. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse në Këshillin e Lartë të Prokurorisë u administruan të dhëna për vlerësimin e punës së subjektit, sipas vendimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, si më poshtë:

- Vendimi “Për vlerësimin e punës së prokurorit”, viti 2012, në nivel “mirë”;
- Vendimi “Për vlerësimin e punës së prokurorit”, për vitet 2013 – 2015, në nivel “shumë mirë”;
- Vendimi “Për vlerësimin e punës së prokurorit”, viti 2016, në nivel “mjaftueshëm”.

22.1 Në lidhje me vlerësimin “mjaftueshëm”, subjekti i rivlerësimit në pyetësin nr. 6 ka depozituar pranë Komisionit vendimin nr. ***, datë 28.10.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila ka shfuqizuar aktin e Prokurorit të Përgjithshëm për vlerësimin e punës “mjaftueshëm” të prokurorit Dritan Nushi në vitin 2016. Nga rrethanat e përshkuara në këtë vendim rezulton se për subjektin e rivlerësimit, në vitin 2016, ishte dhënë vlerësimi i punës “shumë mirë” nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

22.2 Nga ana tjetër, KLP-ja ka dërguar¹²³ pranë Komisionit vendimin nr. ***, datë 5.10.2023, ku ka ndryshuar raportin e vlerësimit të subjektit të rivlerësimit që e kishte miratuar me vendimin nr. ***, datë 16.1.2023, dhe ka hequr nga ky raport vlerësimin “mjaftueshëm”, që subjekti i rivlerësimit kishte marrë nga Prokurori i Përgjithshëm në vitin 2016.

DENONCIME

23. Denoncimet nr. * prot., datë 6.1.2020, nr. *** prot., datë 10.10.2019 dhe nr. *** prot., datë 13.1.2020, të shtetasit V. Ç.**¹²⁴ Në këto denoncime, ky shtetas denoncon disa subjekte rivlerësimi midis të cilëve edhe subjektin Dritan Nushi, për korrupsion të organizuar nëpërmjet shpërdorimit të detyrës në dëm të tij; për lidhje me botën e krimit; si dhe për paafësi profesionale. Komisioni konstatoi se në materialet bashkëlidhur denoncimeve nuk përmendet asnjëherë emri i subjektit Dritan Nushi apo ndonjë akt i nënshkruar prej tij, si dhe nuk ndodhet asnjë dokument që provon pretendimin e denoncuesit për korrupsion.

Për sa më lart, Komisioni vlerësoi të mos i marrë në shqyrtim këta denoncime.

24. Denoncimet nr. * prot., datë 15.11.2018 dhe nr. *** prot., datë 9.9.2019, të shtetasit L. Sh. (M. L.).** Ky shtetas pretendon se në datën 16.2.2009 ka bërë kallëzim penal për vjedhje toke në ***, por prokurori Dritan Nushi e ka kthyer nga “kallëzues” në “të pandehur”, duke mos njohur asnjë të drejtë të kallëzuesit dhe duke mos marrë parasysh asnjë dokument të depozituar nga ky shtetas. Subjekti ka vënë sekuestro me vendimin nr. ***, datë 3.6.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, pa e njoftuar këtë shtetas, por Gjykata e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 6.7.2009, e ka shfuqizuar këtë sekuestro.

24.1 Komisioni, pasi administroi¹²⁵ dhe shqyrtoi dosjet e dërguara nga Prokuroria e Rrethit Kavajë dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, vëren se:

24.1.1 Pranë Prokurorisë së Rrethit Kavajë, në datën 22.4.2009 është regjistruar dhe hetuar nga subjekti i rivlerësimit procedimi penal nr. ***/2009 për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm” mbi

¹²³ Me shkresën nr. *** prot., datë 5.10.2023, të KLP-së, drejtuar Komisionit.

¹²⁴ Dy denoncimet e para janë depozituar pranë Kolegjit, i cili i ka përcjellë pranë Komisionit. Denoncimi nr. ***, datë 10.10.2019, përcjellë pranë Komisionit me shkresën nr. *** prot., datë 10.10.2019, të Kolegjit.

¹²⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe nr. *** prot., datë 1.12.2022, të Prokurorisë së Rrethit Kavajë.

bazën e kallëzimit të shtetasit F. P., administrator i shoqërisë “****”, i cili pretendon se është pronar i pasurisë nr. ***, sip. 59,800 m², zëri kadastral “Pyll”, i ndodhur në z. k. *** të fshatit ***, sipas kontratës së shitjes¹²⁶ dhe certifikatës së pronësisë nr. *** datë 5.2.2008.

24.1.2 Pasi ka blerë pronën, shtetasi F. P. ka mësuar se me vendimin nr. ***, datë 27.11.2003, të Këshillit të Zhvillimit të Turizmit (KZHT), shoqërisë “****” sh.p.k. i është dhënë statusi “Person i stimuluar në zonën e turizmit” për të investuar në ndërtimin e një kompleksi turistik mbi këtë pronë, për ta shfrytëzuar për qëllime turistike dhe për ta kthyer pronën të zhvilluar pasi të përfundonte afati i qirasë. Neni 4, pika 4.5 e kontratës së qirasë përcaktonte se qiramarrësi për asnjë arsye nuk mund ta përdorë pronën me qira, ndryshe nga qëllimi për të cilin është lidhur kjo kontratë. Në bazë të kontratës së zhvillimit dhe kontratës së qirasë, të lidhura midis kësaj shoqërie dhe MRRTT-së, në datën 24.12.2003 shoqëria “****” sh.p.k. ka marrë lejen e ndërtimit dhe ka filluar ndërtimin. Sipas lejes së rinovuar të ndërtimit datë 25.1.2006, afati i ndërtimit është shtyrë deri në datën 31.1.2008.

24.1.3 Me vendimin nr. ***, datë 25.1.2006, të KZHT-së është revokuar vendimi nr. ***, datë 27.11.2003, i KZHT-së. Meqenëse kaloi edhe afati 31.1.2008 i lejes së ndërtimit, kjo shoqëri ka kërkuar nga Enti Kombëtar i Turizmit (EKT) zgjatjen e afatit, por kërkesa i është refuzuar. Edhe me vendim gjyqësor¹²⁷ kjo shoqëri e humbi të drejtën e zgjatjes së afatit të lejes së ndërtimit.

24.1.4 Shoqëria “****” sh.p.k. e humbi statusin e saj, prandaj me shkresën nr. *** prot., datë 20.11.2006, të EKT-së u njoftua për zgjidhjen në mënyrë të njëanshme të aktmarrëveshjeve. Pavarësisht nga zgjidhja e aktmarrëveshjes, disa vila të ndërtuara deri në fazën fillestare, kjo shoqëri nuk ia ktheu MRRTT-së, sipas aktmarrëveshjes së zhvillimit, por ia transferoi shtetasit L. Sh. me anë të disa kontratave¹²⁸.

24.1.5 Shtetasi L. Sh., jo vetëm që vazhdoi ndërtimin e këtyre vilave, por ndërtoi aty edhe 3 vila të tjera, pavarësisht dy procesverbaleve të datave 21.4.2009 dhe 2.5.2009, të mbajtura nga policia gjyqësore për konstatimin e ndërtimit pa leje të disa godinave në stade të ndryshme ndërtimi; procesverbalit datë 29.4.2009 të INUK-ut të komunës ***, që ka konstatuar se afati i lejes së ndërtimit ka përfunduar në datën 31.1.2008; vendimit nr. ***, datë 30.4.2009, të Inspektoratit të Ndërtimit të Komunës *** për pezullim të përkohshëm të punimeve për shkak se ka kaluar afati i lejes së ndërtimit.

24.1.6 Nga dosja hetimore rezulton se shtetasi L. Sh. dhe vëllezërit e tij janë pyetur me procesverbalin datë 11.5.2009, në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e çështjes dhe ka deklaruar se po kryen punime dhe do të vazhdojë të kryejë punime sepse është në shtëpitë e tij që i ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. për 10,000 euro.

24.1.7 Në datën 1.6.2009, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me procedimin penal nr. ***/2009 që po hetonte, i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë vendosjen e sekuestros preventive mbi pesë godinat-vila të pargjistruara në ZVRPP-në Kavajë dhe mbi sipërfaqen e tokës ku ato janë ndërtuar në ***, z. k. ***, zëri kadastral “Pyll”, nr. pasurie ***, sip. 59,800 m².

¹²⁶ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.12.207, e lidhur midis blerësit, shoqëria “****”, dhe shitësit trashëgimtarë të ish-pronarëve N. e J. Sh..

¹²⁷ Vendim nr. ***, datë 26.9.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 23.9.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

¹²⁸ Me kontratën datë 18.8.2005, shoqëria “****” sh.p.k., me cilësinë e sipërmarrësit merr përsipër ndërtimin e vilës dy kat, nr. 1 dhe nr. 5, në favor të porositësit L. Sh. me shpenzimet e porositësit, i cili do të furnizojë sipërmarrësin me beton për ndërtimin e vilave nr. 2 e nr. 3; me kontratën¹²⁸ datë 6.3.2006 palët bien dakord që vilat nr. 3 dhe nr. 5 të ndërtohen për llogari të porositësit L. Sh., ndërsa vila nr. 4, e cila ka përfunduar do i jepet këtij për shfrytëzim; me kontratën¹²⁸ datë 26.9.2006, shoqëria “****” sh.p.k. i jep vilat nr. 1 dhe nr. 2 në fazën e xoklaturave, duke cituar se: “...ia jep për t’i ndërtuar dhe shfrytëzuar lirisht sipas projektit dhe lejes së ndërtimit datë 17.4.2004 (me afat deri datë 31.1.2008) dhe marrëveshjes së zhvillimit datë 24.12.2003 e lidhur me MRRTT-në. L. Sh. do t’i ndërtojë vilat me shpenzimet e veta. Çmimi i shitjes së objektit është 20,000 euro”.

24.1.8 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. ***, datë 3.6.2009, ka pranuar kërkesën e subjektit dhe ka vendosur sekuestro konservative mbi këto prona objekt hetimi.

24.1.9 Mbi ankimin e shtetasit L. Sh., kjo çështje është gjykuar nga Gjykata e Apelit Durrës, e cila me vendimin nr. ***, datë 6.7.2009, ka vendosur: (i) lënien në fuqi të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 3.6.2009, për miratimin e sekuestros preventive mbi sipërfaqen e tokës në ***, z. k. ***, zëri kadastral “Pyll”, me nr. pasurie ***, sip. 59,800 m²; (ii) shfuqizimin e këtij vendimi për pjesën e 5 vilave, duke hequr sekuestron preventive mbi ato me arsyetimin se janë përfunduar brenda afatit të lejes së ndërtimit.

24.1.10 Referuar dosjes së procedimit penal nr. ***/2009, rezultoi se ky procedim është regjistruar në bazë të kallëzimit që ka bërë në datën 15.2.2009 shtetasi L. Sh. për veprën penale “Kanosje”. Ky procedim nuk është hetuar nga subjekti i rivlerësimit Dritan Nushi.

24.1.11 Pra, rezulton se denoncuesi nuk ka bërë kallëzim për “Vjedhje toke”, sikurse pretendon në denoncimin drejtuar Komisionit, por ka bërë kallëzimin për “Kanosje”, që nuk është hetuar nga subjekti i rivlerësimit Dritan Nushi.

24.1.12 Subjekti i rivlerësimit Dritan Nushi ka hetuar procedimin penal të filluar mbi kallëzimin e shtetasit F. P. për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm” dhe, në këtë procedim, kërkesa e subjektit drejtuar gjykatës “Për vendosje të sekuestros konservative” është bërë nga subjekti i rivlerësimit në përputhje me nenin 274 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, subjekti nuk ka pasur detyrim të njoftojë shtetasin L. Sh. për kërkesën drejtuar gjykatës për vendosje të sekuestros, pasi është gjykata ajo që kryen njoftimin e palëve në proces dhe vlerëson kërkesën.

Për sa më lart, Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit.

25. Denoncim nr. *, datë 14.12.2017, i shtetasit Xh. Ç.** Në denoncim pretendohet se gjyqtarët e shkallës së parë, Gjykatës së Apelit dhe prokurori i çështjes kanë mbrojtur vrasësin e vëllait të tij; nuk kanë zbatuar ligjin e, për rrjedhojë, sot vrasësi është i lirë dhe nuk është dënuar për vrasjen në bashkëpunim, si dhe janë fshehur të gjitha provat që kanë ardhur nga Prokuroria e ***. Bashkëlidhur denoncuesi ka depozituar vendimin nr. ***, datë 9.2.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe vendimin nr. ***, datë 11.10.2011, të Gjykatës së Apelit Durrës.

25.1 Komisioni, pasi administroi¹²⁹ dhe shqyrtoi dosjen e këtij procedimi penal, si dhe vendimin nr. ***, datë 9.2.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, vëren se kjo gjykatë ka gjykuar të pandehurin F. Ç. për veprat penale “Vrasja me dashje” dhe “Prodhimi e mbajtja pa leje e armëve të ftohta” për vrasjen e shtetasit Xh. Ç. në datën 24.11.1996, në Itali.

25.2 Në datën 14.7.2006 është regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë procedimi penal nr. *** për veprën penale “Vrasja me dashje” (neni 76 i Kodit Penal) mbi bazën e kallëzimit të shtetasit Xh. Ç., që pretendon se i dyshuar kryesor është shtetasi F. Ç.. Hetimet janë zhvilluar nga dy prokurorë njëri pas tjetrit dhe, në fund, hetimet janë kryer nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka marrë vendimin datë 14.7.2008 për dërgimin e çështjes për gjykim.

25.3 Subjekti ka urdhëruar në datën 2.6.2008 “Për regjistrimin e emrit F. Ç. si personi që i atribuohet vepra penale” dhe me urdhrin datë 11.6.2008 subjekti urdhëron ndalimin e të dyshuarit për krim, shtetasin F. Ç..

25.4 Gjatë hetimit, Prokuroria ka administruar: (1) letërporosinë e dërguar nga autoritetet italiane, që konfirmon se procedimi penal i filluar në Itali, në ngarkim të shtetasve F. Ç. dhe F. L., për vrasjen e shtetasit Xh. Ç., është arkivuar në Gjykatën e ***; (2) disa nga aktet e hetimeve paraprake

¹²⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.12.2022, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

bashkëlidhur letërporosisë. Sipas provave të dërguara me letërporosi, konkretisht raporti mjekësor datë 23.11.1996 (ora 23:45), i mjekut të spitalit ***, rezulton si diagnozë e viktimës “*Plagë penetruese me majë të mprehtë dhe prerje në gjysmëtoraksin e majtë dhe shok hemorragjik i mundshëm, vdekja në orën 00:10 min të datës 24.11.1996*”.

25.5 Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se “*Janë fshehur provat që kanë ardhur nga Prokuroria e ****”, rezulton se në shkresën datë 12.2.2007 Gjykata e *** autorizon Prokurorinë e *** që t’i kalojë Prokurorisë së Rrethit Kavajë aktet e procedimit penal (rezultatet e hetimeve, përfundimi i mundshëm i procesit) mbi vrasjen e shtetasit Xh. Ç.. Gjithashtu, me shkresën datë 25.11.2007 të Gjykatës së ***, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm të Italisë, me objekt “*Kërkesë e letërporosisë së Prokurorisë Kavajë*”, citohet: “*Aktet në ngarkim të shtetasve F. Ç. e F. L. janë arkivuar dhe aktet e hetimeve bashkëngjitur janë të vetmet që janë gjetur*”.

25.6 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka disponuar ato dokumente që ka dërguar shteti italian.

25.7 Në shkresën datë 21.8.2007 të Gjykatës së *** “Referim i vrasjes së Xh. Ç.”, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Kavajë, citohet se nga procesverbalet e të afërmeve dhe miqve të viktimës u mblodhën të dhëna fajësie ndaj shtetasit F. Ç., i cili ka vepruar në bashkëpunim me dy shtetas të tjerë, D. L. e B. A..

25.8 Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se vrasja ka qenë në bashkëpunim, rezulton se janë pyetur disa persona¹³⁰, që kanë deklaruar se një person tjetër, A. D., u ka treguar që viktimë i ka thënë atij gjatë transportimit për në spital se në vrasje shtetasi F. Ç. është ndihmuar nga shtetasit D. L. dhe B. A..

25.9 Nga ana tjetër, sipas procesverbalit datë 20.12.2006, në Prokurorinë e Rrethit Kavajë shtetasi A. D. ka deklaruar se viktimë gjatë transportit i ka thënë që është vrarë nga F. Ç. me thikë, pa cilësuar bashkëpunëtorë të tjerë të vrasjes.

25.10 Nga analiza e dëshmimeve dhe procesverbaleve përkatëse, nuk është provuar bashkëpunimi me prova të drejtpërdrejta dhe bindëse.

25.11 Në lidhje me kërkimin e autorit të vrasjes, gjykata italiane kishte vendosur masën e sigurimit “Arrest në burg”, e cila nuk është ekzekutuar asnjëherë, për shkak se autori nuk gjendet. Në kërkesën datë 6.5.1997 të Kuesturës së *** për masën e sigurimit personal ndaj shtetasit F. Ç., citohet se menjëherë pas vrasjes kanë nisur kërkimet për këtë shtetas, por nuk është bërë i mundur ndalimi i tij. Kërkohet masa e sigurimit “Arrest në burg”.

25.12 Për kërkimin e shtetasit F. Ç., edhe gjatë hetimit në Shqipëri, nga subjekti i rivlerësimit është nxjerrë urdhër ndalimi për të (urdhri datë 11.6.2008), pasi nga hetimet ka dyshime të arsyeshme se ka kryer vrasjen e shtetasit Xh. Ç., por sipas procesverbaleve të kërkimit, datë 10.7.2008 dhe 30.7.2008, rezultoi¹³¹ se ai nuk ndodhej në banesë, sepse është larguar jashtë shtetit, fakt që u provua edhe nga deklaratimet e familjarëve të të pandehurit.

25.13 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. ***, datë 9.7.2008 (të formës së prerë), ka pranuar kërkesën e subjektit për caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” ndaj

¹³⁰ (1) Në aktet e dërguara më letërporosi, shtetasja V. Rr. (kushërirë e viktimës) gjatë pyetjes në Kuesturë, në datën 10.12.1996, ka deklaruar se nga shtetasi A. D. ka mësuar se viktimë i ka thënë atij gjatë transportimit për në spital se në vrasje F. Ç. është ndihmuar nga shtetasit D. L. dhe B. A.; (2) Shtetasja Q. Ç. (motra e viktimës) ka deklaruar në datën 16.12.1996, gjatë pyetjeve në Kuesturë, se shtetasi A. D. ka treguar në Shqipëri se viktimë i ka thënë atij gjatë transportimit për në spital se F. Ç. për vrasjen që kreu është ndihmuar nga shtetasit D. L. dhe B. A..

¹³¹ (1) Sipas informacionit datë 8.7.2008, specialisti i policisë së zonës, ku është i regjistruar me gjendje civile shtetasi F. Ç., informon se sipas të dhënave nga burime të ndryshme konfidenciale, ky shtetas ka jetuar në Itali dhe, nga viti 1994, pas vrasjes që ka kryer, është larguar në SHBA; (2) Sipas procesverbalit datë 30.6.2008, nënshkruar nga OPGJ-ja dhe specialisti i policisë së zonës, rezulton se shtetasi F. Ç. nuk gjendet në banesë, por ai dhe familja e tij janë larguar prej vitesh jashtë shtetit.

shtetasit F. Ç.. Në datën 11.7.2008, subjekti ka urdhëruar ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor, duke urdhëruar Policinë Kavajë të arrestojë shtetasin F. Ç. kudo që të ndodhet.

25.14 Në këtë gjykim, subjekti ka kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit për veprat penale “Vrasja me dashje” dhe “Prodhimi e mbajtja pa leje e armëve të ftohta” dhe dënimin për secilën veprë, respektivisht me 15 vjet burgim dhe 6 muaj burgim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin nr. ***, datë 9.2.2010, ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale “Vrasja me dashje” dhe dënimin me 15 vjet burgim; deklarimin e pafajshëm për veprën penale “Prodhimi e mbajtja pa leje e armëve të ftohta”, sepse nuk është gjetur dhe sekuestruar me cilësinë e provës mjete i krimit për t’u vlerësuar si armë e ftohtë ose nuk është përcaktuar saktësisht mjete me të cilin autori ka kryer vrasjen.

25.15 Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 11.10.2011, ka vendosur prishjen e vendimit gjyqësor nr. ***, datë 9.10.2010 dhe pushimin e çështjes. Gjykata arsyeton se nuk provohet që të jenë veprimet e drejtpërdrejta të të pandehurit shkaku që ka sjellë vdekjen e viktimës, nisur nga rrethanat ku viktimja është goditur rreth orës 23:00 të datës 23.11.1996, ka pedaluar biçikletën dhe është nisur vetë për në spital, duke bërë një copë rrugë derisa ka mbërritur ambulanca dhe, më pas, ka ndërruar jetë rreth orës 00:10 të datës 23.11.1996 në spital, si dhe nga fakti që nuk ka një akt mjekoligjor që të provojë shkakun determinant të vdekjes, pasi nuk është bërë një akt i tillë dhe kanë kaluar 15 vjet nga dita e ngjarjes. Pra, vendimi i Gjykatës së Apelit ka vlerësuar themelin e çështjes dhe, konkretisht, cilësimin juridik të veprës penale dhe nuk citon shkelje procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 4.4.2013, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga prokurori i Apelit Durrës.

25.16 Për sa më lart, në lidhje me pretendimet në denoncim, rezulton se nuk janë veprimet e subjektit që kanë bërë të mundur lirimin dhe mosdënimin e të pandehurit, por fakti që i pandehuri nuk është bërë i mundur të ndalohet as nga autoritetet italiane dhe as nga ato shqiptare pas kërimit (sipas procesverbaleve të kërimit datë 10.7.2008 dhe 30.7.2008).

25.17 Nisur nga fakti që subjekti në gjykim ka kërkuar deklarimin fajtor dhe dënimin e të pandehurit, duket qartë se ai nuk ka kryer veprime për të mbrojtur të pandehurin, sikurse pretendon denoncuesi.

Për sa më lart, Komisioni nuk konstatoi mangësi në veprimet e subjektit të rivlerësimit.

26. Denoncim nr. *, datë 15.3.2018, i shtetases F. M. (B.).** Në denoncim, denoncuesja pretendon se është përfshirë në disa procese gjyqësore të zvarritura e të pushuara ndër vite. Një pronë asaj i është vjedhur nga nipërit, në bashkëpunim me noteren Sh. K.. Në vitin 1986, me dëshmi trashëgimie, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e njeh si trashëgimtare të babait të saj, duke përfutur ¼ pjesë të pasurisë trashëgimore. Në vitin 2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e njeh si trashëgimtare të nënës së saj, duke përfutur 1/3 pjesë të pasurisë së saj, ndërkohë që në aktin e dhurimit, datë 20.9.1990, ku ajo nuk figuron në pjesën e nënës së saj, firmat nuk janë konfirmuar me pasaporta apo dokumente identifikimi.

26.1 Komisioni, pasi administroi¹³² dhe shqyrtoi dosjen e procedimit penal nr. ***, si dhe aktet bashkëlidhur denoncimit, vëren se prokurori Z. H. ka regjistruar në datën 18.7.2013 procedimin për veprën penale “Ekspertimi i rremë” pa autor, mbi bazën e kallëzimit penal datë 7.6.2013 të shtetasit I. M. (bashkëshorti i denoncueses), referuar nga Drejtoria e Policisë Tiranë. Procedimi penal është hetuar deri në datën 6.12.2013 nga ky prokuror, i cili me vendimin datë 6.12.2013 të drejtuesit të Prokurorisë është zëvendësuar nga subjekti Dritan Nushi.

26.2 Në kallëzimin datë 7.6.2013 kërkohet ndjekja penale e ekspertit H. Sh., sepse ka bërë aktekspertim të njëanshëm, datë 5.11.2012, të kontratës së dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë

¹³² Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

20.9.1990, si dhe ndjekja penale e noteres Sh. K. për falsifikimin e kësaj kontrate dhe të dëshmisë së trashëgimisë nr. ***, datë 17.4.1990. Në informacionin datë 11.6.2013 për referim të veprës penale, oficeri i policisë gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë referon për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” (neni 248 i Kodit Penal), por nuk rezulton që të jetë regjistruar procedimi penal për këtë vepër dhe as të jetë pyetur noterja Sh. K..

26.3 Me kallëzimin datë 28.1.2014, bashkëlidhur denoncimit, denoncuesja ka bërë shtesë të kallëzimit të parë, duke kërkuar ndjekje penale ndaj noteres Sh. K. për falsifikimin e aktit noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.1990 dhe dëshmisë së trashëgimisë nr. ***, datë 17.4.1990, ku denoncuesja nuk figuron si trashëgimtare e nënës së saj. Ky kallëzim shtesë që denoncuesja i ka bashkëlidhur denoncimit pranë Komisionit, nuk figuron i regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nuk është pjesë e fashikullit të dosjes penale që ka administruar Komisioni.

26.4 Nga aktet në dosje rezulton se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është ngritur padi nga shtetasja F. M., e cila, midis të tjerash, ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.1990. Gjatë gjykimit, me aktekspertimin nr. ***, datë 5.11.2012, eksperti I. Sh. ka konkluduar se nënshkrimi për shtetasen F. M. në kontratën e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.1990, është shkruar prej saj. Paditësja nuk ka qenë dakord me këtë akt ekspertimi dhe ka kërkuar riekspertim, madje ka kryer privatisht një akt ekspertimi nga dy ekspertë kriminalistë, të cilët kanë konkluduar se nënshkrimet në kontratën e dhurimit nuk janë të shtetasës F. M., por gjyqtarja ia ka refuzuar kërkesën për të administruar këtë aktekspertim.

26.5 Në urdhrin datë 13.12.2013 për caktimin e detyrave që duhet të kryejë OPGJ-ja në interes të hetimit, subjekti kërkon informacion nga OPGJ-ja se çfarë është bërë për noteren, për të cilën në kallëzim është kërkuar ndjekje penale.

26.6 Përveç hetimeve të kryera nga OPGJ-ja pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, janë kryer veprime hetimore edhe nga Prokuroria e Rrethit Tiranë, si marrja në pyetje e ekspertit I. Sh. dhe bashkëshortëve F. e I. M.¹³³, administrimi i akteve nga dosja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; janë këqyruar aktet noteriale në zyrën e noteres Sh. K..

26.7 Ndërkohë, me shkresën nr. *** prot., datë 24.2.2014, gjyqtarja që gjykonte çështjen civile me objekt pavlefshmërinë e kontratës së dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.1990, njofton Prokurorinë e Rrethit Tiranë se çështja është në proces gjykimi.

26.8 Me vendimin datë 3.3.2014, subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2013, në bazë të nenit 328/1, shkronja “f” e Kodit të Procedurës Penale “Në rastet e tjera të parashikuara me ligj”. Në dispozitivin e vendimit, subjekti citon: *“Gjykata është ende në hetim dhe shqyrtim gjyqësor të çështjes ku, ndër të tjera, është objekt kryesor ekspertimi për falsitet i dokumentit të sipërcituar kontratë dhurimi... pra cikli gjyqësor është i pambyllur”*. Gjithashtu, subjekti ka cituar edhe nenin 391 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me falsitetin.

26.9 Në përfundim të shqyrtimit të kësaj dosjeje, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime të plota dhe duke mos konkluduar me vendim në lidhje me faktin nëse ka apo jo vepër penale “Ekspertimi i rremë” nga ana e ekspertit dhe “Falsifikim” apo “Shpërdorim detyre” nga ana e noteres. Nga një konkluzion i drejtë në lidhje me veprën penale “Ekspertimi i rremë”, varej edhe përcaktimi i saktë i faktit nëse ka apo jo vepër penale “Falsifikimi” apo “Shpërdorimi i detyrës” nga ana e noterit që e ka ligjëruar kontratën dhe dëshminë e trashëgimisë.

26.10 Nga aktet në dosje dhe ato bashkëlidhur denoncimit nuk rezulton të jetë bërë ankim ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal.

¹³³ Respektivisht në datat 15.7.2013 dhe 11.9.2013.

26.11 Për sa më lart, duket se subjekti i rivlerësimit ka pushuar procedimin penal “Ekspertimi i rremë” në ngarkim të ekspertit I. Sh., në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe nuk ka kryer hetime të plota, për të konkluduar nëse ka veprë penale nga ana e noteres Sh. K..

Komisioni i ngarkoi subjektin që, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, të japë shpjegimet e nevojshme në lidhje me këto veprime të tij që janë konstatuar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

26.12 Referuar materialit kallëzues të shtetasës F. M., ajo pretendonte se është trashëgimtare e shtetasit O. B. me $\frac{1}{4}$ e pasurisë së tij dhe trashëgimtare me $\frac{1}{3}$ e pasurisë së nënës së saj H. B., e cila ka trashëguar $\frac{1}{4}$ e pasurisë së shtetasit O. B. si bashkëshorte e këtij të fundit. Pasuria e shtetasit O. B. përbëhej nga dy shtëpi banimi me oborr në përdorim, me sipërfaqe 1050 m² në total: shtëpia nr. *** në përdorim të shtetasit B. B., nipi i F. M., dhe shtëpia nr. *** ku banon shtetasi B. B., i biri i R. B..

26.13 Në vitin 2005, në shtëpitë e babait të shtetasit S. B., kishin shkuar disa shoqëri ndërtimi për të marrë truallin për të ndërtuar pallate banimi. Shtetasja F. M. rastësisht vihet në dijeni të këtij ndërtimi dhe merr kontakt me shoqërinë ndërtuese, duke u bërë me dije se ajo ishte trashëgimtare e shtetasit O. B. dhe do të merrte pjesën takuese të kësaj trashëgimie. Si trashëgimtare e shtetasit O. B. u tregon drejtuesve të shoqërisë ndërtuese vendimin gjyqësor nr. ***, datë 27.9.1986, të trashëgimisë që dispononte.

26.14 Në ndjekje të problemeve të trashëgimisë, gjatë procesit gjyqësor të iniciuar prej saj në datën 23.12.2005, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, shtetasja F. M. vihet në dijeni se ekzistonte një kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.1990, në të cilën pasqyrohej fakti se F. dhe motrat e saj i dhuronin shtetasit S. B. të gjithë pasurinë që rridhte nga trashëgimia e shtetasit O. B., duke hequr dorë vullnetarisht secila nga pjesa trashëguese e kësaj pasurie. Kjo kontratë dhurimi sipas deklaratimit të shtetasës F. M. është e falsifikuar pikërisht tek nënshkrimi në fund të saj, pasi ai nënshkrim nuk është bërë prej saj.

26.15 Kjo kontratë është bërë objekt i një hetimi gjyqësor civil me objekt padie “Detyrim njohjeje i së drejtës së pronësisë të paditëses F. M. për $\frac{1}{4}$ pjesë të së gjithë pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit O. B. etj.”, gjyq i cili gjatë hetimit në Prokurori vazhdonte gjykimin në Gjykatën e Rrethit Tiranë tek gjyqtarja M. B..

26.16 Pasi subjekti ka administruar pjesë të dosjes së këtij gjykimi në lidhje me caktimin e ekspertit H. Sh. dhe administrimin e aktit të ekspertimit të kryer prej tij, ka konstatuar se në lidhje me dokumentin kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.1990, në seancën gjyqësore të datës 18.9.2012, pra mbi një vit para depozitimit të kallëzimit në Prokurori, gjyqtarja M. B. kishte pranuar kërkesën e paditëses M. për të bërë një ekspertim grafik nënshkrimi dhe i ishte drejtuar Institutit të Policisë Shkencore Tiranë për të caktuar një ekspert.

Ekspertit të caktuar H. Sh. i janë dërguar me shkresën zyrtare të gjykatës nr. *** akti, datë 17.10.2012, aktet objekt ekspertimi, modelet e lira dhe krahasuese të marra në seancë sipas listës së dhënë nga Gjykata.

26.17 Deklarata e pretenduar e falsifikuar dhe e dorëzuar tek eksperti nga palët rezulton se është fotokopje, pasi vetë palët, sipas procesverbalit gjyqësor, nuk kanë mundur të sigurojnë origjinalen. Gjykata ka konstatuar kryesisht se paditësja M. dhe modelet e lira të dorëzuara nga vetë ajo nuk i ka të njëjta me modelet eksperimentale të plotësuar aty. E pyetur për këtë fakt, paditësja M. pranon se modelet e lira janë të asaj, por tashmë ajo e ka ndryshuar nënshkrimin, nuk bën më firmë, por shënon vetëm emrin dhe mbiemrin, kjo si pasojë e kalimit të viteve (nga procesverbali gjyqësor).

26.18 Sipas aktit të ekspertimit të ardhur në Gjykatë në datën 6.11.2012, ka rezultuar se “Nënshkrimi në dokumentin “Kontratë dhurimi” me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.1990, poshtë shtypshkrimit të emrit F. M., është bërë nga F. M.”.

26.19 Sipas shtetasës F. M., ajo nuk ka qenë dakord me konkluzionet e këtij akti ekspertimi dhe e ka kundërshtuar në Gjykatë, duke kërkuar riekspertim, por Gjykata nuk e ka pranuar kërkesën.

26.20 Po për këtë dokument shtetasja F. M. ka bërë një ekspertim tjetër tek dy ekspertë privatë, të cilët kanë dhënë konkluzionin: “Në dokumentin kontratë dhurimi me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.1990, poshtë shtypshkrimit të emrit F. M., nënshkrimi nuk është bërë nga F. M.”. Gjyqtarja e çështjes, znj. B., nuk ka pranuar të administrohet ky akt ekspertim i bërë privatisht.

26.21 E pyetur gjatë hetimit, nëse ia ka vënë në dispozicion edhe ekspertit H. Sh. dy ekzemplarët e dokumentit “Kontratë dhurimi” nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.1990, që ajo u ka vënë në dispozicion ekspertëve privatë Q. D. dhe D. Z., shtetasja F. M. është përgjigjur se nuk ia ka vënë në dispozicion shtetasit H. Sh., por i ka futur në proces pasi ishte dhënë konkluzioni nga ky ekspert.

26.22 Me vendimin e ndërmjetëm datë 28.10.2013, Gjykata ka vendosur kryerjen e aktit të ekspertimit, për të hetuar në lidhje me padinë e ndërhyrjes kryesore (shtetasi K. K.) dhe pretendimet që ngrihen në këtë padi. Në seancën e datës 29.1.2014, eksperti i caktuar A. Sh. nuk e depozitoi aktin e ekspertimit dhe deklaroi se, meqë palët nuk i kanë vënë në dispozicion provat e kërkuara prej tij, ai nuk mund të kryejë aktin e ekspertimit sipas pyetjeve të caktuara nga Gjykata. Edhe në këtë rast, objekt i ekspertimit janë përsëri nënshkrimet dhe firmat e shtetasve S. B. dhe H. K. tek kontrata e dhurimit nr. ***, datë 20.9.1990.

26.23 Në vijim të prapësimeve, subjekti shpjegon se ka analizuar në atë kohë që, bazuar në provat e administruara, provohej se Gjykata Civile ishte ende në shqyrtim gjyqësor të çështjes ku, ndër të tjera, është objekt kryesor ekspertimi për falsitetin e dokumentit të sipërcituar kontratë dhurimi, pra cikli gjyqësor me këtë objekt ishte ende i pambyllur.

26.24 Konform nenit 391 të Kodit të Procedurës Penale: “...falsiteti i një dokumenti të vërtetuar me vendim gjykate deklarohet në dispozitiv, ku edhe urdhërohet sipas rastit fshirja tërësore ose e pjesshme, përsëritja apo ndryshimi i aktit apo dokumentit, duke caktuar edhe mënyrën me të cilën duhet bërë. Ky deklarim falsiteti mund të ankimohet bashkë me vendimin përfundimtar”.

26.25 Në një arsytim të zgjeruar në prapësime, subjekti qartëson se duke qenë se palët janë në konflikt gjyqësor civil, sipas ligjit, është Gjykata Civile i vetmi organ kompetent që, në analizë të neneve 272, 273, 274 dhe 275 të Kodit të Procedurës Civile, kur gjatë shqyrtimit gjyqësor të një çështjeje civile, konstaton se ka dyshime për falsitetin e një dokumenti të paraqitur para saj dhe ajo provë vlerësohet thelbësore për sqarimin e çështjes, pezullon gjykimin deri në përfundimin e çështjes penale. Pala që pretendon falsitetin e një dokumenti, është e detyruar të paraqesë prova para Gjykatës, në rast të kundërt është i papranueshëm për Gjykatën. Sipas nenit 275 të Kodit të Procedurës Civile, sekretaria e Gjykatës dërgon menjëherë në Prokurorinë kompetente dhe në organin që ka nxjerrë shkresën kopjen e çdo vendimi që e shpall shkresën si të falsifikuar.

26.26 Me këto dispozita sanksionohet se, nëse në një proces gjyqësor civil paraqitet nga palët një provë dokumentare që dyshohet e falsifikuar, me kërkesën e palës që pretendon falsitetin, ose ndërpritet shqyrtimi gjyqësor civil i çështjes dhe dërgohet për hetim në prokurorinë kompetente, ose Gjykata shqyrton falsitetin e dokumentit dhe, nëse e gjen fals, deklaron këtë fakt në vendimin e saj përfundimtar, duke pasur detyrimin të njoftojë Prokurorinë për këtë fakt.

26.27 Për rastin konkret, ka qenë vetë Gjykata Civile që ka shqyrtuar pretendimin për falsitet me ekspertë të Policisë Shkencore Shtetërore (të njëjtët do të merreshin edhe nga ne, për t'i dhënë zgjidhje një problemi të tillë), pa e ndërprerë shqyrtimin gjyqësor të çështjes dhe i ka dhënë vetë zgjidhje pa iu

drejtuar organit të Prokurorisë. Kjo provohet edhe me faktin se në atë kohë pranë kësaj Prokurorie nuk është regjistruar asnjë njoftim nga Gjykata, ashtu siç e parashikon neni 275 i Kodit të Procedurës Civile.

26.28 Duke përdorur si artificë nenin 70 të Kodit të Procedurës Penale “Efektet e vendimit penal për gjykimin civil dhe administrativ” që thotë se “*1. Vendimi penal i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që shqyrton pasojat civile të veprës vetëm për sa i përket faktit nëse vepra penale është kryer dhe nëse është kryer nga i gjykuari...*”, palët e përfshira në një proces gjyqësor civil, sidomos në rastet e konflikteve të pronësisë së paluajtshme, përpiqen gjithmonë që, megjithëse çështja objekt konflikti është në shqyrtim e sipër në Gjykatë dhe kjo e fundit po e trajton me seriozitetin e duhur si në rastin konkret, por me koston e një kohe pak më të gjatë, për shkak edhe të dinamikave të saj të punës dhe të ngarkesës, këto palë, pa u mbyllur procesi në Gjykatë, i drejtohen Prokurorisë me të njëjtin objekt çështjeje, për të përfituar edhe nga afatet e shpejta që legjislacioni penal ka. Por kjo ka një kosto tepër të lartë për drejtësinë, pasi ndërhyrja e Prokurorisë për një element të caktuar të çështjes civile, pa u futur në brendësi dhe tërësi të konfliktit, në një çështje ku Gjykata Civile është investuar prej kohësh me hetim gjyqësor, prova, dëshmitarë, ekspertë etj., mund të ndryshojë pjesërisht ose tërësisht rrjedhën e asaj çështjeje dhe të dëmtojë dhënien e drejtësisë, pikërisht nëse aplikohet neni i mësipërm. Nga ana tjetër, neni 71 i Kodit të Procedurës Penale “Pasojat e procedimit civil dhe administrativ për atë penal” përcakton se: “*1. Vendimi civil i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që gjykon çështjen penale vetëm për sa i përket faktit nëse vepra ka ndodhur ose jo, por jo për fajësinë e të pandehurit*”.

26.29 Lidhur me urdhërimet e këtij neni, për sa i përket hetimit të ndjekur nga subjekti deri në datën e vendimit të tij, Gjykata Civile po investohet në themel për zgjidhjen e çështjes në fjalë, nuk kishte një vendim civil të formës së prerë dhe nuk ndodheshim në kushtet e pezullimit.

26.30 Për sa kohë shkencërisht, me akt ekspertimi, vendim gjykate dhe me prova të tjera nuk rezultonte ndonjë dokument i falsifikuar në atë kohë, rrjedhimisht që nuk kishte vend për të hetuar në lidhje me noteren Sh. K., që rezultonte se e kishte hartuar dokumentin në vitin 1990, pasi vepra penale e falsifikimit të dokumenteve e pretenduar, nëse ekzistonte, sipas nenit 186/3 të Kodit Penal kishte një sanksion dënimi nga 1-7 vjet burgim, por në vitin 2014 rezultoi e parashkruar ndjekja penale konform nenit 66, shkronja “c” e Kodit Penal.

26.31 Në këto kushte, subjekti e gjen të drejtë dhe të bazuar në prova e në ligj vendimin e tij, datë 3.3.2014 “Për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2013”.

26.32 Për sa i përket shtesës së kallëzimit që kallëzuesja pretendon se ka bërë, për sa kohë që nuk gjendet në dosje, subjekti deklaroi se nuk është paraqitur para tij gjatë kohës që çështja ishte në hetim. Për më tepër, me vendimmarrjen e subjektit, kallëzuesja ka qenë dakord dhe nuk e ka ankimuar.

Për sa më lart, subjekti pretendon se ka provuar sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 të kundërtën e rezultatit të hetimit për konstatimin e lartpërmendur.

Vlerësimi i Komisionit

26.33 Në lidhje me veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, referuar nenit 186/3 dhe nenit 66, shkronja “c” e Kodit Penal, qëndron prapësimi i subjektit të rivlerësimit se afati i ndjekjes penale për këtë vepër penale është parashkruar, si dhe referuar akteve të administruara në dosjen hetimore dhe akteve bashkëlidhur denoncimit, nuk mund të hetonte për një kallëzim, i cili nuk ishte regjistruar në regjistrat e prokurorisë.

26.34 Në lidhje me veprën penale “Ekspertimi i rremë”, duke mbajtur në konsideratë rrethanat e çështjes civile dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile që përshkruan subjekti në prapësime, Komisioni vlerëson se këto prapësime janë të mjaftueshme për të krijuar bindjen se subjekti ka marrë

një vendim të drejtë, të bazuar në dispozitat procedurale penale dhe ato procedurale-civile që lidhen me procesin penal.

26.35 Sipas përmbajtjes së procesverbalit datë 15.7.2013, eksperti H. Sh. gjatë pyetjes ka deklaruar se nuk e njeh dhe nuk ka pasur kontakt me kallëzuesen. Atij i është dhënë nga gjykata për ekspertim mbi falsitetin vetëm një dokument, të cilin e ka përshkruar në akt, si dhe modelet për krahasim. Dokumentin e dytë që pretendon kallëzuesja, nuk e njeh dhe nuk i është vënë në dispozicion nga asnjëra prej palëve ndërgjyqëse.

26.36 Sipas përmbajtjes së procesverbalit datë 11.9.2013, të njëjtin shpjegim ka dhënë gjatë pyetjes edhe shtetasja F. M., duke shtuar edhe se dy ekzemplarët e kontratës së dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.1990, nuk ia ka vënë në dispozicion ekspertit H. Sh., por vetëm ekspertëve privatë të caktuar prej saj. Këta dy ekzemplarë ajo i ka depozituar në dosjen gjyqësore pas datës kur shtetasi H. Sh. ka dhënë konkluzionet e tij mbi aktin e ekspertimit që ka kryer.

26.37 Në denoncim, denoncuesja ka pretenduar se procedimi është pushuar pa u kryer asnjë hetim. Nga ana tjetër, sipas akteve në dosje, Komisioni ka konstatuar se janë kryer mjaft veprime hetimore, sidomos nga hetuesi paraardhës Z. H. (administrimi i materialit kallëzues nga Drejtoria e Policisë Tiranë; administrimi i dëshmisë së trashëgimisë nr. ***, datë 17.4.1990; i kontratës së dhurimit *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.1990; akte ekspertimi datë 12.2.2013 dhe datë 5.11.2012; shkresa datë 6.1.2012 nga ZVRPP Tiranë; deklaratë e vitit 1989 ku shtetasja F. M. deklaroi para kryesisë së Këshillit Popullor të lagjes nr. ***, blloku nr. ***, në prani të 3 dëshmitarëve se pjesët që ajo ka trashëguar nga babai i saj O. B., në shtëpitë nr. *** e nr. *** në Lagjen nr. ***, rruga “****”, blloku nr. ***, ia dhuron pa shpërblim vëllait të saj S. B., i cili aktualisht banon aty; pyetja e ekspertit H. Sh., shtetasit I. M., shtetasës F. M.; administrimi i dokumenteve nga zyra e noteres Sh. K.; kërkesa drejtuar gjykatës për të dërguar pranë prokurorisë aktet dhe procesverbalet gjyqësore që kanë të bëjnë me caktimin e ekspertit dhe kryerjen e aktit të ekspertimit prej tij etj.). Ndërsa subjekti ka kryer si veprime procedurale ripyetjen e shtetasës F. M. në datën 13.1.2014, si dhe kërkimin e dokumentacionit shtesë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 17.2.2014.

26.38 Duke mbajtur parasysh këto rrethana dhe faktin që kallëzuesi nuk ka bërë ankim ndaj vendimit të subjektit brenda afateve procedurale, duket se kallëzuesja ka qëllim më tepër të zhvlerësojë aktin e ekspertimit nëpërmjet procesit penal, akt i cili është kryer bazuar në ato akte që ekspertit i janë vënë në dispozicion nga gjykata dhe për të cilin gjykata nuk ishte shprehur ende me vendim përfundimtar, sesa të godasë veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit.

26.39 Subjekti ka marrë vendimin datë 3.3.2014 për “Pushimin e procedimit penal”, pasi ka administruar shkresën datë 24.2.2014 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, që konfirmon se procesi gjyqësor është në shqyrtim, në pritje për t’u kryer akti i ekspertimit për kundërpandinë, i cili nuk ishte kryer ende, për shkak se palët nuk kishin vënë në dispozicion të ekspertit provat e kërkuara prej tij.

26.40 Në këto kushte, kur Gjykata Civile nuk kishte marrë vendim për të administruar provat e paraqitura në gjykim, përfshirë këtu edhe aktet e ekspertimeve, për të cilat ende nuk kishte dhënë një vlerësim, subjekti nuk mund të hetonte për aktin e ekspertimit dhe kontratën e dhurimit, për vlefshmërinë e të cilave nuk ishte shprehur ende kjo Gjykatë.

Për sa më lart, nën dritën e neneve 272, 273, 274 e 275 të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 70 e 71 të Kodit të Procedurës Penale, Komisioni arrin në përfundimin se nuk rezulton të ketë mangësi në veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit, që mund ta ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore në lidhje me kriterin profesional.

27. Denoncimet nr. *, datë 23.11.2017 dhe nr. ***, datë 23.1.2018, të shtetasit S. P., i cili pretendon se dy prokurorët Dritan Nushi dhe A. Q. nuk kanë nisur procedimin penal në ngarkim të topografes B. L., sepse janë të korruptuar. Në ankesën drejtuar kryeprokurorit të Tiranës, denoncuesi**

shprehet se ka kallëzuar topografen B. L. për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” (neni 248 i Kodit Penal), “Akt ekspertimi i rremë” (neni 309 i Kodit Penal) dhe “Evazioni fiskal”. Gjithashtu, në ankimin drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, denoncuesi pretendon se në datën 24.5.2016 ka bërë kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Tiranë dhe në datën 2.11.2016 është njoftuar për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. ***, datë 30.6.2016.

27.1 Komisioni, pasi administroi¹³⁴ dhe shqyrtoi dosjen e kallëzimit penal nr. ***, datë 30.6.2016, të hetuar nga subjekti i rivlerësimit, vëren se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, datë 30.6.2016. Ky organ ka administruar fashikullin e dosjes gjyqësore të procesit civil të gjykuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (që përmban aktet e ekspertimit datë 16.2.2016 dhe datë 4.5.2016, shtesa datë 15.5.2013 e aktit të ekspertimit të ekspertes inxh. topogjeodete B. L.; faturat tatimore nr. *** dhe nr. **, datë 26.5.2016 dhe dy kuponë tatimore datë 26.5.2016, lëshuar nga ekspertja B. L. për blerësin S. P. si pagesa për aktin e ekspertimit të depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë); janë kryer veprime hetimore, si pyetja e kallëzuesit dhe pyetja e ekspertes B. L.; janë administruar aktet në lidhje me origjinën e pronave të paluajtshme objekt gjykimi civil që janë në pronësi të palëve ndërgjyqëse, si dhe hartat përkatëse bashkëlidhur.

27.2 Me vendimin datë 16.9.2016, në bazë të nenit 290/1, shkronja “ç” dhe nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me këtë kallëzim, duke argumentuar se në veprimet dhe mosveprimet e shtetases B. L. nuk rezulton të jenë konsumuar elementet e ndonjë vepre penale.

27.3 Në aktet e depozituara nga denoncuesi dhe ato të administruara¹³⁵ nga Komisioni nuk rezulton të jetë bërë ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal që ka disponuar subjekti.

27.4 Nga shqyrtimi i kësaj dosjeje, Komisioni nuk vëren mangësi në aspektin procedural, ndërsa në lidhje me vendimmarrjen e subjektit që ka të bëjë me themelin e çështjes, Komisioni nuk ka kompetencë shqyrtimi dhe vlerësimi referuar nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

Për sa më lart, Komisioni nuk konstatoi problematika në veprimet e subjektit.

28. Denoncimi nr. *, datë 20.7.2022, i shtetasit A. A.** Denoncuesi pretendon se mbi bazën e akteve të dërguara nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë formulon akuzën “Krijimi i kushteve dhe mjeteve për të kryer vrasje”, akuzë e pabazuar në fakte e prova dhe tendencioze. Pretendohet dhënie e informacionit në media, se shtetasi A. A. u ka dhënë grupeve kriminale informacion të marrë nga sistemi TIMS i Policisë së Shtetit, kur ndërkohë në dosje nuk rezulton një fakt i tillë. Pasi i është njoftuar akuzat, shtetasi A. A. i ka dërguar në datën 9.11.2021 një memo prokurorit brenda afatit 10-ditor, megjithatë prokurori nuk e ka marrë në konsideratë dhe e ka dërguar çështjen për gjykim pa kryer asnjë akt procedural për zbardhjen e së vërtetës, por siç i ka ardhur dosja nga Prokuroria e Rrethit Vlorë. E vetmja gjetje e prokurorit është deklarimi i shtetases Xh. V. “*Sipas mendimit tim, A. A. mund të hyjë në sistemin TIMS si specialist IT*”, duke e trajtuar këtë fakt sikur kjo shtetase të ishte eksperte e fushës. Prokurori duhej të konstatonte se nuk jemi në rastin e moskompetencës tokësore dhe ta kthente çështjen në Prokurorinë e Rrethit Vlorë. Provën kryesore, që është procesverbali datë 23.11.2019 i këqyrjes së telefonit të shtetases N. Sh., prokurori nuk e analizon fare në aktakuzë dhe në konkluzionet përfundimtare. Në procesverbal flitet për biseda që provojnë qartë akuzën ndaj shtetasve N.Sh. e D. S., kurse shtetasi A. A. nuk ka lidhje fare. Prokurori nuk ka analizuar procesverbalin e pyetjes, ku shtetasi A. A. ka shpjeguar procedurën që ndiqet kur ka probleme në sistemet policore. Prokuroria duhej të merrte informacion nga Drejtoria e Policisë së

¹³⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.11.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹³⁵ Shkresat nr. *** prot., datë 31.1.2023, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. *** prot., datë 26.1.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Shtetit nëse shtetasi A. A. ka pasur akses në sistemet policore ose jo. Prokurori ka kërkuar masë dënimi 2 vjet burgim për secilin nga tre të pandehurit, duke vendosur barazi, edhe pse logjikisht pesha e fajit nuk mund të jetë e njëjtë për të tre.

28.1 Komisioni, pasi administroi¹³⁶ dhe shqyrtoi dosjen e procedimit penal nr. ***/viti 2020, vëren se me vendimin datë 23.10.2020 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur ndarjen e procedimit penal nr. ***/2019 në dy procedime: nr. ***/2020 dhe nr. ***/2020 – ky i fundit në ngarkim të shtetasve N. Sh., A. A., D. S. etj. – për veprën penale “Sigurim i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer veprën penale”. Procedimi penal nr. ***/2020 është dërguar për kompetencë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, pasi është regjistruar me nr. **, datë 7.10.2021, është hetuar nga subjekti i rivlerësimit.

28.2 Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se pasi i është njoftuar akuza shtetasi A. A. i ka dërguar në datën 9.11.2021 një memo prokurorit brenda afatit 10-ditor, por prokurori nuk e ka marrë në konsideratë, në referim të nenit 327, pikat 4 dhe 5 të Kodit të Procedurës Penale, rezulton se në dosjen e ardhur nga Prokuroria nuk ndodhet e depozituar memoja që pretendon denoncuesi. Në këto kushte, Komisioni nuk mund të konkludojë nëse është i vërtetë pretendimi i denoncuesit se me letrën postare që i ka bashkëlidhur denoncimit shtetasi A. A. ka dërguar pikërisht memon pranë subjektit të rivlerësimit.

28.3 Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se prokurori duhej të konstatonte se nuk jemi në rastin e moskompetencës tokësore dhe ta kthente çështjen në Prokurorinë e Rrethit Vlorë, Komisioni vëren se në analizë të akteve të administruara në fazën e hetimit paraprak, rezulton që faktet objekt hetimi për sigurimin e kushteve për kryerjen e vrasjes së shtetasit E. M., si marrja e informacionit nga N. Sh. dhe dërgimi i tij tek vëllezërit D. nga D. S., D. E. e F. H., kryerja e pagesës për informacionin e dhënë, kanë ndodhur në qytetin e Tiranës, ku ka qenë asokohe edhe vendndodhja e shtetasve të përfshirë në këtë aktivitet. Në interpretim të neneve 76 e 77/3 të Kodit të Procedurës Penale, kompetente për të vazhduar ushtrimin e ndjekjes penale është Prokuroria e Rrethit Tiranë.

28.4 Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se shtetasi A. A. është i pafajshëm, Komisioni vlerëson se fajësia ose jo lidhet me themelin e çështjes për të cilën nuk ka kompetencë vlerësimi sipas nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

28.5 Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se subjekti ka kërkuar për tre të pandehurit të njëjtën masë dënimi, 2 vjet me burg, duke e trajtuar të barabartë peshën e fajit, Komisioni vlerëson se sipas nenit 26 të Kodit Penal bashkëpunëtorët ndahen në organizatorë, ekzekutorë, shtytës, ndihmues. Vetë kjo ndarje nënkupton se veprimtaria, rrezikshmëria dhe përgjegjësia e secilit prej tyre nuk është e njëjtë.

Në çështjen konkrete, subjekti nuk ka mbajtur parasysh se personi kryesor, i cili ka dhënë informacion, ka qenë shtetasja N. Sh.. Kjo provohet nga aktet në dosje (procesverbale të pyetjes së këtyre shtetasve dhe procesverbale të përgjimeve telefonike etj.), ndërsa shtetasi A. A. ka kontaktuar me personat që kërkonin shtetasin E. M. vetëm në rastin kur ata, pasi kishin marrë informacion nga shtetasi D. E. (djali i dajës së A.), informacion ky i gjetur nga shtetasja N. Sh., nuk kishin kryer pagesën.

28.6 Neni 27, pika 2 e Kodit Penal përcakton se: “Në caktimin e dënimit për bashkëpunëtorët, gjykata duhet të mbajë parasysh shkallën e pjesëmarrjes së secilit dhe rolin e luajtur në kryerjen e veprës penale”. Duke qenë se gjykata vendos, midis të tjerash, edhe duke mbajtur parasysh kërkimin e organit të akuzës në lidhje me masën e dënimit të të pandehurve, kjo dispozitë vlen për analogji edhe për organin e akuzës në formulimin e kërkesës së tij për masën e dënimit.

¹³⁶ Shkresë nr. ***/ prot., datë 19.12.2022, e Prokurorisë së Rrethit Tiranë.

28.7 Për sa më lart, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka vlerësuar drejt rolin dhe përgjegjësinë e bashkëpunëtorëve të veprës penale, pasi ka kërkuar të njëjtën masë dënimi për të tre, duke cenuar kështu të drejtat e tyre për një trajtim të drejtë dhe objektiv gjatë hetimeve.

Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit në lidhje me konstatimet e lartpërmendura.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

28.8 Në prapësimet e tij, subjekti i rivlerësimit citon pjesë nga kërkesa datë __.11.2021 që ai i ka drejtuar gjykatës për dërgimin e çështjes në gjykim ndaj të pandehurve N. Sh., A. A., D. S., si dhe rendit provat e administruara gjatë hetimit për të provuar kryerjen e veprës penale “Sigurimi i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje”. Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti ka depozituar edhe vendimin nr. ***, datë 26.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka vendosur sipas kërkesës së subjektit të rivlerësimit deklarimin fajtor të tre të pandehurve A. A., D. S. dhe N. Sh., si dhe dënimin e secilit prej tyre me nga 2 vjet burgim dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit për të pandehurën N. Sh., duke e vënë në periudhë prove për 2 vjet e 6 muaj.

28.9 Në prapësimet e tij, subjekti i rivlerësimit citon se i pandehuri A. A., ish-punonjës në Policinë e Shtetit, me detyrë IT në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës dhe më pas në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitet 2015 – 2019, kishte akses në sistemet kompjuterike sensitive të kësaj strukture, sa herë që kishte probleme tek përdoruesit e këtyre sistemeve, por edhe me iniciativë.

28.10 Për këtë, subjekti citon edhe deklarimin e shtetasës Xh. V., kolege e shtetasit A. A., e cila ka deklaruar se, pasi herë pas here, për shkak të ngarkesës së sistemit, operatorët kanë probleme me sistemin dhe A. si specialist IT, së bashku me kolegen e tij R. H. dhe shefin e tyre Xh. A., pasi njoftoheshin për defektet e konstatuara, vinin dhe riparonin defektet apo anomalitë e ndryshme në kompjuterë. Sipas saj, për shkak të funksionit që ka pasur shtetasi A. A., ai ka pasur akses në *password*-et e sistemeve dhe, nëse do i duhej të kërkonte për ndonjë person, ai do të hynte vetë dhe të kërkonte pa qenë nevoja që t’i kërkonte punonjësit *password*-in.

28.11 Roli deciziv i shtetasit A. A., duke hyrë në sistemet TIMS etj., me kredencialet e Xh. V. dhe të punonjësve të tjerë, pa dijeninë e tyre, kur ata kishin probleme me rrjetin kompjuterik, si dhe duke marrë të dhëna sensitive e duke informuar grupin kriminal me të cilin kishte lidhje në Vlorë, për lëvizjet e personave “shënjestra” të atentateve të mundshme fatmirësisht të pakryera, rezultoi i provuar edhe gjatë gjyqimit.

28.12 Në vendimin e saj, gjykata arsyeton se me provat e administruara provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se të pandehurit D. S. dhe N. Sh., nga muaji maj i vitit 2019 deri në datën 22.8.2019, duke shfrytëzuar lidhjet e kushëririt D. E., kanë bashkëpunuar në mënyrë aktive me shtetasit F. H., L. D., A. A. etj., me qëllim për të siguruar informacion për lëvizjet e shtetasit E. M..

Vlerësimi i Komisionit

28.13 Duke marrë në konsideratë prapësimet e subjektit referuar vendimit nr. ***, datë 26.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që subjekti ka depozituar bashkëlidhur prapësimeve të tij, si dhe për sa i takon masës së dënimit të të pandehurve, kërkimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me vendimin e gjykatës dhe Komisioni çmon se subjekti, ndonëse nuk ka rol vendimmarrës në caktimin e masës së dënimit, e ka vlerësuar drejt rolin e secilit prej bashkëpunëtorëve të veprës penale dhe nuk ka mbajtur qëndrim procedural diskriminues midis tyre.

Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi mangësi në veprimet procedurale të subjektit.

29. Denoncimi nr. *, datë 2.7.2019, i shtetasit Z. K. (ortak i vetëm i shoqërisë “****” sh.p.k.).** Denoncuesi pretendon se pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar procedimi

penal nr. ***, datë 20.2.2019 dhe subjekti ka marrë vendim për mosfillimin e këtij procedimi. Vendimi është korruptiv, prokurori nuk ka kryer fare hetime, nuk ka kërkuar dhe nuk ka arkivuar dosjen objekt hetimi. Vendimi i prokurorit është ankimuar dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 28.6.2019, ka lënë në fuqi vendimin e prokurorit.

29.1 Nga shqyrtimi i akteve që i janë bashkëlidhur denoncimit, rezulton që në kallëzimin penal nr. ***, datë 15.2.2019, denoncuesi pretendon se noterja Xh. B. ka njësuar me origjinalin dokumente të falsifikuara nga V. N. dhe av. F. P. pa parë dokumentet origjinale. Këto dokumente janë përdorur më pas nga avokati M. P. në procesin gjyqësor të zhvilluar midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit V. N..

29.2 Në vendimin datë 6.3.2019 “Për mosfillimin e procedimit penal”, subjekti, mes të tjerash, citon se pasi është pyetur kallëzuesi për rrethanat e çështjes, provohet se ndodhemi para një çështjeje juridiko-civile pronësie, për të cilën palët duhet të kërkojnë zgjidhje në organet administrative e, nëse nuk bien dakord, të drejtohen në Gjykatën Civile. Në zbatim të neneve 272, 273, 274 e 275 të Kodit të Procedurës Civile, nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor konstatohet thelbësor sqarimi i çështjes së falsitetit të dokumentit, gjykata pezullon gjykimin deri në përfundimin e çështjes penale. Pranë prokurorisë nuk është regjistruar asnjë njoftim nga gjykata. Gjithashtu, edhe sikur të rezultonte i vërtetë falsifikimi i pretenduar, në vendimet gjyqësore të administruara bëhet fjalë për dokumente të hartuara në vitet 2001 – 2004 dhe, në bazë të nenit 186/1 të Kodit Penal, vepra penale e falsifikimit është parashkruar dhe nuk mund të ushtrohet ndjekje penale ndaj asnjë personi.

29.3 Në vendimin nr. ***, datë 28.6.2019, me të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e subjektit, argumentohet se prokuroria ka gabuar në vendimin e saj, kur citon që kallëzimin duhet ta bënte Gjykata Civile, pasi në rastin konkret proceset gjyqësore të zhvilluara pranë gjykatave civile nuk kanë pasur objekt padie “goditjen e akteve për falsitet”. Si rrjedhojë, gjykata nuk mund të bënte kallëzim pasi të konstatonte faktin penal të akteve të falsifikuara. Gjykata vetëm i ka administruar këto akte si prova në gjykim. Juridiksioni penal dhe ai civil mund të zhvillohen paralelisht dhe vendimi penal mund të përdoret më pas në procesin civil. Ndërsa, për sa i përket afatit të parashkrimit, kjo gjykatë argumenton se në referim të nenit 66, shkronja “ç” dhe nenit 186 të Kodit Penal, duke marrë në konsideratë se dokumentet janë falsifikuar nga viti 2001 deri në vitin 2004 dhe merret për bazë viti 2004 kur janë falsifikuar dokumentet e fundit, atëherë vepra penale është parashkruar që në vitin 2009.

Pavarësisht të metave në analizën e çështjes nga subjekti i rivlerësimit, fakti që vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke u vlerësuar kështu prej saj edhe hapat proceduralë që ka ndërmarrë subjekti, Komisioni çmon se nuk ka mjaftueshëm elemente që do të ndikonin në një vlerësim negativ në lidhje me kriterin profesional.

30. Denoncimi nr. *, datë 13.3.2019, i shtetas A. C.** Denoncuesja pretendon se subjekti ka anashkaluar provat dhe nuk i ka hetuar ato; ka zvarritur hetimin për 7 muaj pa vendime të shtyrjes së afateve hetimore; ka vendosur pushimin e çështjes; nuk u është përgjigjur kërkesave të kallëzuesit për informacion në lidhje me zhvillimin e hetimeve; prokurori ka kryer vetëm 8 ditë hetime, të cilat janë ndaluar deri në datën 2.10.2018; nuk ka marrë deklarimin e drejtuesit të automjetit; nuk heton policët për shkelje të detyrës; nuk procedon për deklarimin e rremë të polices; ka përdorur si provë një deklaratë dore, datë 5.3.2018, që nuk është nënshkruar nga kallëzuesi.

30.1 Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin hetimor nr. *** dhe ankimit kundër vendimit gjyqësor, datë 18.12.2018, Komisioni vëren se:

30.2 Në datën 25.3.2018, me urdhër të subjektit është regjistruar procedimi penal pa autor për veprën penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” (neni 290/2 i Kodit Penal) mbi bazën e kallëzimit penal datë 25.3.2018, të shtetasit A. C..

30.3 Në kallëzim pretendohet se në datën 5.3.2018 (ora 19:30) shtetasi A. C. ka qenë duke ecur me semafor jeshil për këmbësorin në kryqëzimin e bulevardit “***”, në rrugën “***”, kur mjete me targë ***, i drejtuar nga shtetasi F. B., e ka goditur duke i shkaktuar dëmtime. Autori ka ndaluar për t’i dhënë ndihmë, por i dëmtuari është dërguar menjëherë me ambulancë në spital, ku ka ardhur edhe oficeri i policisë rrugore H. Z. për të marrë deklarinimin në lidhje me shkakun e aksidentit dhe dëmtimin që kishte marrë. Që nga data e aksidentit deri në datën e kallëzimit, çështja nuk është përcjellë në Prokurori.

30.4 Në dosjen hetimore ndodhen:

- Një deklaratë dore, datë 5.3.2018 (ora 20:00), e shtetasit A. C., i cili, pasi përshkruan ngjarjen, deklaron se nuk ka probleme shëndetësore dhe kërkon që kjo çështje të mos ndiqet ligjërisht.

- Procesverbali datë 30.3.2018 i deklarinimit të personit që tregon rrethanat e hetimit, shtetasi H. Z., i cili deklaron se, pasi ka marrë njoftim nga salla operative për të dëmtuarin që është dërguar në spital, ka shkuar atje dhe personi i dëmtuar i ka pohuar se ka qenë vetë fajtor dhe nuk donte që çështja të ndiqej ligjërisht. Më pas, në spital, në prani të djalit të tij dhe të oficerit E. Z., i dëmtuari ka deklaruar në një deklaratë dore rrethanat e ngjarjes dhe vullnetin e tij që kjo çështje të mos ndiqet ligjërisht. Në procesverbal, deklaruesi citon se ka marrë kontakt me punonjës in e policisë rrugore në vendngjarje, i cili i ka shpjeguar se drejtuesit të automjetit i është bërë testi i alkoolit dhe nuk ka rezultuar të ketë konsumuar alkool.

- Procesverbali datë 30.3.2018 i deklarinimit të shtetasit E. H., punonjës i policisë në Komisaratin e Policisë Rrugore, i cili deklaron se ka qenë në detyrë në vendngjarje kur ndodhi aksidenti dhe ka konstatuar se në momentin e goditjes semafori ka qenë me ngjyrë jeshile për automjetet dhe mjete që goditi këmbësorin ka qenë i dyti në radhën e lëvizjes së automjeteve. Pasi është ngritur, këmbësori i ka thënë se ka qenë vetë fajtor për këtë ngjarje dhe nuk ka pretendime për të kryer veprime të tjera. Drejtuesit të automjetit iu bë testi i alkoolit dhe nuk ka rezultuar të ketë konsumuar alkool.

- Procesverbali datë 4.4.2018 “Për kallëzimin e veprës penale” nga shtetasi A. C..

- Procesverbali datë 4.4.2018 “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për ngjarjen” i kallëzuesit A. C..

- Procesverbal këqyrjeje datë 5.4.2018 i oficerit të policisë gjyqësore, ku deklarohet se nga të dhënat e Drejtorisë së Raportit dhe Lëvizshmërisë së Bashkisë Tiranë nuk ekzistojnë kamera monitorimi në perimetrin e vendit të aksidentit (denoncuesi pretendon se ka 4 kamera dhe nuk janë marrë pamjet filmike, pavarësisht kërkesës së bërë; nuk ka shirit të matjes së alkoolit me aparat dragger; nuk i janë bërë analiza gjaku drejtuesit të automjetit).

30.5 Me vendimin datë 3.6.2018 subjekti ka vendosur caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit mjekoligjor. Akti i ekspertimit datë 17.10.2018 është dërguar në të njëjtën datë në prokurori (4.5 muaj më vonë nga data e vendimit).

30.6 Me vendimin datë 2.8.2018 është vendosur caktimi i ekspertit dhe kryerja e ekspertimit autoteknik. Sipas aktit të ekspertimit autoteknik datë 7.10.2018, këmbësori i dëmtuar nuk ka respektuar sinjalistikën e semaforit, ndërsa nuk konstatohen shkelje e rregullave nga drejtuesi i automjetit.

30.7 Me kërkesën datë 18.10.2018, subjekti i ka kërkuar gjykatës pushimin e procedimit penal nr. ***, në bazë të nenit 328, pika 1/b dhe nenit 329, pika 1/a e Kodit të Procedurës Penale, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Në kërkesë, subjekti citon se referuar aktit të ekspertimit autoteknik, datë 7.10.2018, ka rezultuar se sipas mekanizmit të ngjarjes shkak kryesor për ndodhjen e aksidentit janë veprimet e viktimës këmbësore. Sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor datë 17.10.2018, kanë rezultuar tek viktimat plagë që i kanë shkaktuar paaftësinë e përkohshme për punë mbi 9 ditë,

duke e klasifikuar si plagosje e lehtë. Në këto kushte, sipas subjektit, mungon lidhja e drejtpërdrejtë shkak-pasojë.

30.8 Pra, për sa më lart, rezulton se hetimi ka zgjatur 7 muaj.

30.9 Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se i ka dërguar subjektit të rivlerësimit disa kërkesa, por nuk ka marrë përgjigje, rezulton se në dosje ndodhen disa kërkesa të regjistruara pranë Prokurorisë së Rrethit Tiranë në lidhje me këtë procedim penal, konkretisht kërkesat e datave 26.6.2018, të kallëzuesit dhe 26.9.2018, të bashkëshortes së kallëzuesit, kërkesë-memo datë 31.5.2018 e kallëzuesit, si dhe kërkesa datë 11.10.2018 po e kallëzuesit, për të cilat nuk rezulton të ketë përgjigje nga ana e subjektit të rivlerësimit.

30.10 Rezulton se në lidhje me kërkesën e subjektit datë 18.10.2018 “Për pushimin e procedimit”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 18.12.2018, ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal nr. ***, duke orientuar Prokurorinë për hetime të mëtejshme të veprës penale. Subjekti ka bërë ankim ndaj këtij vendimi, duke kërkuar sërish pushimin e procedimit penal. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e saj nr. ***, datë 4.2.2019, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

30.11 Për sa më lart, duket se subjekti:

- Ka zvarritur hetimet dhe nuk ka kryer hetime të plota, prandaj gjykata i ka kthyer aktet për hetime të mëtejshme.
- Ka cenuar të drejtën e personit të dëmtuar nga vepra penale që të njihet me hetimin dhe materialet hetimore dhe nuk i është përgjigjur kërkesave dhe memove të tij, të drejta këto që parashikohen nga neni 58, pikat 1/d, 1/dh dhe nenet 105, 110 e 279/a të Kodit të Procedurës Penale.

Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit në lidhje me konstatimet e lartpërmendura.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

30.12 Në prapësimet e tij në lidhje me zvarritjen e hetimeve, subjekti i rivlerësimit pretendon si shkak ardhjen me vonesë të akteve të ekspertimit mjekoligjor e atij autoteknik, ngarkesën në punë të OPGJ-së dhe të vetë subjektit të rivlerësimit, pushimet e muajit gusht, prandaj nuk ka vend për të konkluduar se janë zvarritur hetimet.

30.13 Në prapësime, subjekti pretendon se pasi ka rifilluar hetimet dhe ka zbatuar detyrat e lëna nga gjykatat, në datën 13.5.2019 i ka kërkuar gjykatës sërish pushimin e procedimit, e cila me vendimin nr. ***, datë 18.7.2019, ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit. Ky vendim gjyqësor ka marrë formë të prerë në datën 14.8.2019 pa u ankimuar.

30.14 Në lidhje me mosinformimin e palës së dëmtuar për ecurinë e hetimit dhe me materialet hetimore, subjekti prapëson se ka pasur ngarkesë pune dhe nuk i është përgjigjur me shkrim, por e ka prituri në zyrë personin e dëmtuar nga vepra penale, së bashku me avokatin e tij. Në zyrë i ka informuar aq sa i lejonte ligji, por ata sërish nuk ishin të kënaqur.

30.15 Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti ka depozituar kopje të fashikullit të procedimit penal nr. ***.

Vlerësimi i Komisionit

30.16 Nga aktet që gjenden në dosjen që ka depozituar subjekti bashkëlidhur prapësimeve të barrës së provës, rezultojnë edhe këto akte:

- Procesverbal datë 29.3.2018 “Për marrjen dhe këqyrjen e të dhënave të datës 5.3.2018 nga sistemi i sallës operative të Drejtorisë së Policisë Tiranë”.

- Procesverbal datë 5.4.2018 i OPGJ-së për marrjen e dokumenteve “Fletëdalje nga *** Tiranë, nr. kartele *** për pacientin A. C. dhe raportit të ISSH-së datë 16.3.2018 për shtetasin A. C.”.

30.17 Gjithashtu, nga shqyrtimi i fashikullit të procedimit penal nr. ***, ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 18.12.2018 ka vendosur kthimin e akteve të këtij procedimi penal, duke orientuar Prokurorinë për hetime të mëtejshme të veprës penale për të kryer këto veprime: ripërsëritjen e aktit autoteknik me një grup prej 3 ekspertësh; të verifikohet nëse drejtuesit të automjetit i është bërë ose jo testi i alkoolit; të ripyetet kallëzuesi nëse disponohen prej tij prova që mund t'i shërbejnë hetimit.

30.18 Subjekti ka bërë ankim ndaj këtij vendimi gjyqësor, duke kërkuar sërish pushimin e procedimit penal, por ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 4.2.2019, të formës së prerë, pa ankim.

30.19 Duke mbajtur parasysh këto akte procedurale si më lart dhe nga përmbajtja e këtij fashikulli në tërësi, krijohet bindja se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë tendencë që të kryejë hetime të paplota, përkundrazi, i ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale që kërkon hetimi i çështjeve të këtij lloji (aksident automobilistik), duke përfshirë edhe veprimet procedurale që gjykata ka orientuar të ripërsëriten (ripërsëritja e aktit autoteknik me grup prej 3 ekspertësh dhe verifikimi i faktit nëse drejtuesit të automjetit i është bërë ose jo testi i alkoolit). Ndërsa në lidhje me detyrën e lënë nga gjykata që të ripyetet kallëzuesi nëse ai disponon prova që mund t'i shërbejnë hetimit, Komisioni vlerëson se duke mbajtur parasysh dy procesverbale të pyetjes së kallëzuesit gjatë hetimit, si dhe të gjitha “kërkesat” dhe “memot” që kallëzuesi i ka drejtuar subjektit gjatë hetimit, në asnjë prej tyre kallëzuesi nuk ka kërkuar të depozitohet ndonjë provë që disponon. Në këto kushte, subjekti nuk ka pasur dyshime se ka prova të tjera që nuk i ka disponuar gjatë hetimit, kështu që bazuar në bindjen e tij të brendshme i ka vlerësuar të mjaftueshme veprimet hetimore të kryera deri në datën kur i ka kërkuar gjykatës “Pushimin e hetimit”.

30.20 Në lidhje me zvarritjen e hetimeve, provohet pretendimi i subjektit se gjatë hetimit është vonuar nga ekspertët kryerja e aktit të ekspertimeve përkatëse (me vendimin datë 3.6.2018, subjekti ka vendosur kryerjen e ekspertimit mjekoligjor dhe akti i ekspertimit është dërguar në Prokurori, në datën 17.10.2018, pra 4.5 muaj më vonë nga data e vendimit; me vendimin datë 2.8.2018 është vendosur kryerja e ekspertimit autoteknik dhe akti ka ardhur në Prokurori në datën 7.10.2018, pra 2 muaj më pas).

30.21 Në lidhje me datat kur eksperti ka disponuar vendimet për aktet e ekspertimit, Komisioni, duke mos iu referuar datës së regjistrimit të procedimit penal, por datës 5.4.2018 të procesverbalit për marrjen e dokumenteve “Fletëdalje nga *** Tiranë, nr. kartele ***”, për pacientin A. C. dhe raportit të ISSH-së, datë 16.3.2018, për shtetasin A. C.”, pra datën kur është kryer veprimi i fundit në lidhje me rrethanat shëndetësore të kallëzuesit, si dhe bindjen e brendshme të prokurorit, i cili ka vlerësuar se duhet të kryhet akti mjekoligjor; duke iu referuar datës 5.4.2018 të procesverbalit të këqyrjes nga OPGJ-ja, ku deklarohet se nga të dhënat e Drejtorisë së Raportit dhe Lëvizshmërisë së Bashkisë Tiranë nuk ekzistojnë kamera monitorimi në perimetrin e vendit të aksidentit (denoncuesi pretendon se ka 4 kamera dhe nuk janë marrë pamjet filmike, pavarësisht kërkesës së bërë; nuk ka shirit të matjes së alkoolit me aparat *dragger*; nuk i janë bërë analiza gjaku drejtuesit të automjetit), si dhe bindjes së brendshme të prokurorit se në kushte të mungesës së këtyre të dhënave, ka lindur nevoja për të kryer aktekspertimin autoteknik; duke mbajtur në konsideratë faktin që edhe pas riçeljes së hetimit ka rezultuar se nuk ka pasur vepër penale (çka provon edhe një herë bindjen e brendshme të prokurorit për këtë fakt) dhe kallëzuesit në këtë aspekt nuk i ka ardhur ndonjë dëm procedural në lidhje me afatet e ankimit apo kompensimit financiar të dëmit të pretenduar shëndetësor; duke mbajtur në konsideratë faktin që, pavarësisht vonesës pa pasoja të hetimit, sërish hetimi është kryer brenda afatit të përgjithshëm procedural prej 2 vjetësh nga data e regjistrimit të tij; duke mbajtur në konsideratë faktin

që ndaj vendimit të pushimit të hetimit nga subjekti pas riçeljes së hetimit, kallëzuesi nuk ka bërë ankim – vlerëson që në vështrim të përgjithshëm veprimet e subjektit për vonesën e hetimit të pretenduar nga denoncuesja nuk përbëjnë vonesa esenciale rënduese për pozitën e kallëzuesit dhe nuk janë të një rëndësie thelbësore për të ngarkuar me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, aq më tepër që nga përmbajtja e dosjes rezulton që veprimet hetimore të jenë kryer në vazhdimësi, në linjë kronologjike logjike dhe në intervale kohore të pranueshme.

30.22 Denoncuesja ka pretenduar se subjekti ka zvarritur hetimet për 7 muaj pa disponuar me vendime për shtyrje të afatit. Komisioni sjell në vëmendje se sipas parashikimeve të neneve 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale, brenda afatit të përgjithshëm 2-vjeçar, hetimet zgjasin deri 3 muaj nga data kur regjistrohet emri i personit që i atribuohet vepra penale e, më pas, zgjatja e afatit të përfundimit të hetimeve bëhet çdo tre muaj. Në rastin e procedimit penal të hetuar nga subjekti i rivlerësimit, rezulton që procedimi penal është regjistruar pa emër të autorit të veprës penale, kështu që subjekti nuk mund të dispononte me vendime për shtyrje të afatit të hetimeve.

30.23 Në lidhje me informimin e palës së dëmtuar, Komisioni sjell në vëmendje se neni 58, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, përcakton detyrimin e organit procedues që të njoftojë menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni dhe të mbajë procesverbal për këtë njoftim; neni 110, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, përcakton detyrimin që organi procedues të shprehet me vendim brenda 15 ditëve për kërkesat dhe memot e depozituara nga palët. Pra, referuar këtyre dispozitave, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin që për çdo kërkesë apo memo të palës së dëmtuar të shprehej me shkrim, duke bërë kështu transparente veprimet e tij procedurale dhe marrëdhëniet me palët në proces.

30.24 Për sa më lart, Komisioni vlerëson se bazuar në shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, prapësimet e tij në lidhje me konstatimin e Komisionit se “Subjekti ka zvarritur hetimet dhe nuk ka kryer hetime të plota”, janë në tërësi bindëse dhe Komisioni nuk mund ta ngarkojë subjektin me përgjegjësi për veprimet e kryera në afatet e dokumentuara në dosje.

30.25 Nga ana tjetër, në lidhje me konstatimin se subjekti nuk u është përgjigjur kërkesave procedurale dhe memove të kallëzuesit, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti ka cenuar të drejtat e personit të dëmtuar nga vepra penale, që të njihet me hetimin dhe materialet hetimore dhe nuk u është përgjigjur kërkesave dhe memove të tij, të drejta këto që parashikohen nga neni 58, pikat 1/d e 1/dh dhe nenet 105, 110 e 279/a të Kodit të Procedurës Penale, por, parë kjo nën dritën e një vlerësimi proporcional dhe objektiv, që ka të bëjë me këtë procedim në tërësi, veprimet hetimore procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit, vendimmarrjet e tij dhe ato të gjykatës, si dhe nisur nga fakti që vendimi përfundimtar i pushimit i marrë nga subjekti i rivlerësimit ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga ana e kallëzuesit, **Komisioni arrin në përfundimin se kjo problematikë nuk arrin deri në atë nivel saqë ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin profesional.**

KONSTATIME TË TJERA

31. Nga portalet e mediave, konkretisht nga *, në rubrikën “****” të datës 1.2.2022, jepet informacioni se një shtetas është plagosur në ambientet e punës dhe çështja e tij është hetuar nga prokurori Dritan Nushi, i cili në arsyetimin e vendimit citon një aksident tjetër në punë. Gjithashtu, infermieri që ka mjekuar shtetasin e plagosur, gjatë përgjimit të një bisede me një nga inxhinierët e punëdhënësit të shtetasit të plagosur është shprehur: “Me para e mbyll këtë punë”.**

31.1 Komisioni, pasi administroi¹³⁷ dhe shqyrtoi dosjen e procedimit penal nr. ***, viti 2019, vëren se mbi bazën e kallëzimit të shtetasit G. K. Prokuroria e Rrethit Tiranë ka regjistruar në datën

¹³⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.11.2022, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

14.11.2019 procedimin penal nr. ***, viti 2019, për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” (289/1 Kodi i Procedurës Penale) pa emër autori të dyshuar. Kallëzimi kishte dy objekte: “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” dhe “Moskallëzimi i krimit”.

31.2 Në kallëzim pretendohet se ky shtetas ka qenë i punësuar në kompaninë “****” sh.p.k. si punëtor i përpunimit të mishit, por, pavarësisht përsëkrimit të punës në kontratë, ai kryente çdo detyrë që i ngarkonte përgjegjësi i turnit. Në datën 9.4.2019 ka qenë duke punuar si zakonisht në paketimin e sallamit dhe në orën 10:30 është urdhëruar nga përgjegjësjë e turnit që të transportonte disa bombola gazi, pavarësisht refuzimit të tij se nuk mund t’i mbante dot. Gjatë transportimit, një bombol është rrëzuar, duke i zënë dorën e majtë dhe dëmtuar 4 gishta. Është nisur me një shofer të kompanisë në spital, por është kthyer nga rruga me urdhër nga kompania. Pasi i kanë ndërruar rrobat e punës dhe i kanë fashuar dorën, e kanë nisur të shoqëruar nga inxhinieri i kompanisë Y. P. tek një mjek privat V. A. pranë Spitalit të Traumës Tiranë. Në orën 22:00 ka shkuar në këtë spital kur mjeku V. A. ishte në turnin e tretë, për të bërë grafi dhe për të vendosur dorën në allçi. Kur e ka pyetur polici në spital përse kishte ardhur dhe çfarë problemi kishte, doktor V. ishte përgjigjur se ishte miku i tij dhe kishte ardhur të mjekojë dorën. Y. P. i ka thënë që të mos bënte denoncim në polici, sepse kompania do t’i përgjigjej për dëmshpërblimin dhe shpenzimet. Kallëzuesi ka qëndruar 6 muaj me raport mjekësor dhe, kur është kthyer në punë, kompania i ka njoftuar një shkresë, ku thuhej se ai ka pësuar aksident në ambientet e shtëpisë së tij dhe, meqë ishte i paaftë për punë, nuk mund ta merrnin në punë. Në vijim, kallëzuesi pretendon se dora është dëmtuar dhe nuk është i aftë për punë. Në përfundim pretendon për hetimin për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” (neni 289 i Kodit Penal) dhe “Moskallëzimi i krimit” (neni 300 i Kodit Penal).

31.3 Hetimet janë kryer deri në datën 14.2.2020 nga prokurori A. Xh., më pas nga prokurori B. H.. Veprimi i fundit i kryer nga prokurori B. H. është urdhri datë 20.5.2021 për shoqërimin e detyrueshëm të shtetasit G. K. në Institutin e Mjekësisë Ligjore për ekspertizën e dorës. Akti i fundit procedural është akti i ekspertimit mjekoligjor nr. *** në qershor të vitit 2021 nga Instituti i Mjekësisë Ligjore. Relacioni i OPGJ-së për përfundimin e hetimeve me pushim të çështjes mban datën 28.6.2021. Në dosje nuk ka urdhër të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Tiranë që të kuptohet se kur është zëvendësuar prokurori B. H. me subjektin e rivlerësimit, por në pyetësin nr. 3 subjekti ka depozituar faqen nga sistemi në lidhje me shortin e kësaj çështjeje, nga ku rezulton se është caktuar për këtë çështje në datën 9.9.2021.

31.4 Për 6 muaj, nga data 28.6.2021 deri në datën 20.12.2021, kur subjekti i rivlerësimit i drejton Gjykatës kërkesë për pushimin e çështjes, nuk rezultojnë veprime hetimore dhe asnjë akt i nënshkruar nga asnjë prej prokurorëve të kësaj çështjeje. Pra, subjekti nga ana e tij për rreth 2.5 muaj nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, përveç atyre që kanë kryer prokurorët paraardhës të çështjes, por gjithashtu ka kaluar edhe afatin e përgjithshëm të hetimeve prej 2 vitesh, të parashikuar nga neni 324 i Kodit të Procedurës Penale dhe nuk rezulton të ketë në dosje ndonjë miratim të Prokurorit të Përgjithshëm, siç përcakton pika 2 e këtij neni.

31.5 Kërkesën për pushimin e çështjes subjekti e ka bazuar në nenet 328/1/b dhe 329/a/1 të Kodit të Procedurës Penale, sepse fakti i ndodhur nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, pasi mungon pasoja e kërkuar.

31.6 Në arsyetimin e kërkesës, subjekti citon të gjitha veprimet hetimore të kryera, përfshirë edhe deklaratimet e personave të pyetur, duke dhënë një tablo të plotë të rrethanave të ngjarjes. Në pjesën arsyetuese, subjekti bën analizën e elementeve të veprës penale me referime në dispozita ligjore, por nuk bën njëkohësisht lidhjen e tyre me rrethanat e rastit konkret, për të analizuar kështu ekzistencën ose jo të secilit element të veprës penale konkrete.

31.7 Në vendim subjekti citon se: “...nuk provohet që me dashje ose pakujdesi ka shkelje të rregullave të mbrojtjes në punë, të sigurimit teknik dhe disiplinës teknike, si dhe nuk rezulton mosmarrja e masave për respektimin dhe zbatimin e këtyre rregullave. Pasoja e ardhur nuk është rrjedhim i lidhjes shkakësore midis veprimit dhe mosveprimit të shkeljes së rregullave në punë, që janë shkak kryesor dhe përcaktues për ardhjen e pasojës. Nuk provohet që ndonjë person të ketë shkelur marrëdhënien juridike të vendosur nga shteti për mbrojtjen në punë dhe sigurimin teknik”.

31.8 Vendimi i subjektit është ankimuar në gjykatë nga shtetasi G. K. dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 1.6.2022, ka vendosur kthimin e akteve prokurorisë dhe detyrimin e saj për të vazhduar hetimet brenda afatit 90 ditë, duke i caktuar edhe detyrat që duhet të kryejë prokuroria, për shkak se hetimi nuk është i plotë.

31.9 Kundër vendimit të gjykatës, i protokolluar në datën 7.7.2022, subjekti i rivlerësimit ka bërë ankim, duke kërkuar prishjen e vendimit gjyqësor nr. ***, datë 1.6.2022. Ky ankim me shkresën nr. ***, datë 9.7.2022, i është përcjellë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, por ende nuk rezulton¹³⁸ të ketë një vendimmarrje për këtë ankim.

31.10 Për sa më lart, duket se subjekti i rivlerësimit:

- Nuk ka kryer hetime për 2.5 muaj që nga dita kur është caktuar për hetimin e çështjes dhe ka lejuar kalimin e afatit procedural 2-vjeçar të hetimeve, duke shkelur nenin 324 të Kodit të Procedurës Penale.
- Nuk ka kryer hetime të plota dhe, për këtë shkak, gjykata ka prishur vendimin e tij për pushimin e procedimit dhe e ka urdhëruar të ribëjë hetimin, duke i caktuar edhe detyrat përkatëse brenda afatit 90-ditor.

Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit në lidhje me konstatimet e lartpërmendura.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

31.11 Në lidhje me konstatimin e Komisionit për moskryerjen e hetimeve për 2.5 muaj që nga dita kur është caktuar për hetimin e çështjes dhe lejimin e kalimit të afatit procedural 2-vjeçar të hetimeve, subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij pretendon se, pavarësisht se është caktuar për të vazhduar hetimin e kësaj dosjeje në datën 9.9.2021, ai e ka tërhequr dosjen nga sekretaria në datën 15.12.2021.

31.12 Për të provuar këtë prapësim, subjekti ka bashkëlidhur kopje të regjistrit të njoftimit të kallëzimeve penale, ku rezulton se ka firmosur tërheqjen e dosjes në datën 15.12.2021. Kjo vonesë ka qenë për shkak të mosdorëzimit në kohë të dosjes nga prokurori i mëparshëm dhe vonesat e veprimeve të sekretarisë. Për afatin 2-vjeçar të hetimeve që Komisioni konstaton se është tejkualuar, subjekti pretendon se ky afat ekziston vetëm për veprat penale, për të cilat është regjistruar emri i autorit të dyshuar.

Vlerësimi i Komisionit

31.13 Në lidhje me konstatimin e Komisionit për moskryerjen e hetimeve për 2.5 muaj, subjekti ka dhënë prapësime bindëse për Komisionin.

31.14 Në lidhje me konstatimin e dytë, se gjykata ka prishur vendimin e subjektit për pushimin e procedimit dhe e ka urdhëruar të ribëjë hetimin duke i caktuar edhe detyrat përkatëse brenda afatit 90-ditor, Komisioni mban parasysh se ky nuk është një vendim i formës së prerë dhe ankimi ndaj këtij vendimi është në proces gjykimi.

¹³⁸ Sipas shkresave nr. *** prot., datë 13.11.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe nr. *** prot., datë 3.11.2023, të kësaj gjykate.

31.15 Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se, meqenëse vendimi nr. ***, datë 1.6.2022, i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për kthimin e akteve prokurorisë për të vazhduar hetimet, nuk është i formës së prerë, për të vlerësuar kështu mbi vendimmarrjen e subjektit, ky fakt do të mbahet parasysh nga Komisioni në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

32. Nga portalet e mediave, konkretisht *, artikulli me titull “Zvarriste seancat gjyqësore/Çfarë ndodhi me hetimet për prokurorin Dritan Nushi. 13.10.2020 (08:50)”**

32.1 Në artikull shkruhet se në ankesën e tij datë 2.7.2014 drejtuar Avokatit të Popullit, shtetasi V. Ç. nga Tirana ankohej për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimit të kërkesës penale me objekt “Kundërshtim i vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. ***/2013 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, duke pretenduar se shkaku kryesor i zvarritjeve ka qenë mosparaqitja në gjykim e prokurorit Dritan Nushi pa arsye ligjore në seancën datë 15.7.2014 (ora 11:30) dhe atë paraardhëse.

32.2 Komisioni, pasi administroi¹³⁹ dhe shqyrtoi dosjet e çështjeve të gjykuara me vendimet nr. ***, datë 25.7.2014 dhe nr. ***, datë 15.9.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vëren se: Prokuroria e Rrethit Tiranë në datën 28.5.2013 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal të regjistruar mbi bazën e kallëzimit penal nr. *** të shtetasit V. Ç. për veprën penale “Shkatërrim prone”, i cili është hetuar nga prokurori E. K.. Shtetasi V. Ç. e ka kundërshtuar në gjykatë vendimin e prokurorisë.

32.3 Me autorizimin datë 8.5.2014 autorizohet subjekti Dritan Nushi të zëvendësojë në këtë gjykim përfaqësuesin e prokurorisë në çështje, prokurorin E. K.. Rezulton se subjekti nuk është paraqitur dhe nuk ka referuar shkaqe të mungesës në 3 seanca (në datat 2.6.2014, 15.7.2014 dhe 21.5.2014).

32.4 Për këto mungesa subjekti ka shpjeguar në pyetësorin nr. 3 se për seancën e datës 2.6.2014 nuk e mban mend arsyen e mungesës, sepse ka kaluar një kohë e gjatë prej 9 vjetësh, por bazuar në korrektesën që e karakterizon për pjesëmarrje në seanca, mund të ketë pasur ndonjë shkak të arsyeshem, si angazhimi në veprime të ngutshme hetimore, në ndonjë seancë tjetër gjyqësore apo të ketë qenë prokuror i gatshëm në ndonjë ngjarje kriminale. Për mungesën në seancën e datës 15.7.2014, kujton se është urdhëruar nga prokurori i rrethit si drejtues i grupit hetimor për çështjen e vrasjes së bankierit A. S., duke lënë çdo çështje tjetër. Për këtë ka njoftuar nëpërmjet telefonit edhe gjyqtarin e çështjes, i cili e ka pasqyruar rregullisht në procesverbalin e seancës datë 30.6.2014¹⁴⁰. Për sa më lart, subjekti nuk dha shpjegime për seancën e datës 21.5.2014.

32.5 Në seancën e datës 25.7.2014, shtetasi V. Ç. ka kërkuar pezullimin e këtij gjykimi. Në lidhje me këtë kërkesë, subjekti duke shprehur mendimin e tij ka dhënë orientim që ky shtetas të kërkonte pushimin e këtij gjykimi, pastaj të ankimonte vendimin e kësaj gjykate, duke vazhduar derisa të zgjidheshin çështjet civile. Gjykata, në bazë të nenit 387 të Kodit të Procedurës Penale, me vendimin nr. ***, datë 25.7.2014, ka vendosur pushimin e kërkesës penale të shtetasit V. Ç. me objekt “Kundërshtimin e vendimit të Prokurorisë “Për mosfillimin e procedimit penal”.

32.6 Kundër vendimit nr. ***, datë 25.7.2014, shtetasi V. Ç. ka bërë ankim. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 4.5.2016, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 25.7.2014 dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, duke arsyetuar se kërkuesi është sugjeruar nga prokurori dhe gjyqtari në seancë që të pushonte kërkesën. Këto sugjerime kanë ndikuar në vendimmarrjen e kërkuesit, duke e bërë qëndrimin e tij me ves dhe nën ndikim. Afati i përcaktuar nga neni 291/2 i Kodit të Procedurës Penale është afat prekluziv dhe pushimi i gjykimit të kërkesës i humb kërkuesit të drejtën që të rihapë sërish të njëjtën çështje.

32.7 Për sa më lart duket se:

¹³⁹ Me shkresën nr. *** pro., datë 18.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁴⁰ Bashkëlidhur subjekti ka depozituar procesverbalin e seancës datë 30.6.2014, që provon shpjegimin e subjektit.

- Subjekti me mosparaqitjen e tij në gjykim në datën 21.5.2014 ka zvarritur gjykimin vetëm me 1 seancë, pa shkaqe të arsyeshme.
- Subjekti ka dalë tej kompetencave të tij si prokuror, të përcaktuara nga Kodi i Procedurës Penale, duke orientuar gabim palën kërkuese në gjykim në seancën gjyqësore datë 25.7.2014, lidhur me pushimin e kërkesës së saj, veprim për të cilin është shprehur kundër edhe Gjykata e Apelit Tiranë.

32.8 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kërkoi subjektit të japë shpjegimet e nevojshme në lidhje me veprimin procedural të mosparaqitjes pa arsye të tij në një seancë gjyqësore dhe në lidhje me veprimet e tij në seancën gjyqësore të datës 25.7.2014, sipas konstatimeve më lart.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

32.9 Në prapësimet e tij, në lidhje me konkluzionin e parë të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se sipas procesverbalit gjyqësor bashkëlidhur prapësimeve, seanca e datës 21.5.2014 u caktua të zhvillohej në orën 14:30, por është zhvilluar në orën 15:23. Subjektit, pasi ka pritur fillimin e seancës gjyqësore, i është dashur të largohej për një seancë hetimore për çështjen e vrasjes së bankierit A. S..

32.10 Në lidhje me konstatimin e dytë, pavarësisht se gjatë prapësimeve subjekti referon nenin 71 të Kodit të Procedurës Penale dhe argumenton rëndësinë e ligjit penal në raport me atë civil dhe administrativ, e pranon se në seancën gjyqësore ka deklaruar që shtetasi V. Ç. do të ishte mirë të zgjidhte njëherë çështjen civile dhe të pushonte çështjen penale objekt gjykimi.

Vlerësimi i Komisionit

32.11 Në lidhje me konstatimin se subjekti me mosparaqitjen e tij në gjykim, në datën 21.5.2014, ka zvarritur gjykimin vetëm me 1 seancë, pa shkaqe të arsyeshme, Komisioni i vlerëson bindëse këto prapësime të subjektit.

32.12 Në lidhje me prapësimet e subjektit ndaj konstatimit të Komisionit se subjekti ka dalë tej kompetencave të tij si prokuror, të përcaktuara nga Kodi i Procedurës Penale, duke orientuar gabim palën kërkuese në seancën gjyqësore të datës 25.7.2014, lidhur me pushimin e kërkesës së saj, Komisioni, duke mbajtur parasysh shpjegimet e subjektit, si dhe vendimin nr. ***, datë 4.5.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë që ka prishur vendimin nr. ***, datë 25.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës.

32.13 Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se gjatë gjykimit të kërkesës penale të shtetasit V. Ç. me objekt “Kundërshtimin e vendimit të Prokurorisë “Për mosfillimin e procedimit penal”, subjekti ka dalë tej kompetencave të tij si prokuror, të përcaktuara nga Kodi i Procedurës Penale, duke orientuar gabim palën kërkuese në seancën gjyqësore datë 25.7.2014, lidhur me pushimin e kërkesës së saj, veprim për të cilin është shprehur kundër edhe Gjykata e Apelit Tiranë.

Konkluzione për kriterin e figurës dhe për kriterin e vlerësimit profesional

33. Në përmbledhje të konkluzioneve, referuar raportit të hartuar nga Grupi i Punës në KLP dhe dokumentacionit bashkëlidhur, raportit të hartuar nga AKSIK-ja, dokumentacionit të administruar nga Komisioni, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, trupi gjykues vlerëson se nuk janë konstatuar shkelje nga ana e subjektit të rivlerësimit, që mund të çonin në cenimin e figurës së tij në kuptim të nenit 34 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale sipas shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, prandaj subjekti i rivlerësimit paraqet përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në lidhje me kriterin e

figurës, si dhe ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Shumica e trupit gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, referuar neneve Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës, krerëve V, VI dhe VII të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme të trupit gjykues, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Nushi:

a. Ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

b. Ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 34 të ligjit nr. 84/2016.

c. Ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 51, shkronjës “a”, pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Nushi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 31.1.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Xhensila PINE
Anëtare (kundër)

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj